



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE**

**USTAVNI SUD**

**CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 22 mars 2023

Nr.ref.:AGJ 2146/23

## **AKTGJYKIM**

në

**rastin nr. KI129/21**

Parashtrues

**Velerda Sopi**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së “veprimeve dhe mosveprimeve” të Gjykatës Themelore në Gjilan, Prokurorisë Themelore në Gjilan, Stacionit Policor në Graçanicë dhe Prokurorisë Themelore në Prishtinë**

## **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare  
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Safet Hoxha, gjyqtar  
Radomir Laban, gjyqtar  
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare  
Nexhami Rexhepi, gjyqtar dhe  
Enver Peci, gjyqtar

### **Parashtruesja e kërkesës**

1. Kërkesa është parashtruar nga Velerda Sopi, e bija e së ndjerës S.M., me vendbanim në Gjilan (në tekstin e mëtejmë: parashtruesja e kërkesës).

## **Objekti i çështjes**

2. Parashtruesja e kërkesës konteston “*të gjitha veprimet dhe mosveprimet*” e autoriteteve publike, si në vijim: (i) Gjykatës Themelore në Gjilan; (ii) Prokurorisë Themelore në Gjilan; (iii) Stacionit Policor në Graçanicë; dhe (iv) Prokurorisë Themelore në Prishtinë, veprimet apo mosveprimet e të cilave, sipas saj, kanë cenuar të drejtën për jetë të nënës së saj, përkatësisht të ndjerës S.M., të garantuar me: (i) nenin 25 [E Drejta për Jetën] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë Kushtetuta) në lidhje me nenin 2 (E drejta për jetën) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ); si dhe (ii) nenet 18 (Detyrimet e Përgjithshme), 50 (Reagim, parandalim dhe mbrojtje të menjëherëshme) dhe 51 (Vlerësimi i rrezikut dhe menaxhimi i rrezikut) të Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës kundër Grave dhe Dhunës në Familje (në tekstin e mëtejmë: Konventa e Stambollit).

## **Baza juridike**

3. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridikioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa Individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i Kërkesave dhe Përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatë**

4. Më 13 korrik 2021, parashtruesja e kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).
5. Më 14 korrik 2021, Kryetarja e Gjykatës përmes Vendimit [KSH.KI.129/21] caktoi gjyqtarin Safet Hoxha Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrties, të përbërë nga gjyqtarët: Radomir Laban (kryesues), Remziye Istrefi-Peci dhe Nexhami Rexhepi (anëtarë).
6. Më 28 korrik 2021, Gjykata e njoftoi parashtruesen e kërkesës për regjistrimin e kërkesës. Në të njëjtën ditë, në cilësinë e palëve kundërshtare, Gjykata njoftoi Gjykatën Themelore në Gjilan, Prokurorinë Themelore në Prishtinë, Prokurorinë Themelore në Gjilan dhe Policinë e Kosovës, duke u dhënë mundësinë e paraqitjes së komenteve të tyre dhe dorëzimit të dokumentacionit relevant në lidhje me kërkesën. Përveç mundësisë për dhënien e komenteve, Gjykata në mënyrë specifike i kërkoi Gjykatës Themelore në Gjilan dorëzimin e kopjeve të dokumenteve si në vijim: (i) procesverbalin e seancës dëgjimore në lidhje me rastin [2019:263376] të mbajtur në Gjykatën Themelore në Gjilan, më 25 nëntor 2019; si dhe (ii) dosjen e rastit [P.nr. 1042/19] përkitazi me zhvillimin e procedurës penale kundër L.S-së.
7. Po ashtu, më 28 korrik 2021, në cilësinë e palës së interesuar, Gjykata njoftoi Avokatin e Popullit, duke i dhënë mundësinë e dorëzimit të komenteve në lidhje me kërkesën.
8. Më 3 gusht 2021, Gjykata Themelore në Gjilan i dorëzoi Gjykatës dosjen e lëndës [P.nr. 1042/2019] dhe dosjen e lëndës [C.nr. 1002/2019], përkitazi me procedurën e shqiptimit të urdhrit mbrojtës.
9. Më 11 gusht 2021, Prokuroria Themelore në Prishtinë dorëzoi në Gjykatë komentet e saj në lidhje me kërkesën, të përcjella me dokumentacionin përkatës.

10. Më 11 gusht 2021, Prokuroria Themelore në Gjilan dorëzoi në Gjykatë komentet e saj në lidhje me kërkesën, të përcjella me dokumentacionin përkatës.
11. Më 11 gusht 2021, Policia e Kosovës, përkatësisht Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës, dorëzoi në Gjykatë komentet e saj në lidhje me kërkesën, të përcjella me dokumentacionin përkatës.
12. Më 19 gusht 2021, Avokati i Popullit dorëzoi në Gjykatë Raportin e Avokatit të Popullit *Ex-Officio* [Nr. 150/2021] të 27 prillit 2021, të titulluar “*Detyrimet pozitive të shtetit për të drejtën në jetë dhe mbrojtjen nga dhuna në familje*” (në tekstin e mëtejmë: Raporti i Avokatit të Popullit).
13. Më 6 maj 2022, Gjykata e njoftoi Koordinatoreni Nacionale kundër Dhunës në Familje për regjistrimin e kërkesës, duke i dhënë mundësinë e dorëzimit të komenteve në lidhje me kërkesën.
14. Më 16 dhjetor 2022, gjyqtari Enver Peci dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç'rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
15. Më 25 janar 2023, Gjykata shqyrtoi raportin e gjyqtarit rapportuese dhe njëzëri vendosi që shqyrtimin e mëtejmë të kërkesës ta shtyjë për një seancë të radhës pasi të jetë plotësuar me analizë shtesë.
16. Më 7 mars 2023, Kolegji shqyrties shqyrtoi raportin e gjyqtarit rapportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata vendosi: (i) të deklarojë kërkesën të pranueshme; (ii) të konstatojë se Policia e Republikës së Kosovës përkatësisht, Stacioni Policor në Graçanicë dhe Prokurori i Shtetit, përkatësisht Prokuroria Themelore në Prishtinë, kanë dështuar në detyrimin e tyre pozitiv për mbrojtje të jetës së S.M.-së, të garantuar me paragrafin 1 të nenit 25 [E Drejta për Jetën] të Kushtetutës dhe paragrafin 1 të nenit 2 (E drejta për jetën) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; dhe (iii) të konstatojë se Policia e Republikës së Kosovës, përkatësisht Stacioni Policor në Graçanicë dhe Prokurori i Shtetit, përkatësisht Prokuroria Themelore në Prishtinë, kanë dështuar në përbushjen e detyrimeve të përcaktuara me paragrafin 4 të nenit 18 (Detyrimet e Përgjithshme), paragrafin 1 të nenit 50 (Reagim, parandalim dhe mbrojtje të menjëherëshme), paragrafin 1 të nenit 51 (Vlerësimi i rrezikut dhe menaxhimi i rrezikut) dhe paragrafin 1 të nenit 55 (Procedimet *ex parte dhe ex officio*) të Konventës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje.

### **Përbledhja e fakteve**

17. Gjykata fillimisht vë në pah se parashtruese e kërkesës është e bija e S.M.-së. S.M më 14 mars 2021 ishte privuar ngajeta me armë zjarri nga bashkëshorti i saj L.S. [babai i parashtruese së kërkesës], i cili në vendngjarje më pas kishte kryer vetëvrasje. Të ndjerës S.M., Gjykata i referohet me inicialet S.M., për arsy se të njëjtat janë përdorur në kërkesën e parashtruar në Gjykatë, edhe pse e ndjera në dokumentacionin zyrtar paraqitet me mbiemrin e bashkëshortit, respektivisht inicialet [S.S]. Në lidhje me këtë të fundit, nga shkresat e lëndës rezulton që të ndjerët, S.M. dhe L.S., respektivisht, kishin qenë në procedurë të zgjidhjes së martesës së tyre.

## **I. Përbledhja e fakteve që i paraprijnë vrasjes të së ndjerës S.M.**

(a) Përbledhja e fakteve që ndërlidhen me urdhrin mbrojtës

18. Më 10 nëntor 2019, S.M. në Stacionin Policor në Gjilan kishte raportuar rastin përsulm dhe dhunë të vazhdueshme në familje nga i ndjeri L.S.
19. Më 12 nëntor 2019, S.M., parashtroi kërkesë për Urdhër Mbrotjtës në Gjykatën Themelore në Gjilan ndaj bashkëshortit L.S. Në kërkesën e saj për Urdhër Mbrotjtës, e ndjera, S.M., në cilësinë e viktimës, ndër të tjera, kishte theksuar se: “*Që nga martesa kemi pasur mosmarrëveshje me [L.S.] dhe çdo herë ka ushtruar dhunë fizike dhe psiqike ndaj meje mirëpo nuk e kam raportuar në polici ngase kam menduar që po përmirësohet, mirëpo ai nuk është përmirësuar dhe gjithnjë ka vazhduar me dhunën ndaj meje*”.
20. Po ashtu, viktima S.M., ndër të tjera, deklaroi se: “[...]prej asaj dite që jam kthyer te ish burri im, çdo herë kam pasur probleme ku ai ka ushtruar dhunë psiqike e sistematike të vazhdueshme dhe më kërcënojke me fjalët “ti mund të ndahesh nga unë, mirëpo unë nuk do të lë rahat dhe do ta gjej pikën e dobët që e ki ti”, dhe mendoj se pika e dobët është vllau im sepse e kam vetëm një vëlla dhe mos e gjen ndonjë e keqe nga ky”, si dhe përfundoi se “*Unë nuk i besojë burrit tim [L.S.] sepse kohët e fundit ka qenë shumë agresiv dhe ka qenë edhe te psikiatri Dr. [A.L.] dhe me duket se përdor terapi*”.
21. Më 12 nëntor 2019, L.S., ishte intervistuar në cilësinë e të dyshuarit dhe më pas ishte liruar në procedurë të rregullt. Në të njëjtën ditë, prokurori i rastit kërkoi intervistikimin e sérishëm të të dyshuarit L.S. në prezencë të avokatit mbrojtës, dhe për pasojë ndaloi L.S.-në në kohëzgjatje prej dyzet e tetë (48) orëve.
22. Më 12 nëntor 2019, gjyqtari i procedurës paraprake në Gjykatën Themelore në Gjilan nxori urdhrin verbal për bastisjen e shtëpisë dhe lokaleve përcjellëse të L.S.-së. Në të njëjtën ditë, Stacioni Policor në Gjilan në Gjykatën Themelore në Gjilan dorëzoi kërkesën [nr.ref.04/0106GJ-H-433/2019] për aprosim retroaktiv të kontrollit të shtëpisë dhe objekteve përcjellëse të L.S.-së.
23. Më 13 nëntor 2019, Policia e Kosovës në Prokurorinë Themelore në Gjilan dorëzoi kallëzimin penal [PP.II.nr. 1835/19] ndaj të dyshuarit L.S.
24. Më 13 nëntor 2019, Prokuroria Themelore në Gjilan nxori Aktvendimin [PP.II.nr. 1835/19] për fillimin e hetimit ndaj L.S.-së për shkak të dyshimit të kryerjes së veprave penale të përcaktuara në paragrafin 1 të nenit 248 [Dhuna në Familje] dhe nënparagrafin 3.1 të nenit 184 [Sulmi] të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPRK).
25. Më 13 nëntor 2019, Prokuroria Themelore në Gjilan në Gjykatën Themelore në Gjilan parashtroi kërkesën për caktimin e paraburgimit ndaj të dyshuarit L.S. Me qëllim të sigurisë së viktimës S.M., një kopje e kallëzimit penal iu dërgua Zyrës për Mbrotjtë dhe Ndihmë të Viktimate (në tekstin e mëtejmë: ZMNV).
26. Në një datë të pasaktësuar, vajzat e S.M.-së parashtruan në ZMNV kërkesë për ndërprerjen e paraburgimit të L.S.-së. Të njëjtën kërkesë vajzat e S.M.-së e kishin parashtruar edhe në Prokurorinë Themelore në Gjilan dhe në Gjykatën përkatëse Themelore.

27. Më 13 nëntor 2019, Prokuroria Themelore në Gjilan në Qendrën për Punë Sociale (në tekstin e mëtejmë: QPS), parashtroi kërkesën për vizitë të S.M.-së, në cilësinë e viktimës dhe hartimin e një raporti me konstatime nga kjo qendër.
28. Më 13 nëntor 2019, Prokuroria Themelore në Gjilan morri deklaratën e viktimës S.M. në prezencë të përfaqësuesit të ZMNV-së.
29. Më 14 nëntor 2019, ZMNV morri deklaratën e djalit të S.M.-së dhe e përcolli në Prokurorinë Themelore në Gjilan.
30. Më 18 nëntor 2019, Prokuroria Themelore në Gjilan morri deklaratën e të dyshuarit L.S. në prezencë të avokatit të tij mbrojtës.
31. Më 18 nëntor 2019, QPS në Gjilan mbajti takim këshillues me S.M.-në dhe përpiloi Raportin [04-141986/19] për veprat penale “Dhunë në familje” dhe “Sulm”, të cilin raport e dërgoi të prokurorja e rastit në Prokurorinë Themelore në Gjilan. Raporti i përpiluar nga QPS pëershkruan marrëdhëniet ndër vite të S.M.-së me bashkëshortin e saj L.S., duke i cilësuar ato si: “*fillimi* *raporte-marrëdhënie* *të mira deri me lindjen e vajzës së parë ku pastaj janë shfaqur mosmarrëveshje për shkak të xhelozisë nga ana bashkëshortit, ka pasur dhunë fizike dhe psikologjike mirëpo viktima nuk i ka paraqitur rastet në polici deri në rastin e fundit, i cili ka ndodhur me 10.11.2019*”. Raporti thekson se viktima S.M. vuan nga sëmundja e kancerit, të cilën është duke e trajtuar si dhe ka iniciuar padinë për shkurorëzim.
32. Më 26 nëntor 2019, Gjkata Themelore në Gjilan nxori urdhrin mbrojtës [C.nr. 1002/2019] ndaj S.M.-së dhe vëllait të saj në kohëzgjatje prej dy muajve, me mundësi vazhdimi, por jo më shumë se njëzet e katër (24) muaj. Në Urdhrin e mbrojtjes specifikohej si në vijim:

*I. NDALIMI I SHQETËSIMIT* *të palës së mbrojtur respektivisht ndalimi i shqetësimit, ofendimit, përuljes apo përbuzjes, mos ta sulmoj apo kërcënoj se do ta sulmoj qoftë fizikisht apo psiqikisht, ta ndjek apo te bllokoj lëvizjen, apo të mos kontaktoj direkt apo indirekt ne çfarëdo forme me palën e mbrojtur dhe masën mbrojtëse të afritit në afërsi prej 100 m nga vendbanimi i palës së mbrojtur.*

*II. NDALIMI i afritit të viktimës së dhunës në familje [S.M.] nga Gjilani si dhe masën mbrojtëse ndalimin e afritit nga fëmijët dhe vëllai i palës së mbrojtur [F.M.], si në shkollë të fëmijëve ashtu edhe në pjesë të ndryshme të qytetit në afërsi prej 20 m kudo që ndodhet pala e mbrojtur.”*

33. Më 12 dhjetor 2019, Gjkata Themelore në Gjilan përmes Aktvendimit [P.nr.1042/19] aprovoi kërkesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan dhe L.S.-së i vazhdoi masën e paraburgimit në kohëzgjatje prej dy (2) muajve, gjegjësisht deri më 20 janar 2020.
34. Më 25 dhjetor 2019, Prokuroria Themelore në Gjilan ndaj L.S.-së ngriti Aktakuzën [PP.II.1835/19] për shkak të dyshimit se ky i fundit kishte kryer veprat penale të parapara me paragrafin 1 të nenit 248 të KPRK-së dhe nënparagrafi 3.1 të nenit 184 të KPRK-së. Të njëjtën kohë, Prokuroria Themelore në Gjilan paraqiti kërkesën për vazhdimin e masës së paraburgimit në Gjykatën përkatëse Themelore.
35. Më 27 janar 2020, Gjkata Themelore në Gjilan përmes Aktgjykimit [P.nr.1042/19], të pandehurin L.S. e: (i) shpalli fajtor për kryerjen e veprës penale “Dhunë në familje” nga paragrafi 1 i nenit 248 i KPRK-së dhe veprën penale “Sulm” nga nënparagrafi 3.1 i nenit 184 të KPRK-së; (ii) për kryerjen e veprës penale “Dhunë në familje” e dënoi me nëntëdhjetë (90) ditë burgim dhe me dyqind (200) euro gjobë, ndërsa për

kryerjen e veprën penale "Sulm" e dënoi me tridhjetë (30) ditë burgim; (iii) dënim i me burgim u zëvendësua me dënim me gjobë në shumë prej një mijë e treqind (1300) eurosh dhe në rast të mospagesës së kësaj shume, ky dënim me gjobë do të kthehej në dënim me burgim në kohëzgjatje prej shtatëdhjetë e pesë (75) ditëve; (iv) L.S.-së iu konfiskua një thikë-brisk me gjatësi prej 14 cm; dhe (v) S.M.-në, në cilësinë e viktimitës, e udhëzoi në kontest civil për kompensim dëmi.

36. Më 26 nëntor 2020, skadoi urdhri [C.nr.1002/2019] ndaj S.M.-së dhe vëllait të saj.

(b) *Përbledhja e fakteve pas skadimit të urdhrit mbrojtës*

37. Më 3 mars 2021, e bija e S.M.-së, respektivisht motra e parashtrueses së kërkesës, raportoi rastin "dhunë në familje" në Stacionin Policor në Graçanicë.
38. Në raportin e Oficerit [2021-AT-086] të 3 marsit 2021 në Stacionin e Policisë në Graçanicë [të dorëzuar nga Prokuroria Themelore në Prishtinë], theksohet se "*pas marrjes së informatës [ora 19.40] për një problem familjar, rreth orës 20.15, patrulla policore doli në vendngjarje (Uglarë) dhe pas kontaktimit me sektorin e hetimeve, morën deklaratat e dëshmitares [M. S.] dhe viktimitës [S.M.]*"
39. Në deklaratën e S.M.-së, të marrë më 3 mars 2021, theksohet, ndër të tjera, "[...] se sot deri sa ish anë anesën e vajzës sime në të cilën edhe banoj përkohësisht ka ardhur ish burri im [L.S] me të cilin jam ndarë përmes Gjykatës, [...] në prezencë të vajzës sime më ka goditur në fytyre dhe ka dalur nga banesa.[...].ish burri jeton në Gjilan dhe ai për çdo ditë vjen dhe më përcjell mu sis në Fushë Kosovë ashtu edhe tek puna në Prishtinë". Po ashtu ajo kishte deklaruar se babai i saj [L.S.] në banesën e saj të njëjtën ditë e kishte goditur S.M.-në.
40. Sipas dokumentacionit të dorëzuar nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, më 3 mars 2021, rezulton që Stacioni Policor në Graçanicë kishte informuar prokuroren e kujdestare për rastin e iniciuar si "dhunë në familje" dhe veprimet e ndërmarra nga ky stacion policor lidhur me rastin.
41. Më 4 mars 2021, L.S., në cilësinë e të dyshuarit ishte ftuar në Stacionin Policor në Graçanicë dhe të njëjtit i ishte marrë deklarata lidhur me rastin.
42. Në raportin e Oficerit [2021-AT-086] të 4 marsit 2021, ndër të tjera, theksohet se: "*Më 03.03.2021 është intervistuar i dyshuarit [L.S.] në cilësinë e të dyshuarit, më pas edhe është njoftuar prokurorja kujdestare e dhunës në familje [H.K] e cila ka udhëzuar që i dyshuarit të lirohet dhe rasti të vazhdon në procedurë të rregullt*". Sipas Raportit të shënimit zyrtar për rastin [2021-AT-0086] të Prokurorit të Shtetit në Prokurorinë Themelore në Prishtinë të 15 prillit 2021 dorëzuar Avokatit të Popullit specifikohet se: "*[S.M] është kontaktuar nga policia ditën e nesërme me dt. 04.03.2021 në ora 8.30 për deklaratë shtesë, se a ka ndonjë problem dhe të paraqesë dokumente shtesë, e njëjtë ka refuzuar, duke theksuar se nuk është interesuar që të vazhdoj me rastin kundër [L.S] pasi ka qenë e momentit. Të gjitha këto njoftime i janë bërë edhe me dt. 04.03.2021 derisa i dyshuarit [L.S] ka qenë në Stacion Policor Gracanicë duke u marr në pyetje, dhe ka qenë i arritshëm për tu bërë kërkesa për urdhër mbrojtje si masë parandaluese për një periudhë kohore ma gjatë*".
43. Më 14 mars 2021, S.M. u privua ngajeta me armë zjarri nga bashkëshorti i saj L.S., i cili më pas kreua vetëvrasje.

## **II. Përbledhja e fakteve pas vrasjes të së ndjerës S.M.**

### *(a) Veprimet e ndërmarra nga Avokati i Popullit*

44. Më 19 mars 2021, Avokati i Popullit kishte filluar hetimin *ex officio* në lidhje me vdekjen e të ndjerës S.M.
45. Më 27 prill 2021, Avokati i Popullit publikoi Raportin *ex officio* dhe të njëjtin ia dërgoi Gjykatës. Përbledhja e këtij Raporti do të reflektohet në pjesën e komenteve të këtij Aktgjykimi.
46. Si rezultat i Raportit *ex officio* të Avokatit të Popullit, më 7 maj 2021 në Policinë e Kosovës kishte filluar procedura disiplinore ndaj zyrtarëve policorë.

### *(b) Veprimet e ndërmarra nga parashtruesja e kërkesës*

47. Më 29 qershor 2021, parashtruesja e kërkesës bazuar në nenet 4 dhe 12 të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike (GZ, numër 13, 4 korrik 2019), parashtroi kërkesa për qasje në dokumente publike në: (i) Prokurorinë Themelore në Prishtinë; (ii) Gjykatën Themelore në Gjilan; (iii) në ZMNV; dhe (iv) në Shërbimin Korrektues të Republikës së Kosovës.
48. Në kërkesën e saj për qasje në dokumente publike të parashtruar në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, parashtruesja e kërkesës i kërkoi kësaj të fundit qasje: (i) në të gjitha shkresat e lëndës; dhe (ii) informacionet në lidhje me veprimet e ndërmarra nga kjo Prokurori nga data 3 mars 2021 deri më datën 14 mars 2021.
49. Në kërkesën e saj për qasje në dokumente publike, të parashtruar në Gjykatën Themelore në Gjilan, parashtruesja e kërkesës kërkoi qasje në: (i) Vendimin e kësaj Gjykatë për caktimin e urdhrit mbrojtës; dhe (ii) Aktgjykimin [P.nr. 1042/19] të 27 janarit 2020.
50. Në kërkesën e saj për qasje në dokumente publike, të parashtruar në Shërbimin Korrektues, parashtruesja e kërkesës kërkoi qasje në “*komplet dosjen e [L.S.] i cili ka qenë në vuajtje të dënit, në veçanti të dhënat në lidhje trajtimin psikiatrik të tij*”.
51. Në kërkesën e saj për qasje në dokumente publike të parashtruar në ZMNV, parashtruesja e kërkesës kërkoi qasje në dosjen e rastit me të gjitha shkresat e lëndës e cila sipas saj duhet të përfshijë “*mes tjerash: 1. Deklaratën e S.M në polici, me nr. 2019-CA-136. Kërkesën për urdhërmbrojtje nr.13-11/19, e dt. 12 nëntor 2019. 3. Aktakuzën e ngritur nga prokuroria kompetente përkitazi me këtë rast*
52. Më 30 qershor 2021, Shërbimi Korrektues përmes Vendimit përkatës refuzoi pjesërisht kërkesën e parashtrueses së kërkesës për qasje në dokumente publike, duke e njoftuar atë që ky shërbim nuk ka “*kompetencë për të vendosur në lidhje me qasjen e të dhënave mbi trajtimin psikiatrik të [L.S.]*”. Në lidhje me këtë të fundit, Shërbimi Korrektues e njoftoi parashtruesen e kërkesës se: “*Qasja e të dhënave mbi trajtimin psikiatrik nuk është në kompetencë të Shërbimit Korrektues pasi që trajtimi shëndetësor brenda Institucioneve Korrektuese te Shërbimit Korrektues, menaxhohet nga Departamenti Shëndetësor i burgjeve në kuadër të Ministrisë se Shëndetësisë*”, dhe e udhëzoi që për këtë qëllim ajo mund të parashtronte kërkesë në Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Shëndetësisë.

## Pretendimet e parashtrueses së kërkesës

53. Parashtruesja e kërkesës pretendon se Gjykata Themelore në Gjilan, Prokuroria Themelore në Gjilan, Stacioni Policor në Graçanicë dhe Prokuroria Themelore në Prishtinë përmes “veprimeve dhe mosveprimeve” të tyre kanë cenuar të drejtën për jetë të së emës së saj, të ndjerës S.M., të garantuar me nenin 25 të Kushtetutës në lidhje me nenin 2 të KEDNJ-së si dhe me nenet 18, 50 dhe 51 të Konventës së Stambollit.

### I. Pretendimet përkitazi me pranueshmërinë e kërkesës

#### (i) Statusi i viktimës

54. Parashtruesja e kërkesës thekson se “mund të jetë pale pranë Gjykatës Kushtetuese-si viktimë e tërthortë-për shkak të vdekjes së nënës se saj”. Në lidhje me këtë, parashtruesja e kërkesës i referohet rastit të Gjykatës KI41/12, me parashtrues *Gëzim dhe Makfire Kastrati*, Aktgjykim i 26 shkurtit 2013 dhe praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ), gjegjësisht rasteve si në vijim: *Van Colle kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr. 7678/09*, Aktgjykim i 13 nëntorit 2012, paragrafi 86; *Tsalikidis dhe të tjërët kundër Greqisë, nr.73974/14*, Aktgjykim i 16 nëntorit 2017, paragrafi 64; dhe *Yasa kundër Turqisë, nr. 22495/93*, Aktgjykim i 2 shtatorit 1998, paragrafët 61-62.

#### (ii) Afati kohor

55. Parashtruesja e kërkesës thekson se: “Në aspektin kohor, [...] mund të kërkojë vlerësimin e kushtetutshmërisë së (mos)veprimeve të autoriteteve shtetërore që nga 2019 e këndej (përtej limitit katër mujor). Kjo për shkak që të gjitha këto(mos) veprime duhen parë si ngjarje zinxhirore, e jo si episoda të vecanta”. Në lidhje me këtë, parashtruesja e kërkesës i referohet rastit të GJEDNJ-së *Opuz kundër Turqisë, nr. 33401/02*, Aktgjykim i 9 qershorit 2009, paragrafët 108-113.

#### (iii) Shterimi i mjeteve juridike

56. Sa i përket shterimit të mjeteve juridike, parashtruesja e kërkesës pretendon se pas vdekjes së nënës së saj S.M., nuk ka pasur mjet efektiv juridik në dispozicion.
57. Në lidhje me këtë, parashtruesja e kërkesës specifikon se: “...në parim, mundësia për kompensim për vdekjen e personit si pasojë e dështimit të shtetit për të mbrojtur të drejtën për jetën paraqet një mjet juridik adekuat dhe të mjaftueshëm [...] Sidoqoftë, në rendin juridik kosovar nuk ekziston një mundësi e tille. Edhe sikur te ekzistonte, fakti qe autoritetet shtetërore nuk kane zhvilluar asnje procedure penale, disiplinore, apo tjetër ndaj zyrtareve përgjegjës, nënkuption qe ky mjet juridik nuk do te kishte gjasa për sukses, ndaj edhe nuk do te ishte efektiv [...]. Sido qe te jete, problemet me (mos)veprimet e autoriteteve qe adresohen në këtë kërkesë ndërlidhen me probleme zinxhirore e institucionale ne rastin në fjalë që nuk do të mund të adresoheshin me ndonjë mjet tjetër juridik ne Kosove [...] Në anën tjetër, nuk është mjet juridik adekuat as ngritja e kallëzimeve penale apo fillimi i procedurave tjera nga të afërmët e viktimës. Në çështje që mund të invokojnë përgjegjësinë e shtetit për vdekje te individëve autoritetet duhet të veprojnë në këtë drejtim sipas detyrës zyrtare, pa pritur veprime nga të afërmët e viktimës (po aty, §43). Për mjete tjera juridike eventuale nuk i takon parashtrueses se Kërkesës që të argumentojë se të njëjtat do të ishin efektive dhe adekuate, pasi barra e provës nuk bie mbi të) [...]”.

58. Në mbështetje të këtij pretendimi, parashtruesja e kërkesës i referohet rasteve të GJENDJ-së: *E. dhe të Tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 33218/96, Aktgjykim i 26 nëntorit 2002, paragrafi 110; *Branko Tomašić dhe të Tjerët kundër Kroacisë*, nr. 46598/06 74448/12, Aktgjykim i 15 janarit 2009, paragrafët 39-45; dhe *Akdivar kundër Turqisë*, nr. 21893/93, Aktgjykim i 16 shtatorit 1996.

## **II. Pretendimet përkitazi me meritat e kërkesës**

*(i) Pretendimet përkitazi me nenin 25 të Kushtetutës në lidhje me nenin 2 të KEDNJ-së*

59. Parashtruesja e kërkesës fillimisht pretendimin e saj për shkelje të së drejtës në jetë, të garantuar me nenin 25 të Kushtetutës në lidhje me nenin 2 të KEDNJ-së e mbështet në rastet e GJEDNJ-së: *Armani Da Silva kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 5878/08, Aktgjykim i 30 marsit 2016, paragrafi 229; *Qendra për Burime Ligjore në emër të Valentin Campeanu kundër Rumanisë*, nr. 47848/08, Aktgjykim i 17 korrikut 2014, paragrafi 130; *Kurt kundër Austrisë*, nr. 62903/15, Aktgjykim i 15 qershorit 2021; *Branko Tomašić dhe të tjerët kundër Kroacisë*, cituar më lart, paragrafi 50; *Paul dhe Audrey Edéards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 46477/99, Aktgjykim i 14 marsit 2002, paragrafi 55; *Mastromatteo kundër Italisë*, nr. 37703/97, Aktgjykim i 24 tetorit 2002, paragrafi 68; dhe *Osman kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 23452/94, Aktgjykim i 28 tetorit 1998, paragrafi 116.
60. Në kërkesën e saj, parashtruesja e kërkesës thekson se autoritetet shtetërore kishin genë të njoftuar për dhunën e vazhdueshme në familje ndaj të ndjerës S.M. Sipas saj, në nëntor të vitit 2019, për herë të parë L.S. u raportua në polici. Parashtruesja e kërkesës në vijim specifikon se: “*Autoritetet shtetërore u bënë të vetëdijshëm për rrezikshmérinë e [L.S.] si kryes i dhunës ne familje, prandaj edhe ndaj tij u shqiptua urdhri mbrojtës si dhe, paralelisht, u zhvillua procedura penale për veprat sulm dhe dhunë në familje. Pikërisht për shkak të rrezikshmërisë së vlerësuar të tij, [L.S] edhe u mbajt në paraburgim për 69 ditë e në fund u dënuva (megjithëse jo mjaftueshëm, siç do të argumentohet më poshtë)*“.
61. Tutje, parashtruesja e kërkesës konsideron se: “...*autoritetet shtetërore nuk kanë marrë gjithçka që (arsyeshëm) është dashur të merrej nga ta për të shmangur rrezikun për jetën e [S.M.]*”.
62. Për të mbështetur pretendimin e lartcekur, së pari, parashtruesja e kërkesës thekson se autoritetet shtetërore dështuan të adresojnë problemet e natyrës psikike të L.S.-së, meqenëse ishin të informuar nga e ndjera S.M.: “[...] pos që L.S. është trajtuar privatisht nga psikiatri i dhe është vizituar nga e njëjta në Qendrën e Paraburgimit. Prokuroria asnjëherë nuk ka kërkuar ekzaminimin psikiatrik te L.S., me gjithë indikacionet për probleme te shëndetit mendor, te cilat ishin burim i sjelljes se tij te dhunshme. As masa e trajtimit psikosocial ne kuadër të procedurës për shqiptim te urdhrit mbrojtës nuk u morr ne konsiderate asnjëherë nga autoritetet. L.S. u dënuva vetëm me gjobe dhe kurrë nuk u bë një vlerësim adekuat se a do të përbënte rrezik për viktimën edhe në të ardhmen”.
63. Së dyti, parashtruesja e kërkesës pretendon se dënim i gjobës i vitit 2019 ndaj L.S.-së për dy vepra penale: “...*ka krijuar një klimë të pandëshkueshmërisë si dhe ka zbehur besimin e viktimës në drejtësi (për këtë arsyе ajo me vone as nuk ka lajmëruar shkeljet e urdhrit mbrojtjes nga L.S. e as dhunën e ushtruar, e cila tek me 2021 u raportua përsëri dhe atë nga fëmijët e se ndjerës)*”.

64. Së treti, parashtruesja e kërkesës specifikon se: “...në rastin e fundit te raportuar te dhunës në familje, më 3 mars 2021, autoritetet shtetërore nuk morën masa adekuate për të mbrojtur viktimën, duke injoruar obligimet e tyre ligjore”. Sipas saj veprimet e vetme të autoriteteve lidhur me rastin e 3 marsit 2021, ishin inicimi i rastit penal, intervistimi i dëshmitares dhe kryerësit. Parashtruesja e kërkesës, në vijim thekson se asnë veprim tjetër nuk është ndërmarrë në mes të periudhës 4 dhe 14 mars 2021. Këtë pretendim, ajo mbështet në Komunikatën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, të lëshuar dy (2) ditë pas ngjarjes tragjike dhe në Raportin e Avokatit të Popullit, ku konstatohet se: “...kishte munguar koordinimi i veprimeve ndërmjet autoriteteve ndërkaq zyrtarët përgjegjës, në kundërshtim me obligimet e tyre nuk e kishin njofuar mbrojtësin e viktimave që duhet të jetë prezent me viktimën si dhe nuk ishte përpiluar ndonjë plan për sigurinë e viktimës”.
65. Më tej, parashtruesja e kërkesës thekson se: “..fakti se e ndjera [S.M] siç thuhet ne komunikatën e Prokurorisë ”nuk dëshiron që më tutje te vazhdoje me rastin“ nuk duhet assesi te përbejë baze për arsyetim te heqjes dore nga ndjekja e veprës penale nga ana e prokurorisë. Vepër penale ”dhuna në familje“ e përcaktuar me nenin 248 të Kodit o6/L-074 Penal të Republikës së Kosovës, është vepër penale që ndiqet sipas detyrës zyrtare dhe prokurori i rastit nuk ka guxuar që të bazohet në thëniet e viktimës. Madje, kjo parashihet edhe me atë që konsiderohet si ”një nga hallkat më të rëndësishme në infrastrukturën ligjore për mbrojtje nga dhuna në familje“ Në lidhje me këtë, parashtruesja e kërkesës i referohet ”Procedura[ve] Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna ne Familje në Kosovë“, gjegjësisht i referohet përbajtjes së këtij Dokumenti, duke cituar se, ”ndjekja e veprave penale është e rëndësishme për sigurinë e Kosovës. Ndjekja e veprave penale është një çështje midis shtetit dhe kryesit/të pandehurit. Viktima është një dëshmitar i veprës penale“.
66. Tutje, parashtruesja e kërkesës sërisht i referohet Dokumentit të ”Procedura[ve] Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna ne Familje në Kosovë“ duke cituar se: ”...pjasi të njoftohet pér rastin e caktuar, Prokurori duhet tē veproj me urgjencë dhe prioritet gjithmonë duke pas parasysh specifikat e rastit te caktuar. Prokurori është i obliguar qe nga ai moment te mbikëqyr punën e policisë, kryesisht (njësinë e dhunës ne familje), mbi hapat qe duhet te ndërmerren ne vijim pér marrjen e provave Prokurori ka pér detyre te siguroje qe gjate intervistës se viktimës, tē gjithë personat që kanë nevojë pér tē marre pjesë sipas ligjit tē jenë tē pranishëm.“ Në vijim të kësaj, parashtruesja e kërkesës pretendon se: ”Këto kërkesa që dalin nga Procedurat Standarde të Veprimit nuk janë respektuar nga Prokuroria ne rastin konkret“.
67. Në fund, parashtruesja e kërkesës specifikon se: ”..si pasojë e neglizhencës dhe joprofesionalizmit të autoriteteve,jeta e [S.M] përfundoj tragjikisht. Shteti ka dështuar tē mbrojë tē drejtën e saj pér jetën, duke shkelur obligimet kushtetuese te parapara me nenin 25 tē Kushtetutës në lidhje me nenin 2 tē KEDNJ“.
- (ii) Pretendimet përkitazi me nenet 50 dhe 51 tē Konventës së Stambollit
68. Përkitazi me shkeljen e nenit 50 tē Konventës së Stambollit, parashtruesja e kërkesës pretendon se autoritetet përgjegjëse nuk kanë marrë masa ”menjëherë dhe në mënyrë tē përshtatshme [pér tē] ofruar mbrojtje tē mjaftueshme dhe tē menjëherë pér viktimën e dhunës në familje“.
69. Përkitazi me shkeljen e nenit 51 tē kësaj Konverte, parashtruesja e kërkesës pretendon se vlerësimi i rrezikut nga autoritetet përgjegjëse ishte joadekuat dhe me

gjithë indikacionet për rrezikshmërinë e L.S.-së ndaj viktimit, rasti u trajtua “*pa ndonjë nguti*”.

70. Në fund, parashtruesja e kërkesës kërkon nga Gjykata që:

- (i) të deklarojë kërkesën të pranueshme;
- (ii) të konstatojë se (mos)veprimet kumulative të autoriteteve shtetërore [Gjykatës Themelore në Gjilan, Prokurorisë Themelore në Gjilan, Stacionit Policor në Graçanicë dhe Prokurorisë Themelore në Prishtinë] kanë shkelur të drejtën për jetë të S.M.-së, të garantuar me nenin 25 të Kushtetutës në lidhje me nenin 2 të KEDNJ-së; dhe
- (iii) të konstatojë se (mos)veprimet kumulative të autoriteteve shtetërore nuk kanë qenë në pajtueshmëri me nenet 50 dhe 51 të Konventës së për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës.

### Komentet e palëve kundërshtare

#### *(i) Komentet e Gjykatës Themelore në Gjilan*

71. Më 3 gusht 2021, Gjykata pranoi nga Gjykata Themelore dosjen e lëndës [P.nr. 1042/2019] përkitazi me procedurën e zhvilluar kundër L.S.-së dhe dosjen e lëndës [C.nr. 1002/2019] përkitazi me procedurën e shqiptimit të urdhrit mbrojtës.
72. Gjykata Themelore nuk ofroi komente përkitazi me kërkesën e parashtrueses së kërkesës por dosjeve të lartëkura të lëndëve i bashkëngjiti dokumentacionin si në vijim: (i) Kallëzimin Penal të Stacionit Policor në Gjilan për veprat penale “Dhunë në familje” dhe “Sulm” të 12 nëntorit 2019; (ii) Aktvendimin [PP. I. Nr. 1005437055] e Prokurorisë Themelore në Gjilan mbi ndalimin e personit të arrestuar L.S., të 12 nëntorit 2019; (iii) Dëftesën e Stacionit Policor në Gjilan mbi konfiskimin e pronës (brisk metalik ngjyrë kafe tehu 5 cm) të 12 nëntorit 2019; (iv) Vërtetimin [nr. 2019-CA-1336] e Stacionit Policor në Gjilan për bastisjen e shtëpisë të 12 nëntorit 2019; (v) Kërkesën [nr. 04/0106GJ-H-433/2019] e Stacionit Policor në Gjilan për Aprovim Retroaktiv Gjyqësor të Kontrollit të Shtëpisë dhe objekteve përcjellëse të dyshuarit L.S.-së të 12 nëntorit 2019; (vi) Aktvendimin [PP. II. 1835/19] e Prokurorisë Themelore në Gjilan për fillimin e hetimeve të 13 nëntorit 2019; (vii) Kërkesën [PP.II.nr.1835/2019] e Prokurorisë Themelore në Gjilan për caktimin e paraburgimit ndaj L.S.-së të 13 nëntorit 2019; (viii) Procesverbalin [PP.II.1835] e Prokurorisë Themelore në Gjilan të 18 nëntorit 2019, mbi marrjen në pyetje e të pandehurit; (ix) Procesverbalin [PP.II.1835] e Prokurorisë Themelore në Gjilan të 13 nëntorit 2019 mbi marrjen në pyetje e të dëmtuarës në cilësi të dëshmitares S.M.; (x) Parashtresën [PP.II.Nr.1835/2019] e mbrojtësit të viktimate për viktimën S.M. të 13 nëntorit 2019; (xi) Kërkesën e viktimit S.M. për shqiptimin e Urdhrit Mbrotjtës të 12 nëntorit 2019; (xii) Parashtresën e mbrojtësit të viktimate për djalin e viktimit S.M., me deklaratën e tij të 14 nëntorit 2021; (xiii) Procesverbalin [PPr.nr.206/2019] e seancës dëgjimore të 14 nëntorit 2019 për vazhdim të paraburgimit; (xiv) Aktvendimin [PPr.II.206/2019] për caktimin e paraburgimit të 14 nëntorit 2019; (xv) Ankesën e mbrojtësit të të pandehurit L.S., ndaj Aktvendimit [PPr.II.206/2019] për caktimin e paraburgimit të 14 nëntorit 2019; (xvi) Aktvendimin [PN.DP.nr.1291/2019] e Gjykatës së Apelit të Kosovës të 22 nëntorit 2019 që refuzon ankesën e mbrojtësit të të pandehurit L.S.; (xvii) Aktakuzën [PP.II.nr.1835/2019] e Prokurorisë Themelore në Gjilan, të 25 nëntorit 2019, ndaj të pandehurit L.S.; (xviii) Aktgjykimin [P.nr.1042/19] e Gjykatës Themelore të 27 janarit 2020, ndaj të pandehurit L.S.; (xix) Procesverbalin [C.nr. 1002/19] e Seancës Përgatitore të Gjykatës Themelore të 25 nëntorit 2019; dhe (xix) Aktvendimin [C.nr.1002/2019] e Gjykatës Themelore të 26 nëntorit 2019 për lëshimin e urdhrit për mbrojtje.

(ii) Komentet e Prokurorisë Themelore në Prishtinë

73. Më 11 gusht 2021, Gjykata pranoi nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, Njësiti për Dhunë në Familje, komentet përkatëse të përcjella me dokumentacionin si në vijim: (i) Shënim zyrtar për rastin 2021-AT-086 nga prokurorja e rastit; (ii) Aktin përcjellës [PPN/II.Nr.666/21] të Departamentit të Përgjithshëm drejtuar Departamentit për Krime të Rënda në kuadër të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, së bashku me Raportin e Veçantë, e pranuar në Prokurori më 11 maj 2021; (iii) Formularin e pranim-dorëzimit të rastit [2021-AT-86] nga Stacioni Policor në Graçanicë në IPK [Inspektoratin Policor të Kosovës]; (iv) Certifikatën vdekjes së të ndjerës S.M., të lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme; (v) Shkresën e Avokatit të Popullit drejtuar Prokurorisë Themelore në Prishtinë për rastin [A.nr.150/2021] e inicuar *Ex-officio* kundër Policisë së Kosovës, të 1 prillit 2021; dhe (vi) Përgjigjen e Prokurorisë Themelore në Prishtinë në shkresën e Avokatit të Popullit me referencë [A. nr.150/2021, dt. 01.04.2021].
74. Prokuroria Themelore në Prishtinë në komentet përkatëse fillimisht ofroi historikun procedural të rastit të të ndjerës S.M., dhe theksoi se e ndjera S.M., nuk ka pasur urdhër mbrojtës aktiv sepse i njëjti kishte pasur kohëzgjatje vetëm deri më 26 nëntor 2020.
75. Prokuroria Themelore në Prishtinë theksoi se në ditën kur kishte ndodhur vrasja, rasti i S.M.-së, ka qenë duke u trajtuar nga organet e drejtësisë dhe në ditën e raportimit të rastit, Prokuroria ishte në fazën e grumbullimit të provave dhe informatave të nevojshme për ndriçimin e rrethanave faktike që nuk kanë qenë të njohura për organet përkatëse.
76. Prokuroria Themelore në Prishtinë më tej specifikon se përkundër që e ndjera S.M., ka deklaruar se nuk është e interesuar të vazhdojë me ndjekjen penale, kjo nuk e ka ndaluar Prokurorinë që të ndërmarrë veprime tjera hetimore me qëllim të vërtetimit të veprës penale dhe gjendjes faktike dhe në mungesë të informatave dhe refuzimit të palës së dëmtuar për bashkëpunim të mëtejshmë, ka kërkuar informacione shtesë për të verifikuar arsyen e refuzimit të të ndjerës për të vazhduar me rastin.
77. Prokuroria Themelore në Prishtinë përfundon komentet duke theksuar se: “*Prokurori i rastit i cili merret vetëm me rastet dhunë në familje, ka ndërmarrë sipas kompetencave dhe autorizimeve, të gjitha veprimet e nevojshme hetimore dhe ligjore për të trajtuar këtë rast dhe si çdo herë është në mbrojtje dhe shërbim të sigurimit të jetës dhe të drejtave të çdo lloj kategorie kushtetuese të shoqërisë, veçmas të rasteve më të ndjeshme të dhunës në familje që janë rastet më të vështira dhe më të ndjeshme për trajtim sepse çdo herë prekin themelet e familjes dhe shoqërisë*”.

(iii) Komentet e Prokurorisë Themelore në Gjilan

78. Më 11 gusht 2021, Gjykata pranoi nga Prokuroria Themelore në Gjilan komentet lidhur me kërkësën, të përcjella me dokumentacion përkatës.
79. Prokuroria Themelore në Gjilan në komentet përkatëse fillimisht ofroi historikun procedural të rastit të të ndjerës S.M., duke shtuar se ka vepruar në tërsi në përputhje me dispozitat ligjore dhe se në asnjë rrethanë nuk ka neglizhuar rastin. Sipas Prokurorisë Themelore në Gjilan: (i) hetimi është përfunduar në afat të arsyeshëm kohor; (ii) kryerësi nuk ka shfaqur shenja të ndonjë çregullimi nga ana e shëndetit mendor; (iii) viktima ka pasur të angazhuar avokat; (iv) i pandehuri është

ndaluar e më pas edhe paraburgosur; (v) është njoftuar ZMNV në Gjilan; (vi) është lëshuar urdhri mbrojtës për kohëzgjatje prej dymbëdhjetë (12) muajve gjatë të cilës periudhë nuk është raportuar asnje shkelje e urdhrit; si dhe (vii) është njoftuar edhe QPS në Gjilan, e cila ka realizuar sesione këshilluese me të ndjerën S.M.

(iv) Komentet e Policisë së Kosovës

80. Më 11 gusht 2020, Gjykata pranoi komentet e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Kosovës lidhur me kërkesën, të përcjella me Raportin [DDO-04/1-229/2021] drejtar Koordinatores Nacionale Kundër Dhunës në Familje lidhur me "rekomandimet për Policinë e Kosovës nga Raporti i Avokatit të Popullit, e 18 majit 2021" (në tekstin e mëtejmë: Raporti i Policisë së Kosovës për rekombandimet e Avokatit të Popullit).
81. Policia e Kosovës në komentet përkatëse thekson se në reagim ndaj rekombandimeve nga raporti i Avokatit të Popullit, menjëherë ka themeluar komisionin profesional (*ad-hoc*) për t'i vlerësuar veprimet e zyrtarëve përgjegjës policor përkitazi me rastin e dhunës në familje të paraqitur me 3 mars 2021 në Stacionin Policor të Graçanicës dhe nëse të njëjtë kishin vepruar në pajtim me Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në familje, si dhe me Ligjin nr.03/L-182 për Mbrojtje nga Dhuna në Familje (GZ, numër 76, 10 gusht 2010). Po ashtu, Policia e Kosovës e njofton Gjykatën se me 12 maj 2021, ka iniciuar dhe zhvilluar procedurë (hetimore) administrative-disiplinore ndaj dy (2) zyrtarëve policorë nga Drejtoria e Standardeve Disiplinore të Policisë së Kosovës dhe është në pritje të vendimmarrjes nga Komisioni i Brendshëm Disiplinor i Policisë se Kosovës.
82. Policia e Kosovës në Raportin e saj për rekombandimet e Avokatit të Popullit thekson se:

*Me datën 07.05.2021 është themeluar komisioni profesional (*ad-hoc*) për ti vlerësuar veprimet e zyrtarëve përgjegjës policor përkitazi me rastin e dhunës në familje, i paraqitur me 3 mars 2021 në Stacionin Policor te Graçanicës.*

*Komisioni profesional (*ad-hoc*) me datën 11.05.2021 ka vizituuar stacionin policor Gracanicë për ti analizuar te gjitha shkresat e lendes dhe veprimet e zyrtarëve policore. Komisioni profesional ne raportin e përpiluar me datën 12.05.2021 ka gjetur disa veprime te cilat nuk janë ndërmarr nga zyrtaret përgjegjës policor te stacionit policor Gracanicë si me poshtë:*

- *Rasti nuk është trajtuar nga hetuesi i dhunës ne familje (zyrtarja qe trajton këto raste ka qene ne pushim vjetor) por rasti është trajtuar nga hetues tjetër;*
- *Hetuesi nuk i ka njoftuar institucionet tjera si janë qendra për punën sociale dhe mbrojtësi i viktimate;*
- *Nuk janë plotësuar format bazike, plotësimi i këtyre formave është obligim i Policisë se Kosovës, sipas Procedurave Standarde të Veprimit për mbrojtje nga dhuna ne familje. Kjo forme bazike e të dhënave duhet te jetë konfidenciale duhet të jete në shërbim vetëm për akterët ne procedure, pra kur viktima dërgohet ne strehimore apo dërgohet tek institucionet tjera për ndonjë shërbim, ndërsa ne rastet kur viktima nuk ka nevoje për strehim apo shërbime tjera, origjinali i formës ruhet ne dosjen e rastit;*
- *Nuk është kryer vlerësimi i rrezikshmërisë për rastin dhe nuk është plotësuar forma e vlerësimit te rrezikshmërisë;*
- *Nuk është plotësuar lista e kontrollit, e cila kërkohet sipas procedurës standarde te veprimit nacionalë dhe e cila ndihmon Policin e Kosovës qe mos te lëshoj ndonjë gabim eventual gjate trajtimit te rasteve te dhunës ne familje;*
- *Nuk është evidentuar, nëse është këshilluar viktima për planin e sigurisë, i cili është shume i rëndësishëm për viktimin e dhunës ne familje.*

## **Komentet e Avokatit të Popullit dhe Raporti ex officio**

83. Më 19 gusht 2021, Gjykata pranoi nga Avokati i Popullit letrën përcjellëse të tij në lidhje me kërkesën, të përcjellë me Raportin e tij "Ex-Officio nr. 150/21 përkitazi me detyrimet pozitive të shtetit për të drejtën në jetë dhe mbrojtjen nga dhuna në familje", të publikuar më 27 prill 2021.
84. Në letrën e tij përcjellëse, Avokati i Popullit e njofton Gjykatën se lidhur me këtë çështje më 19 mars 2021 ka hapur rast *Ex-Officio* nr. 150/2021 dhe më 27 prill 2021 ka publikuar Raportin e tij me rekomandime për institucionet përkatëse, gjegjësisht Policinë e Kosovës, Këshillin Gjyqësor, Këshillin Prokurorial dhe ZMNV-në.

*Raporti ex officio i Avokatit të Popullit "përkitazi me detyrimet pozitive të shtetit për të drejtën në jetë dhe mbrojtjen nga dhuna në familje"*

85. Raporti i Avokatit të Popullit përmban: (i) qëllimin e raportit; (ii) kompetencën e Avokatit të Popullit të përcaktua me Kushtetutë dhe Ligjin për Avokatin e Popullit (GZ, numër 16, 26 qershor 2015), për të filluar një hetim të tillë; (iii) Veprimet e Institucionit të Avokatit të Popullit; (iv) Bazën ligjore, e cila përmban dispozita përkatëse të Kushtetutës, Konventave Ndërkombëtare, legjisacionit në fuqi në Republikën e Kosovës, Strategjinë Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Planin e Veprimit [2016-2020]; (v) Analizën Ligjore; (vi) Konstatimet; dhe (vii) Rekomandimet.
86. Në Raport theksohet se më 25 mars 2021, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit bisedoi me psikiatren përgjegjëse të Repartit Psikiatrik të Spitalit të Përgjithshëm në Gjilan, për të cilën viktima S.M., kishte deklaruar se e kishte trajtuar bashkëshortin e saj L.S. Para përfaqësuesit të Avokatit të Populli, psikiatrja deklaroi se personin L.S., e kishte trajtuar diku para disa vitesh në ambulancë specialistike të Repartit Psikiatrik dhe të njëjtit i kishte përshkruar terapi përkatëse. Me tej, psikiatrja sqaroi se në fund të vitit 2019, sërisht e kishte vizituar L.S.-në, por kësaj radhe në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan, pasi i njëjti ishte paraburgosur sepse kishte ushtruar dhunë fizike dhe psikike kundër S.M.-së. Pas kësaj, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit bisedoi me zyrtaret përgjegjës të Qendrës së Shëndetit Mendor në Gjilan, nga të cilët kërkoi informacione nëse L.S. ishte trajtuar në këtë qendër dhe kishte marrë përgjigje se L.S. asnëherë nuk ishte pacient i kësaj qendre.
87. Tësia, Raporti i Avokatit të Popullit numëron bazën kushtetuese dhe ligjore për mbrojtjen e të drejtës në jetë dhe detyrimet e shtetit përkitazi me garantimin e kësaj të drejtë dhe parandalimit dhe luftimit të dhunës në familje, duke theksuar dispozitat relevante të Kushtetutës, KEDNJ-së, Konventës së Stambollit, Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, Ligjet Nr.03/L-182 për Mbrojtje nga Dhuna në Familje (në tekstin e mëtejmë: Ligji për Mbrojtje nga Dhuna në Familje), Ligjet Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare (GZ, numër 12, 1 maj 2007) (në tekstin e mëtejmë: Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare), Ligjet Nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimate të Krimít (GZ, numër 17, 30 qershor 2015) (në tekstin e mëtejmë: Ligji për Kompensimin e Viktimate të Krimít), Udhëzimit Administrativ (QRK) – Nr. 01/2017 për Mënyrën e Kompensimit përfshire edhe Llogaritjen e Kompensimit për Dëmtimet e Shumëfishta (në tekstin e mëtejmë: Udhëzimi Administrativ për Mënyrën dhe Llogaritjen e Kompensimit të Dëmtimeve të Shumëfishta), Udhëzimit Administrativ Nr. 12/2012 për Përcaktimin e Vendit dhe Mënyrës së Trajtimit Psikosocial të Kryerësit të Dhunës në Familje (Udhëzimi Administrativ Përcaktimin e Vendit për Trajtimin Psikosocial të Kryerësit të Dhunës në Familje), si dhe Strategjinë Kombëtare të Republikës së Kosovës për Mbrojtje nga

Dhuna në Familje dhe Planin e Veprimit 2016-2020 (në tekstin e mëtejmi: Strategjia për Mbrojtje nga Dhuna në Familje).

88. Në raportin e tij, Avokati i Popullit, përkitazi me aplikimin e dispozitave relevante kushtetuese në rastin konkret, pretendon se: “[...] si pasojë e neglizhencës dhe joprofesionalizmit të autoriteteve gjegjëse, si në rastin e parë kur viktima S.M. e kishte paraqitur rastin në Gjilan; si në rastin e dytë kur vajza e viktimës S.M. e kishte paraqitur rastin në SP në Graçanicë, viktima ishte përballur me neglizhencë apo joprofesionalizëm të autoriteteve, prandaj kjo ngjarje kishte epilog fatal”.
89. Gjithashtu, Raporti i Avokatit të Popullit thekson se Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, dokument i cili përcakton listën e kontrollit të veprimet që duhet ndërmarrë gjatë trajtimit të rasteve të dhunës në familje, sipas Avokatit të Popullit, ishte neglizhuar nga zyrtarët përgjegjës në Stacionin Policor në Graçanicë, të cilët, gjatë trajtimit të rastit të së ndjerës S.M., nuk kishin njoftuar QPS-në, mbrojtësin e viktimave apo përfaqësuesin ligjor të viktimës dhe nuk kanë përpiluar raportin.
90. Në raportin e tij, Avokati i Popullit, konstaton se në rastin konkret: (i) nuk janë respektuar Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje; (ii) autoritetet përgjegjëse nuk e kishin vlerësuar mjaftueshëm rrezikun potencial të rastit edhe pse viktima kishte deklaruar vazhdimësinë e veprimeve të L.S. dhe kishte dhënë indikacione të problemeve me shëndetin mendor; (iii) kishte munguar koordinimi i veprimeve ndërmjet autoriteteve; (iv) zyrtarët policorë në Stacionin Policor në Graçanicë nuk kishin njoftuar mbrojtësin e viktimave si dhe nuk kishin përpiluar ndonjë plan për sigurinë për viktimën; dhe (v) me gjithë numrin e madh të akteve ligjore që i referohen mbrojtjes nga dhuna në familje, instrumenteve ndërkontaktore që janë të zbatueshme në vendin tonë, si dhe një mori të akteve të tjera dhe deklarimeve të vazhdueshme të zyrtarëve qeveritarë për luftimin e dhunës në familje, duket se nuk janë përmbushur pritet legjitime në këtë rast.
91. Në raportin e tij, Avokati i Popullit nxori Rekomandimet si në vijim:
1. *Policisë së Kosovës i rekomandoi që:*
    - (i) që të formojë komision profesional (*ad-hoc*) për të vlerësuar veprimet e zyrtarëve policorë përkitazi me rastin e dhunës në familje, i paraqitur më 3 mars 2021, në Stacionin policor të Graçanicës, nëse të njëjtët kishin vepruar në përputhje me Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, si dhe Ligjin për Mbrojtje nga Dhuna në Familje;
    - (ii) të kërkojë nga të gjitha stacionet policore që në raste kur ballafaqohen me raportim të dhunës në familje, zyrtarët përgjegjës të veprojnë në pajtim me Procedurat Standarde të Veprimit;
    - (iii) të kërkojnë nga të gjitha stacionet policore që në raste kur ballafaqohen me raportim të dhunës në familje, zyrtarët përgjegjës të veprojnë në pajtim me nenin 24 të Ligjit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje.
  2. *Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës i rekomandoi që:*
    - (i) “nëpërmjet Akademisë së Drejtësisë, të organizohen module të veçanta trajnimi për gjyqtarë dhe prokurorë për vlerësimin e rrezikshmërisë së rasteve të tillë dhe masat që duhet ndërmarrë për pengimin e dhunës në familje.”
    - (ii) Këshillit Gjyqësor i kërkojë nga të gjithë gjykatësit që në të gjitha rastet kur marrin vendim për urdhërmbrojtje, të veprojnë në

pajtim me nenin 17, paragrafin 2 të Ligjit o3/L-182 për Mbrojtje nga Dhuna në Familje”.

3. Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave (ZMN) i rekomandoi që “nëpërmjet trajnimeve adekuate, të ngrejë kapacitet profesionale të mbrojtësve të viktimave, që gjatë ushtrimit të detyrave të punës të jenë në gjendje ti kuptojnë nevojat e viktimave të dhunës në familje dhe trajtin e palëve përgjegjëse, që situata e dhunës në familje të mos përsëriten”.
92. Në fund të Raportit të Avokatit të Popullit, ky i fundit duke u bazuar në paragrafin 3 të nenit 132 të Kushtetutës dhe nenin 28 të Ligjit për Avokatin e Popullit, njoftoi institucionet e lartcekura përkizazi me obligimin e tyre për dorëzimin e përgjigjeve dhe informacionin përkatës në lidhje me veprimet e ndërmarra që dalin nga rekomandimet e këtij Raporti.

### **Dispozitat përkatëse kushtetuese dhe ligjore**

#### **KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

**Neni 22**

**[Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare]**

Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike:

- (1) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;
- (2) Konventa Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj;
- (3) Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj;
- (4) Konventa Kornizë e Këshillit të Europës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare;
- (5) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor;
- (6) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas;
- (7) Konventa për të Drejtat e Fémijës;
- (8) Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese.

**Amendamenti nr. 26 [i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 25 shtator 2020, i publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më 30 shtator 2020].**

Në nenin 22, pas paragrafit (8) shtohet paragrafi (9), si në vijim:

- (9) Konventa e Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje.

**Neni 25**  
**[E Drejta për Jetën]**

1. Secili individ gjëzon të drejtën për jetën.
2. Dënim i vdekje është i ndaluar.

## **KONVENTA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT**

### **Neni 2 (E drejta për jetën)**

1. *E drejta e çdo njeriu për jetën mbrohet me ligj. Askujt nuk mund t'i merretjeta qëllimisht, me përjashtim të rastit kur zbatohet një vendim gjyqësor me vdekje, pas dënimit për një krim për të cilin ky dënim është parashikuar me ligj.*  
[...]

## **KONVENTA PËR ELIMINIMIN E TE GJITHA FORMAVE TE DISKRIMINIMIT NDAJ GRAVE** [e miratuar në vitin 1979 nga Asambleja e Kombeve të Bashkuara]

### **Neni 1 (pa titull)**

*Për qëllimet e kësaj Konverte shprehja “diskriminimi ndaj grave” nënkupton çdo dallim, përjashtim ose kufizim që bëhet mbi bazën e gjinisë, e që ka për pasojë ose për qëllim të komprometojë ose të asgjësojë njohjen, gëzimin ose ushtrimin nga gratë, pavarësisht nga gjendja e tyre martesore, mbi bazën e barazisë së burrit dhe të gruas, të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut në fushën politike, ekonomike, shoqërore, kulturore, civile ose në çdo fushë tjetër.*

### **Neni 2 (Pa titull)**

*Shtetet palë dënojnë diskriminimin ndaj grave në të gjitha format, pranojnë të ndjekin me të gjitha mjetet e përshtatshme dhe pa vonesë një politikë të eliminimit të diskriminimit kundrejt grave dhe për këtë arsyе zotohen:*

[...]  
(c) të vendosin një mbrojtje gjyqësore të të drejtave të grave mbi bazën e barabartë me burrat dhe të sigurojnë. nëpërmjet gjykatave kombëtare kompetente dhe institucioneve të tjera publike, mbrojtjen efektive të grave kundër çdo veprimi diskriminues [...]

## **KONVENTA E KËSHILLIT TË EVROPËS PËR PARANDALIMIN DHE LUFTIMIN E DHUNËS KUNDËR GRAVE DHE DHUNËS NË FAMILJE** [e miratuar më 7 prill 2011 nga Këshilli i Evropës si dhe e përfshirë në listën e Konventave dhe instrumenteve ndërkombëtare ligjore në nenin 22 të Kushtetutës përmes Amendamentit nr. 26, të 28 shtatorit 2020]

### **Kapitulli IV Mbrojtja dhe mbështetja**

#### **Neni 18 Detyrimet e përgjithshme**

*1 Palët marrin masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për të mbrojtur të gjitha viktimat nga akte të mëtejshme dhune.*

*2 Palët marrin masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera në pajtim me ligjin e rendshëm, për të garantuar ekzistencën e mekanizmave të duhur për të parashikuar bashkëpunim efektiv midis të gjitha agjencive shtetërore përkatëse, duke përfshirë gjyqësorin, prokurorët publikë, agjencitë e zbatimit të ligjit,*

*autoritetet vendore dhe rajonale, si dhe organizatat joqeveritare dhe organizata dhe ente të tjera përkatëse, në mbrojtje dhe mbështetje të viktimave dhe dëshmitarëve të të gjitha formave të dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konverte, duke përfshirë ato me anë të referencës ndaj shërbimeve të përgjithshme dhe mbështetëse të specializuara, siç përcaktohen hollësisht në Nenet 20 dhe 22 të kësaj Konverte.*

*3 Palët garantojnë që masat e marra sipas këtij kapitulli: – të bazohen në një perceptim gjinor të dhunës kundër grave dhe dhunës në familje dhe të fokusohen tek të drejtat e njeriut dhe siguria e viktimës; – të bazohen në një përqasje të integruar, e cila merr parasysh marrëdhënien midis viktimave, autorëve të veprave penale, fëmijëve dhe mjedisit të tyre më të gjerë social; – të synojnë shmangjen e viktinizimit dytësor; – të synojnë fuqizimin dhe pavarësinë ekonomike të grave, viktima të dhunës; – të lejojnë, sipas rastit, një gamë mbrojtjeje dhe shërbimesh mbështetëse që duhet të vendosen në të njëjtat ambiente; – të trajtojnë nevojat specifike të personave të pambrojtur, duke përfshirë viktimat fëmijë dhe t'u vihen në dispozicion.*

*4 Sigurimi i shërbimeve nuk varet nga gatishmëria e viktimës për të ngritur akuza ose për të dëshmuar kundër një autori vepre penale.*

*5 Palët marrin masat e duhura për të ofruar mbrojtje konsullore dhe mbrojtje dhe mbështetje tjeter për shtetasit e tyre dhe viktima të tjera që kanë të drejtën e kësaj mbrojtjeje, në përputhje me detyrimet e tyre sipas të drejtës ndërkombëtare.*

[...]

### **Neni 29 Paditë civile dhe mjetet ligjore**

*1. Palët marrin masat e nevojshme legjislativë ose masa të tjera për t'u ofruar viktimave mjetet ligjore të mjaftueshme civile kundër autorit të veprës penale.*

*2. Palët marrin masat e nevojshme legjislativë ose masa të tjera për t'u ofruar viktimave, në përputhje me parimet e përgjithshme të të drejtës ndërkombëtare, mjetet ligjore të mjaftueshme civile kundër autoriteteve Shtetërore që nuk kanë mundur të përbushin detyrën e tyre për të marrë masa të nevojshme parandaluese ose mbrojtëse brenda objektit të kompetencave të tyre.*

### **Neni 30 Kompensimi**

*1. Palët marrin masat e nevojshme legjislativë ose masa të tjera për të garantuar që viktimat të kenë të drejtë për të kërkuar kompensim nga autorët për çdo shkelje të përcaktuar në pajtim me këtë Konventë.*

*2. Kompensimi i mjaftueshmëri nga Shteti i jepet atyre që kanë pësuar dëme të rënda trupore ose dëme ndaj shëndetit, në shkallën që dëmi nuk mbulohet nga burime të tjera, si për shembull masa për autorët e veprave penale, sigurimin ose masa sociale ose shëndetësore të finançuara nga shteti. Kjo nuk pengon Palët që të kërkojnë kthim për kompensimin e dhënë nga autori i veprës penale, për sa kohë që i kushtohet rëndësia e duhur sigurisë së viktimës.*

*3. Masat e marra sipas paragrafit 2 garantojnë dhënien e kompensimit brenda një afati kohor të arsyeshëm.*

### **Neni 50 Reagim, parandalim dhe mbrojtje të menjëhershme**

*1. Palët marrin masat e nevojshme legjislativë apo të tjera për të siguruar që agjencitë përgjegjëse të zbatimit të ligjit të përgjigjen ndaj të gjitha formave të*

*dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konvente menjëherë dhe në mënyrë të përshtatshme duke ofruar mbrojtje të mjaftueshme dhe të menjëhershme për viktimat.*

*2. Palët marrin masat e nevojshme legjislatieve apo të tjera për të siguruar që agjencitë përgjegjëse të zbatimit të ligjit të angazhohen menjëherë dhe në mënyrë të përshtatshme në parandalimin dhe mbrojtjen kundër të gjitha formave të dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konvete, duke përfshirë përdorimin e masave parandaluese operacionale dhe mbledhjen e provave.*

### **Neni 51** **Vlerësimi i rrezikut dhe menaxhimi i rrezikut**

*1. Palët marrin masat e nevojshme legjislatieve apo të tjera për të siguruar që një vlerësim i rrezikut vdekjeprurës, seriozitetit të situatës dhe rrezikut të dhunës së përsëritur të kryhet nga të gjitha autoritetet përkatëse për të menaxhuar rrezikun dhe nëse është e nevojshme për të siguruar mbështetje dhe siguri të koordinuar.*

*2. Palët marrin masat e nevojshme legjislatieve apo të tjera për të siguruar që vlerësimi i përmendur në paragrafin 1 merr parasysh siç duhet, në të gjitha fazat e hetimit dhe zbatimit të masave mbrojtëse, faktin se autorët e akteve të dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konventë zotërojnë ose kanë akses të armëve të zjarrit.*

### **Neni 55** **Procedimet *ex parte* dhe *ex officio***

*1. Palët sigurojnë që hetimet ose ndjekja penale e veprave penale të parashikuara në përputhje me nenet 35, 36, 37, 38 dhe 39 të kësaj Konvete nuk do të jenë tërësish të varura nga një raport ose ankesë e paraqitur nga një viktimë, nëse vepra penale ishte kryer tërësish ose pjesërisht në territorin e saj, dhe se procedimi mund të vazhdojë edhe nëse viktima e tërheq deklaratën ose ankesën e tij ose saj.*

*2. Palët marrin masat e nevojshme legjislatieve apo të tjera për të siguruar, në përputhje me kushtet e parashikuara nga ligji i tyre i brendshëm, mundësinë për organizatat qeveritare dhe jo-qeveritare dhe këshilltarët mbi dhunën në familje për të ndihmuar dhe / ose mbështetur viktimat, me kërkësë të tyre, gjatë hetimeve dhe procedimeve gjyqësore në lidhje me veprat penale të parashikuara në pajtim me këtë Konventë.*

### **Neni 56** **Masat e mbrojtjes**

*1. Palët marrin masat e nevojshme legjislatieve apo të tjera për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e viktimateve, duke përfshirë nevojat e tyre të veçanta si dëshmitarë, në të gjitha fazat e hetimeve dhe procedimeve gjyqësore, në veçanti:*

*a duke ofruar mbrojtjen e tyre, si dhe atë të familjeve të tyre dhe të dëshmitarëve, nga hakmarrja, kërcënimi dhe viktimidimi i përsëritur;*

*b duke siguruar që viktimat të informohen, të paktën në rastet kur viktima dhe familja mund të jetë në rrezik, kur autori i veprës arratiset ose lirohet përkohësisht ose përfundimisht;*

*c duke i informuar ata, sipas kushteve të parashikuara nga ligji i brendshëm, për të drejtat e tyre dhe shërbimet në dispozicion të tyre dhe shqyrtimin e ankesës së tyre, akuzat, ecurinë e përgjithshme të hetimit ose të procedimit, dhe rolin e tyre në to, si dhe rezultatin e çështjes së tyre;*

*d duke bërë të mundur që viktimat, në mënyrë të pajtueshme me rregullat procedurale të ligjit të brendshëm, të dëgjohen, të sigurojnë prova dhe të paraqesin pikëpamjet, nevojat dhe shqetësimet e tyre, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet një ndërmjetësi, si dhe marrjen e tyre në shqyrtim;*

e duke u sigruuar viktimate shërbime mbështetëse të duhura në mënyrë që të drejtat dhe interesat e tyre të paraqiten siç duhet dhe të merren parasysh; f duke sigruuar që masat mund të miratohen për të mbrojtur jetën private dhe imazhin e viktimit;

g duke sigruuar që kontakti ndërmjet viktimate dhe autorëve të veprës brenda gjykatës dhe zyrave të agjencisë së zbatimit të ligjit të shmanget kur është e mundur;

h duke u sigruuar viktimate përkthyes të pavarur dhe kompetentë, kur viktimat janë palë në procedim ose kur ata sigurojnë prova;

i duke bërë të mundur që viktimat të dëshmojnë, sipas rregullave të parashikuara nga ligji i tyre i brendshëm, në sallën e gjyqit pa qenë të pranishëm ose të paktën pa praninë e autorit të dyshuar të veprës, veçanërisht nëpërmjet përdorimit të teknologjive të përshtatshme të komunikimit, kur janë në dispozicion.

2. Një fëmije viktimë dhe dëshmitar i dhunës kundër grave dhe dhunës në familje i sigurohen, kur është e përshtatshme, masa të posaçme mbrojtjeje duke marrë parasysh interesin më të mirë të fëmijës.

## Kapitulli IX – Mekanizmi i monitorimit

### Neni 66

Grupi i ekspertëve për masat kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje

1 Grupi i ekspertëve për masat kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (më poshtë referuar si "GREVIO") monitoron zbatimin e kësaj Konvente nga Palët.

2 GREVIO përbëhet nga një minimum prej 10 anëtarësh dhe një maksimum prej 15 anëtarësh, duke marrë parasysh një balance gjinore dhe gjeografike, si dhe ekspertizën multidisiplinore. Anëtarët e saj zgjidhen nga Komiteti i Palëve nga radhët e kandidatëve të nominuar nga Palët për një mandat prej katër vjetësh, i rinovueshëm një herë, dhe zgjidhen nga shtetasit e Palëve.

[...]

## KODI PENAL o6/L-074 I REPUBLIKËS SË KOSOVËS [I PUBLIKUAR NË GAZETËN ZYRTARE MË 14 JANAR 2019]

### Neni 248

#### Dhuna në familje

1. Kushdo që e kryen dhunën ose keqtrajtimin fizik, psikologjik ose ekonomik me qëllim të cenimit të dinjitetit të personit tjeter brenda një marrëdhënieje familjare, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në 3 (tre) vjet.

2. Kur çfarëdo vepre në Kodin Penal kryhet brenda marrëdhënieve familjare, do të konsiderohet si rrethanë rënduese.

3. Çdo anëtar i familjes që ushton dhunë ose keqtrajtim fizik, psikologjik, seksual ose ekonomik ndaj anëtarit tjeter të familjes së tij/saj, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet.

3.1. "Marrëdhënia familjare" për nevojat e kësaj dispozite është në përputhshmëri me përkufizimin në nenin 113 të këtij kodit.

3.2. Dhuna në familje, dhuna fizike, psikologjike, seksuale dhe ekonomike, për nevojat e këtij kodit do të jetë e njëjtë siç është përkufizuar ne dispozitën e nenit 2, nën paragrafi 1.2. të Ligjit nr. 03/L-182 për mbrojtje nga Dhuna në Familje.

**LIGJI NR. 03/L-182 PËR MBROJTJEN KUNDËR DHUNËS NË FAMILJE  
[I PUBLIKUAR NË GAZETËN ZYRTARE MË 10 GUSHT 2010]**

**Neni 1  
Qëllimi i ligjit**

*1. Ky ligj ka për qëllim parandalimin e dhunës në familje, në të gjitha format e saj, me masa të përshtatshme ligjore, të pjesëtarëve të familjes, që janë viktima të dhunës në familje, duke u kushtuar vëmendje të veçantë fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara.*

*2. Ky ligj, po ashtu, ka për qëllim edhe trajtimin e kryerësve të dhunës në familje dhe lehtësimin e pasojave.*

**Neni 2  
Përkufizimet**

*1.2. Dhunë ne familje - një ose më shumë vepra apo lëshime të qëllimshme që i bën një person personit tjeter me të cilin është ose ka qenë në marrëdhënie familjare si këto, por nuk kufizohet në:*

[...]

*1.3. Pala e mbrojtur - personi ndaj të cilit është ushtruar dhuna në familje dhe vartësit në dobi të të cilit është kërkuar urdhri për mbrojtje, urdhri për mbrojtje emergjente ose urdhri për mbrojtjen e përkohshme emergjente.*

[...]

*1.5. Kryerësi i dhunës në familje - personi, i cili ka kryer një apo me tepër vepra të dhunës në familje, kundër të cilit kërkohet urdhri për mbrojtje, urdhri për mbrojtje emergjente. ose urdhri për mbrojtjen e përkohshme emergjente.*

*1.6. Victimë - personi i cili i është nënshtuar dhunës në familje.*

[...]

*2.8. Mbrojtësi i viktimate - personi i autorizuar zyrtar i cili ndihmon drejtpërdrejtë palën e dëmtuar që nga kontaktet e para me organet kompetente të mbrojtjes, këshillon, iniciion procedurat për caktimin e masave të mbrojtjes, është i obliguar të marr pjesë në të gjitha seancat gjyqësore, të monitoroj mbarëvajtjen e procesit gjyqësor.*

*1.9. Urdhër mbrojtje - urdhri i lëshuar me vendim gjykate, ku parashikohen masat mbrojtëse për viktimen.*

[...]

**Neni 4  
Masa mbrojtëse e trajtimit psikosocial**

*1. Masa mbrojtëse e trajtimit psikosocial, mund ti shqiptohet kryesit të dhunës në familje në kombinim me ndonjë masë tjeter parandaluese, me qëllim të evitimit të sjelljeve të dhunshme të kryerësit apo nëse ekziston rrezik i përsëritjes së dhunës në familje.*

*2. Masa nga paragrafi 1 i këtij nenit, zgjatë derisa të përfundojnë shkaqet mbi bazën e të cilave është shqiptuar, por nuk mund të zgjasë më shumë se gjashtë muaj.*

*3. Ministria përgjegjëse për mirëqenie sociale në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për Shëndetësi dhe institucionet përkatëse përgatisin dhe propozojnë për aprovim në Qeveri aktin nënligjor me të cilin përcaktohet mënyra dhe vendi i zbatimit të trajtimit psikosocial.*

**Neni 13  
Kërkesat për urdhër mbrojtje ose urdhër mbrojtje emergjente**

*1. Kërkesën për urdhër mbrojtje mund ta paraqesë:*

- 1.1. pala e mbrojtur;
  - 1.2. përfaqësuesi i autorizuar i palës së mbrojtur;
  - 1.3. mbrojtësi i viktimave me pëlqimin e palës së mbrojtur;
  - 1.4. përfaqësuesi i qendrës për punë sociale në komunën ku pala e mbrojtur ka vendbanimin apo vendqëndrimin në rastet kur viktimi është i mituri.
- [...]

### Neni 17

#### **Shqiptimi i urdhër mbrojtjes dhe urdhër mbrojtjes emergjente**

1. Gjykata kompetente e shqipton urdhër mbrojtjen apo urdhër mbrojtjen emergjente, në rastet kur dyshon se kryerësi i dhunës pashmangshëm rrezikon sigurinë, shëndetin ose mirëqenien e palës së mbrojtur dhe personit me të cilin pala e mbrojtur ka lidhje familjare dhe i cili duhet të mbrohet me anë të urdhër mbrojtjes apo urdhër mbrojtjes emergjente.
2. Vendimi për urdhër mbrojtje ose urdhër mbrojtje emergjente ekzekutohet menjëherë me vendim përkatës, i shqiptuar nga Gjykata kompetente dhe i `u dërgohet menjëherë kryerësit të dhunës në familje Policisë së Kosovës, qendrave për punë sociale, si dhe palëve të tjera në procedurë.
3. Pas skadimit të urdhër mbrojtjes ose urdhër mbrojtjes emergjente, pushojnë të gjitha kufizimet e shqiptuara.

### Neni 18

#### **Përbajtja e urdhrit mbrojtës dhe urdhrit për mbrojtje emergjente**

1. Në urdhrin për mbrojtje duhet të ceket:
    - 1.1. masa mbrojtëse e caktuar nga gjykata;
    - 1.2. moszbatimi i urdhrit mbrojtës është vepër penale;
    - 1.3. njoftimi për të drejtën e ankesës;
    - 1.4. njoftimi se kryerësit të dhunës mund t'i ofroj ndihmë përfaqësuesi i autorizuar.
  2. Kohëzgjatja e urdhrit për mbrojtje nuk mund të jetë më e gjatë se dy mbëdhjetë (12) muaj por me mundësi vazhdimi jo më shumë se njëzetkatër (24) muaj.
- [...]

### Neni 20

#### **Ndryshimi, ndërprerja dhe vazhdimi i urdhër mbrojtjes**

1. Kur rrëthanat kanë ndryshuar, pala e mbrojtur ose kryesi i dhunës mund t'i parashtrojë kërkesë gjykatës, për ndryshimin ose ndërprerjen e urdhrit për mbrojtje, me ç'rast gjykata mund të vendosë që urdhri për mbrojtje:
  - 1.1. të mbetet në fuqi;
  - 1.2. të ndryshohet;
  - 1.3. të ndërpritet, nëse gjykata vlerëson se kanë pushuar të gjitha shkaqet mbi bazën e të cilave është shqiptuar urdhri mbrojtës.
2. Parashtrimi i kërkesës për ndryshimin ose ndërprerjen e urdhrit për mbrojtje, nuk e ndalon ekzekutimin e urdhrit për mbrojtje.
3. Pesëmbëdhjetë ditë para skadimit të urdhrit për mbrojtje, pala e mbrojtur ose përfaqësuesi i autorizuar, mund të parashtrojë kërkesën për vazhdimin e urdhrit për mbrojtje. Nëse nuk parashtron kërkesa për vazhdimin e urdhrit për mbrojtje, ai ndërpritet menjëherë në ditën e skadimit.
4. Pas marrjes së kërkesës për vazhdimin e urdhrit për mbrojtje, gjykata mund:
  - 4.1. të ndërpres urdhrin për mbrojtje në datën e skadimit të tij; ose
  - 4.2. të vendosë që të vazhdohet urdhri për mbrojtje, nëse nuk kanë pushuar shkaqet mbi bazën e të cilave është shqiptuar masa mbrojtëse.

## **Neni 22** **Urdhri për mbrojtjen e përkohshme emergjente**

1. Jashtë orarit të punës së gjykatave, kërkesa për urdhër të mbrojtjes së përkohshme emergjente mund t'i paraqitet Policisë së Kosovës nga :
  - 1.1 pala e mbrojtur;
  - 1.2. përfaqësuesi i autorizuar, ose mbrojtësi i viktimave;
  - 1.3. personi me të cilin pala e mbrojtur ka lidhje familjare;
  - 1.4. përfaqësuesi i qendrës për punë sociale ku ka vendbanimin ose vendqëndrimin pala e mbrojtur;
  - 1.5. personi i cili është në dijeni të drejtë për drejtë për një vepër ose më shumë vepra të dhunës në familje ndaj kërkuesit.
2. Kohëzgjatja e urdhrit të përkohshëm emergjent skadon në fund të ditës së ardhshme gjatë të cilës gjykata punon.
3. Shefi i njësitit rajonal të Policisë së Kosovës kundër dhunës në familje, mund të shqiptojë urdhrin për mbrojtje të përkohshme emergjente dhe të caktojë një ose disa prej masave të përmendura në nenet 5,6,7 dhe 10 të këtij ligji, nëse ai ose ajo vërteton se:
  - 3.1. ekzistojnë baza për të besuar se kryesi ka kryer ose është kërcënuar se do të kryejë ndonjë vepër të dhunës në familje;
  - 3.2. kryesi i dhunës paraqet kërcënim të drejtpërdrejtë dhe të atypëratyshëm për sigurinë, shëndetin dhe mirëqenien e palës së mbrojtur ose të personit me të cilin pala e mbrojtur ka lidhje familjare, të cilët duhet të mbrohen me anë të urdhrit për mbrojtje dhe
  - 3.3. shqiptimi i urdhrit për mbrojtje të përkohshme emergjente është i domosdoshëm për të siguruar shëndetin ose mirëqenien e palës së mbrojtur ose të personit me të cilin pala e mbrojtur ka lidhje familjare, e që duhet të mbrohen me anë të urdhërit për mbrojtje.
4. Kërkesa për urdhër mbrojtje të përkohshme emergjente mund t'i paraqitet Policisë së Kosovës edhe nga OJQ-të, që kanë njoftime të sigurta për dhunën në familje dhe që janë familjarizuar me viktimën.

## **Neni 24** **Përgjegjësitet e Policisë së Kosovës**

1. Policia e Kosovës duhet t'i përgjigjet secilit njoftim për veprat ose kërcënimet e dhunës në familje ose shkeljes së urdhrit për mbrojtje apo të urdhrit për mbrojtje emergjente pa marrë parasysh se kush e bën njoftimin.
2. Nëse ekziston dyshimi i arsyeshëm se është kryer vepra që ka të bëjë me dhunën në familje, Policia e Kosovës e ndalon kryerësin e supozuar në pajtim me ligjin.
3. Policia e Kosovës përdor mjete të arsyeshme për të mbrojtur viktimën dhe për të parandaluar dhunën, përfshirë, por duke mos u kufizuar vetëm në:
  - 3.1. sigurimin e linjës së posaçme telefonike për raportim të dhunës në familje;
  - 3.2. informimin e viktimës, përfaqësuesin ligjor ose mbrojtësin e viktimës për të drejtat e tij në përputhje me këtë ligj, por edhe me të drejtën për të kërkuar urdhrin për mbrojtje të përkohshme sipas nenit 22 të këtij ligji;
  - 3.3. informimin e viktimës lidhur me shërbimet e ndihmës ligjore, psikologjike dhe ndihmave të tjera në dispozicion nga institucionet qeveritare si dhe prej rrjetit të autorizuar të organizatave joqeveritare të cilat ofrojnë shërbime për viktimat;
  - 3.4. informimin e ofruesve përkatës të shërbimeve të përmendura sipas paragrafit 3.2 të këtij neni lidhur me ndonjë rast të dhunës në familje dhe mundësimin e kontaktit mes ofruesit të shërbimit dhe viktimës me kërkeshën e viktimës;
  - 3.5. sigurimin e transportimit të viktimës dhe vartësue të saj deri në objektin e duhur mjekësor për trajtim ose kontrollim mjekësor;

- 3.6. sigurimin e transportimit të viktimiës, e sipas nevojës edhe vartësve të saj deri në një vendstrehim apo vendqëndrim tjetër të përshtatshëm dhe të sigurt, me kërkesën e viktimiës;
- 3.7. nëse paraqitet nevoja, sigurimin e mbrojtjes për atë që ka lajmëruar dhunën në përputhje me obligimet përkatëse ligjore lidhur me mbrojtjen e dëshmitarëve;
- 3.8. largimin e të pandehurit nga banesa ku e ka vendbanimin ose vendqëndrimin e palës së mbrojtur apo ndonjë pjese të saj në rastin kur me anë të urdhrit për mbrojtje ose urdhrit për mbrojtje emergjente caktohet masa e paraparë në nenin 7 të këtij ligji;
- 3.9. sigurimin e kontaktit zyrtar për viktimen ose përfaqësuesin e saj ligjor me nëpunësin hetues në kuadër të Policisë së Kosovës nëse kërkohet ndihma e mëtejshme. Nëse mungon nëpunësi hetues, atëherë ndonjë nëpunës tjetër i Policisë së Kosovës duhet t'i ndihmojë viktimiës.
4. Policia e Kosovës e përpilon raportin lidhur me rastin pavarësisht se a është kryer vepra apo jo, a është ndaluar dikush apo jo dhe një kopje të këtij rapporti ia jepin viktimiës, përfaqësuesit të saj ligjor dhe mbrojtësit të viktimiës.
5. Nëse viktima është e moshës nën tetëmbëdhjetë (18) vjet ose nuk ka zotësi të veprimit, apo kur veprat e dhunës në familje janë aq të rënda sa ndikojnë në qetësinë e sigurinë e personit të moshës nën tetëmbëdhjetë (18) vjet, ose që nuk ka aftësi të plotë të veprimit dhe jeton në banesën e njëjtë, Policia e Kosovës duhet të raportoj për rastin menjëherë në qendrën për punë sociale të komunës ku ai person ka vendbanimin ose vendqëndrimin.
6. Nëse ekziston dyshimi i bazuar se është kryer një veprë që ka të bëjë me dhunën në familje pavarësisht se a është arrestuar kryerësi ose është gjetur vendndodhja e tij, Policia e Kosovës duhet ta njoftoj rregullisht viktimen apo përfaqësuesin ligjor dhe mbrojtësin e viktimiës për gjendjen e hetimeve, duke përfshirë informatat lidhur me vendndodhjen e kryerësit të supozuar ose lirimin e tij a të saj nga burgimi.

### **Neni 27 Programi i Kosovës Kundër Dhunës në Familje**

*Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale, në bashkëpunim me: Ministrinë e Shëndetësisë, Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Ministrinë e Kulturës, të Rinisë dhe të Sportit dhe me atë të Arsimit, është përgjegjëse për mbështetjen dhe për ngritjen e strukturave ndihmëse dhe të infrastrukturës së nevojshme, që shërben për mbështetjen dhe për plotësimin e nevojave të personave ndaj të cilëve është ushtruar dhuna në familje, përfshirë këtu asistencën sociale dhe shërbimet mjekësore, në pajtim me legjislacionin në fuqi.*

### **LIGJI NR. 05/L-036 PËR KOMPENSIMIN E VIKTIMAVE TË KRIMIT [I PUBLIKUAR NË GAZETËN ZYRTARE MË 30 QERSHOR 2015]**

### **Neni 2 Fushëveprimi**

*Ky ligj rregullon të drejtën e kompensimit financiar të viktimateve të veprave të dhunshme penale dhe të vartësve të tyre, autoritetet vendimmarrëse si dhe procedurat për realizimin e të drejtës për kompensim në situatat vendore dhe ndërkufitarë.*

## **Neni 6** **Veprat e dhunshme të kompensueshme**

1. Veprat e dhunshme të cilat hyjnë në kategorinë e veprave të kompensueshme sipas këtij Ligji janë:

[...]

1.5. veprat penale që bien brenda përkufizimit të dhunës në familje sipas Ligjit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje.

[...]

## **Neni 7** **Kushtet formale**

1. Kushtet formale për të drejtën në kompensim janë që parashtruesi i kërkesës:

1.1. të jetë shtetas ose banor i përhershëm i Republikës së Kosovës;

1.2. të jetë shtetas i cilitdo shtet, me të cilin Republika e Kosovës ka reciprocitet, apo;

1.3. të jetë shtetas i shtetit anëtar të BE-së.

## **Neni 8** **Kushtet materiale**

1. Kushtet materiale për të drejtën në kompensim në situatat vendore dhe situatat ndërkufitarë vendore janë që vepra penale:

1.1. të jetë paraparë dënim me minimum një vit burgim;

1.2. të jetë kryer në territorin e Republikës së Kosovës;

1.3. të jetë zbuluar dhe raportuar te autoriteti kompetent dhe të jetë trajtuar si vepër penale;

1.4. të mos jetë kryer nga pakujdesia;

1.5. të ketë rezultuar në vdekjen e viktimës, lëndim të rëndë trupor, dëmtim të rëndë të shëndetit fizik apo çrrégullim të rëndë të shëndetit mendor;

1.6. të ketë rezultuar në dëmtim tjetër të përcaktuar me këtë Ligj, dhe;

1.7. viktima e krimtit të mos ketë mundësi të realizimit të kërkesës për kompensim nga sigurimi shëndetësor apo burime tjera.

2. Nëse vepra penale për të cilën kërkohet kompensim sipas këtij Ligjit rezulton në vdekjen e viktimës, vartësit e viktimës mund të gjëzojnë të drejtat e parapara me këtë Ligj.

## **Neni 12** **Llojet e kompensimeve**

1. Dëmtimet dhe shpenzimet në vijim mund të kompensohen sipas këtij ligji:

1.1. lëndimet të rënda fizike apo dëmtimi i shëndetit;

1.2. çrrégullimet e rënda të shëndetit mendor;

1.3. humbja e aftësisë për punë dhe mbajtje;

1.4. shpenzimet mjekësore dhe të hospitalizimit;

1.5. shpenzimet e varrimit;

1.6. dëmet për pajisjet mjekësore të shkatërruara, dhe;

1.7. shpenzimet procedurale për parashtrimin e kërkesës për kompensim.

2. Dëmtimi i shkaktuar nga vepra penale duhet të jetë i natyrës së rëndë. Ajo i referohet si dëmtimit fizik ashtu edhe atij psikik.

[...]

## **PROCEDURAT STANDARDE TË VEPRIMIT PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE NË KOSOVË**

**[të aprovuara përmes Vendimit nr. 78/2013 të 15 korrikut 2013 të  
Koordinatorit Nacional kundër Dhunës në Familje në kuadër të  
Ministrisë së Drejtësisë [publikuar dhe i qasshëm në uebfaqen e  
Agjencisë për Barazi Gjinore në kuadër të Zyrës së Kryeministrit]**

Masat për zbatimin e procedurave standarde të veprimit Akterët institucional dhe akterët mbështetës të cilët kanë kompetenca dhe detyra të luftimit të dhunës në familje, janë të obliguar të veprojnë konform aktiviteteve të përshkruara në PSV vetanake të cilat janë të integruara në këtë Procedurë. Procedurat standarde të veprimit janë hartuar në bazë të dispozitave ligjore në fuqi dhe në rast të plotësimi dhe ndryshimi të ligjeve dhe akteve nënligjore, Agjencia për Barazi Gjinore dhe akterët tjera, janë të obliguar të kryejnë përgaditjen për ndryshimin dhe plotësimin e këtyre procedurave brenda afatit prej 30 ditësh nga data e ndryshimit të ligjeve, akteve nënligjore, memorandumeve të mirëkuptimit dhe PSV institucionale. Të gjitha institucionet e ngarkuara me detyra emergjente, të cilat nuk mund të shthyhen, sipas kësaj Procedure, do të organizojnë kujdestari 24-orëshe për shtatë ditë të javës, për zytarët përkatës të linjave të cilët mirren me dhunën në familje. Akterët institucional dhe akterët mbështetës, do të bëjnë deponimin e të dhënave në bankën e sistemit të menaxhimit të integruar të informatave me qëllimt të grumbullit të dhënave. Me miratimin e Procedurave Standarde, përgjegjësit e akterëve institucional dhe akterët mbështetës, janë të obliguar që të ndërmarrin të gjitha veprimet e parapara për zbatimin e tyre.

[...]

### **Instrumenti 1: Lista e kontrollit për identifikim zyrtar (Shtoja 7).**

Intervista për identifikim. Institucioni i cili e ka kontaktin e parë me viktimën e dhunës në familje duhet të bëjë intervistën për identifikim. Qëllimi i kësaj interviste është që të bëjë identifikimin zyrtar të një rasti të dhunës në familje të përshkruar si më lartë. Intervista ka për qëllim që të konfirmohet statusi i viktimës apo të përgjëneshtrohet ajo. Supozimi i intervistuesit është se ekziston një rast i dhunës në familje, Intervista është një mjet për të bërë vëzhgime dhe për të mbledhur fakte që mbështesin identifikimin zyrtar të rastit të dhunës në familje. Akterët duhet ta realizojnë intervistën në një dhomë që ofron ndjenjën e sigurisë dhe rehatisë për viktimës sikur gjatë identifikimit poashtu edhe në fazat tjera të procedurës. Intervista për identifikim është një fazë kritike në proces për të ndërtuar besimin e viktimës në aftësinë e akterëve për të ofruar siguri dhe ndihmë për viktimën. Angazhimi i akterëve në takтика dhe sjellje që do të riviktimizonin personin e intervistuar për identifikim konsiderohet shkelje e të drejtave të njeriut të viktimës. Për të siguruar viktimave të drejtat e njeriut, viktimës duhet ofruar mundësia e kontaktit me anëtarët e familjes dhe të afërmit tek të cilët ajo/ai ka besim të plotë për ti ofruar ndihmë dhe mbështetjen e duhur. Viktimës duhet ti ofrohet mundësia e komunikimit të drejtë në gjuhën e vet amëtare ose gjuhën që ai/ ajo e kpton, duke filluar nga intervistimi filletar për identifikim dhe deri te fazat tjera. Ofruesit e shërbimit duhet të informojnë çdo viktimë lidhur me qasjen e tyre në shërbime, të marrë pëlqimin apo mos pëlqimin e viktimës për ofrimin e këtyre shërbimeve para se të ndërhyhet. Në rastet të dhunës në familje ku ka edhe viktima fëmijë, duhet të njoftohet organi i kujdestarisë dhe ofruesve të shërbimit sipas mënyrave të lartëcekura dhe mandatit të tyre ligjor. Këshillimi i viktimave për të drejtat e tyre është një hap kritik për t'iu shmangur shkeljeve të të drejtave të njeriut.

### **Shtoja 7. Lista e kontrollit për identifikim zyrtar**

*Lista e Kontrollit për Intervistën e Identifikimit zyrtar*

Akterët duhet të fillojnë intervistën me supozimin se është kryer një rast i dhunës në familje.

*Komunikimi me viktimën në një gjuhë që është e kuptueshme për viktimën  
Shpjegohen shërbimet potenciale për viktimën dhe kërkohet pëlqimi i saj/tij.  
Lejohet qe viktima të kontaktojë më dikë që i beson për t'i ofruar ndihmë dhe mbështetje gjatë procesit  
Dhoma e intervistës është e rehatshme dhe e sigurtë për viktimën.  
Kryesi i dhunës nuk është prezent apo i dukshëm  
Persona të panevojshëm nuk janë prezent  
Personat që viktima i kërkon të janë present  
Rrjedha e intervistës është mënyrës së bisedës, jo gjykues.  
Kontaktohet Organi i Kujdestarisë (Qendra për Punë Sociale) në rast se ka fëmijë.  
Kontaktohen akterët e duhur të përfshirë:  
Policia e Kosovës  
Mbrojtësit e Viktimate/Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimate  
Qendra për Punë Sociale  
Institucionet shëndetësore: parësor, dytësor, tretësor dhe qendrat e shëndëtit mendor  
Strehimoret*

#### **Shtoja 8. Lista e kontrollit për vlerësimin e rrezikut**

*Qëllimi i vlerësimit të rrezikut është që të vlerësohet niveli i rrezikut për dhunën potenciale apo te vazhdueshme për viktimën e dhunës në familje.*

*Merren të gjitha masat emergjente për të siguruar Mbrojtjen e viktimës dhe të tjerëve.*

*Mbrojtësi i viktimate prezent me viktimën.*

*Organi i kujdestarisë prezent kur ka fëmijë viktima.*

*Plotësohet forma bazike për ndihmë të viktimate në prezencën e Mbrojtësit të Viktimate.*

*Vendoset origjinali i formës bazike në dosjen e rastit, përfshirë edhe vlerësimin e rrezikut.*

*Ofrohen kopjet e formës bazike akterëve të përfshirë.*

*Sigurohet që policia të ndihmojë viktimën në përpilimin e një plani të sigurisë për viktimën.*

#### **Shtoja nr. 9 Lista e kontrollit për Policinë**

*Reagimi ndaj rasteve të dhunës në familje.*

*Mbrojtja e viktimës, fëmijëve dhe dëshmitarëve tjerë.*

*Largimi i kryesit të dhunës në familje.*

*Plotësimi i formës bazike, vlerësimi i nevojave dhe rrezikut.*

*Informimi i viktimës për të drejtat e saj/tij.*

*Informimi i viktimës për shërbimet ekzistuese.*

*Sigurimi i kontaktit të zyrtarit policor për viktimën ose përfaqësuesin ligjor.*

*Njoftimi i qendrës për punë sociale dhe mbrojtësit të viktimate apo përfaqësuesit ligjor të viktimës. Intervistimi i viktimës, kryesit, fëmijëve dhe dëshmitarëve.*

*Intervistimi i viktimate nën moshën 18 vjeç në prezencën e organit të kujdestarisë/qendrës për punë sociale.*

*Dorëzimi i kopjes së formës/ndarja e informacionet me akterët tjerë të përfshirë në proces.*

*Transportimi ose sigurimi i transportit për viktimën dhe bartësit e saj/tij në institucionin shëndetësor.*

*Transportimi ose sigurimi i transportit për viktimën dhe bartësit e saj/tij në strehimore ose në ndonjë lokacion tjeter të sigurtë sipas kërkesës së viktimës.*

*Shqiptimi i urdhrit të përkohshëm emergjent jashtë orarit të punës së gjykatave, nëse kërkohet nga viktima, QPS, mbrojtësi i viktimave ose strehimorja. Monitorimi dhe ekzekutimi i urdhërave mbrojtës të lëshuara nga gjykata.*

*Përcjellja e viktimës për t'i marrë gjërat personale. Përpilimi i raportit lidhur me rastin dhe dorëzimi i kopjes së raportit viktimës, QPS-së, dhe Mbrojtësit të viktimave.*

*Hetimi i rastit të dhunës në familje.*

*Nëse ka elemente të veprës penale, përpilimi i kallëzimit penal dhe referimi I rastit tek prokurori kompetent.*

*Ofrimi i transportit për viktimën gjatë procedurave gjyqësore. Informimi i viktimës nëse kryesi i dhunës në familje është arrestuar ose lidhur me vendndodhjen e tij/saj. Informimi i viktimës, mbrojtësit të viktimave, Qendrës për punë sociale, dhe strehimores lidhur me ndryshimet në statusin e ndalimit apo arrestimit të kryesit.*

## **Institucionet e Republikës së Kosovës dhe akterët tjerë të përfshirë në mbrojtje të viktimave nga dhuna në familje**

### **(i) Koordinatori/ja Kombëtare kundër Dhunës në Familje**

Bazuar në Vendimin nr. 04/83, të 11 korrikut 2012, të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Zëvendësministri/ja e Drejtësisë mban pozitën e Koordinatores Nacionale kundër Dhunës në Familje (Zyra e Koordinatores Nacionale), ndërsa Agjencia për Barazi Gjinore mban pozitën e Nën-Kryesuesit.

Sipas Vendimit të lartcekur, Zyra e Koordinatorit/es Nacionale mbikëqyrë zbatimin e Strategjisë Nacionale për Mbrojtje nga Dhuna në Familje në nivelin kombëtar; koordinon masat dhe politikat në lidhje me dhunën në familje; mbikëqyrë bazën e të dhënavë për rastet e dhunës në familje; dhe udhëheq Grupin Koordinues Ndërministror për Dhunën në Familje të përbërë nga: Zyra e Kryeministrat (Agjencia për Barazi Gjinore), zëvëndëskryesuese, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punës dhe mirëqenies Sociale, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Financave, Policia e Kosovës dhe Agjencia e Statistikave.

Zyra e Koordinatorit/es Nacionale gjithashtu harton raporte monitorimi dhe vlerësimi për Strategjinë Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje.

### **(ii) Agjencia për Barazi Gjinore**

Agjencia për Barazi Gjinore në Zyrën e Kryeministrat (në tekstin e mëtejmi: ABGJ): [Mandati, detyrat, dhe përgjegjësitet e ABGJ-së janë të përcaktuara në Ligjin Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore]. ABGJ në bazë të Vendimit të lartcekur nr. 04/83 të 11 korrikut 2012shërbën si nën-kryesuese e Grupit Koordinues Ndërministror kundër Dhunës në Familje.

### **(iii) Përgjigja komunale ndaj dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave (Mekanizmat Koordinues)**

Në nivel komunal janë themeluar Mekanizmat Koordinues të cilët duhet të bashkëpunojnë për të adresuar dhunën në familje si dhe dhunën ndaj grave dhe për të menaxhuar raste specifike, sipas kornizës ligjore. Anëtarët e Mekanizmave Koordinues përfshijnë Zyrtarët për Barazi Gjinore, Policinë e Kosovës, Gjyqtarë, Qendrat për Punë Sociale, Mbrojtësit e Viktimave, Drejtoretë Komunale të Arsimit, Zyrat e Punësimit, Organizata të Shoqërisë Civile duke përfshirë strehimoret dhe, në disa komuna, gratë anëtarë të Kuvendit Komunal. Ende nuk është realizuar ngritja e Mekanizmave Koordinues në të gjitha komunat e Kosovës.

**(iv) Policia e Kosovës [Shih më lart nenin 24 të Ligjit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje] dhe Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje në Kosovë**

**(v) Inspektorati i Policisë**

**(vi) Zyra për Mbrojtjen dhe Ndihmë Viktimave (ZMNV)**

**(vii) Mbrojtësi i viktimave**

Sipas Ligjit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, *Mbrojtësi i viktimave* është personi i autorizuar zyrtar i cili ndihmon drejtpërdrejtë palën e dëmtuar që nga kontaktet e para me organet kompetente të mbrojtjes, këshillon, iniciacion procedurat për caktimin e masave të mbrojtjes, është i obliguar të marr pjesë në të gjitha seancat gjyqësore, të monitoroj mbarëvajtjen e procesit gjyqësor.

*Mbrojtësit e Viktimave* bashkëpunojnë ngushtë me institucionet tjera si agjensionet e zbatimit të ligjit, QPS-të, Institutin e Mjekësisë Ligjore, organizatat qeveritare dhe jo qeveritare për të siguruar ofrimin e shërbimeve profesionale për të gjitha viktimat e krimít.

*Mbrojtësit e Viktimave* zbatojnë strategjinë dhe vendimet e ZMNV e të Kryeprokurorit të Shtetit duke raportuar për punën e kryer në afate kohore.

Sipas Procedurave standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje: “*Mbrojtësit e viktimave zakonisht takohen me viktimat menjëherë pas reagimit të policisë ndaj një rasti të lajmëruar të dhunës në familje. Ky kontakt në fillim me viktimë lejon që Mbrojtësi i Viktimave të ndërtojnë një raport me viktimën që zgjatë gjatë kontaktit të viktimës me mekanizmat tjere institucional. Përgjegjësia e Mbrojtësit të Viktimave është që të sigurojë se viktima kuption shërbimet që mund t'i ofrohen nga Shteti dhe si mund t'i pranojë ato.*“

**(viii) Prokurori i Shtetit**

Sipas Procedurave standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje: *Bashkëveprimi* në mes të Prokurorit dhe viktimës së dhunës në familje apo dhunës ndaj grave zakonisht vjen në shprehje në procesin e mëvonshëm të raportimit. Prokurorët kanë për obligim t'i ndërmarrin masat e nevojshme varësisht nga vlerësimi i rrezikshmërisë së rastit konkret të dhunës në familje. Ata i vlerësojnë rastet e dhunës në familje, historinë kriminale të kryerësit dhe shkeljet e urdhërave mbrojtës për të përcaktuar nëse ka prova të mjaftueshme për t'i ndjekur kryerësit e dhunës në familje. *Viktima e dhunës në familje* është palë në procedure dhe njëkohësisht dëshmitarja kryesore e prezantuar në gjykata nga ana e prokurorit. Mbi të gjitha, prokurori ka për obligim që të bëj sigurimin e provave dhe të procedojë me ndjekjen penale bazuar në ato prova pa marrë parasysh vullnetin e viktimës për të proceduar më tutje apo jo me ndjekjen penale. Prokurori poashtu ka për obligim bashkëpunimin me mbrojtësin e viktimave, i cili ndihmon prokurorin gjatë gjithë procedurës duke shërbyer si urëlidhës mes prokurorit dhe viktimës. Prokurori ka për obligim që të informojë viktimën lidhur me të drejtat e viktimës në procedurë, të drejtën në kompensim si dhe statusin e rastit të saj/tij.

**(ix) Gjykatat**

Sipas Procedurave standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje: “*Gjykatat i shqyrtojnë me prioritet rastet e dhunës në familje. Këto raste trajtohen nga gjykata në procedurë civile apo penale varësisht nga natyra e rastit. Në raste të rralla gjykatat janë ofruesit e parë të shërbimeve që ballafaqohen me viktimën e*

*dhunës në familje. Edhe pse gjykata nuk inicon procedurat lidhur me rastet e dhunës në familje, gjykata nuk është pasive në obligimet e saj ndaj rasteve të dhunës në familje. Gjykatat, kanë përgjegjësinë e trajtimit të palëve dhe individëve që shfaqen para tyre, në mënyrë të paanshme, dinjitoze dhe respekt, duke siguruar mbrojtje adekuate për të gjitha palët e përfshira në procedurë. Në procedurë civile, gjykatat shqyrtojnë kërkesën për urdhër mbrojtje ose urdhër mbrojtje emergjente dhe shqiptojnë masat mbrojtëse të parapara me ligj. Në procedurë penale, Organet hetuese janë kompetente të vendosin për rastet e ndjekjes penale të kryerësve të dhunës në familje, të cilët kanë shkelur urdhrin për mbrojte, ose personat që kanë kryer vepër penale në marrëdhënie familjare. Gjykatat kanë për obligim që t'i njoftojnë të gjitha palët në procedurë për të drejtat që i përkasin atyre, si dhe pasojat e mosveprimit të tyre.”*

**Raporti Shpjegues mbi Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (11 maj 2011)**

**Neni 18  
Detyrimet e përgjithshme**

*111. Ky nen parashtron një sërë parimesh të përgjithshme që duhen respektuar në ofrimin e shërbimeve mbrojtëse dhe mbështetëse.*

*112. Paragrafi 1 përmban detyrimin e përgjithshëm për marrjen e masave legjislativë ose masa të tjera për mbrojtjen e të gjitha viktimate brenda territorit të tyre nga çdo akt tjetër dhune i mbuluar me këtë Konventë.*

*113. Në përputhje me qasjen e përgjithshme të të gjitha agjencive dhe gjithëpërfshirese të promovuar me Konventë, paragrafi 2 kërkon nga Palët në Konventë të sigurojnë që, në përputhje me ligjin e brendshëm, ekzistojnë mekanizmat e duhur që sigurojnë bashkëpunim efektiv midis agjencive të mëposhtme, të cilat hartuesit kanë identifikuar si relevante: gjyqësorin, prokurorët publikë, agjencitë e zbatimit të ligjit, autoritetet lokale dhe rajonale dhe OJQ-të. Duke shtuar “organizata të tjera përkatëse”, hartuesit kanë siguruar që kjo listë nuk është shteruese për të lejuar bashkëpunimin me çdo organizatë tjetër që një Palë mund ta konsiderojë të rendësishme. Termi “mekanizëm” i referohet çdo strukture formale ose joformale, siç janë protokollet e dakorduara, tryezat e rrumbullakëta ose çdo metodë tjetër që mundëson një numër profesionistësh të bashkëpunojnë në një mënyrë të standardizuar. Nuk kërkon ngritjen e një organi apo institucionizyrtar.*

*114. Theksi i vënës në bashkëpunimin ndërmjet këtyre aktorëve buron nga bindja se format e dhunës të mbuluara me Konventë trajtohen më së miri në një mënyrë të bashkërenduar dhe të koordinuar nga një sërë agjencish. Agjencitë e zbatimit të ligjit, të cilat janë shpesh të parat që janë në kontakt me viktimat kur thirren në një skenë krimi, duhet të jenë në gjendje ta referojnë viktimin te shërbimet e specializuara të mbështetjes, për shembull një strehimore ose një qendër krizash përdhunimi që shpesh drejtohet nga OJQ-të. Këto shërbime mbështetëse më pas do ta mbështesin viktimin duke ofruar kujdes mjekësor, mbledhjen e provave mjekologjore nëse kërkohet, këshillim psikologjik dhe ligjor. Ata gjithashtu do të ndihmojnë viktimin në marrjen e hapit të ardhshëm, i cili shpesh kërkon që të merret me gjyqësorin. Është e rendësishme të theksohet se ky detyrim nuk kufizohet vetëm te viktimat, por shtrihet edhe tek dëshmitarët, duke pasur parasysh veçanërisht dëshmitarët fëmijë.*

*115. Paragrafi 3 numëron një sërë synimesh dhe kriteresh që duhet të ndjekin ose duhet të bazohen shërbimet mbrojtëse dhe mbështetëse. Së pari, të gjitha masat e marra duhet të bazohen në një perceptim gjinor të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Kjo do të thotë që shërbimet e ofruara duhet të demonstrojnë një qasje,*

përkatëse për përdoruesit e tyre, e cila njeh dinamikën gjinore, ndikimin dhe pasojat e këtyre formave të dhunës dhe që vepron brenda kornizës së barazisë gjinore dhe të drejtave të njeriut.

116. Së dyti, ky paragraf kërkon çdo masë të tillë për të marrë parasysh marrëdhëniet midis viktimave, autorëve, fëmijëve dhe mjedisit të tyre më të gjere për të shmanjur rrezikun e adresimit të nevojave të tyre në izolim ose pa pranuar realitetin e tyre shoqëror. Hartuesit e konsideruan të rendësishme që të sigurohet që nevojat e viktimave të vlerësohen në dritën e të gjitha rrëthanave relevante për të lejuar profesionistët të marrin vendime të informuara dhe të përshtatshme. Termi “qasje e integruar” i referohet qasjes së integruar të bazuar në të drejtat e njeriut të trajtuar si “qasja tre P”, që synon parandalimin, mbrojtjen dhe ndjekjen penale të integruar.

117. Së treti, masat dhe shërbimet që kanë qëllim të mirë, por që nuk marrin në parasysh në mënyrë adekuate efektet shkatërruese të dhunës dhe kohëzgjatjen e procesit të rimëkëmbjes ose që i trajtojnë viktimat në mënyrë të pandjeshme, rrezikojnë të ri-victimizojnë përdoruesit e shërbimit.

118. Për më tepër, paragrafi 3 kërkon të gjitha masat për të synuar fuqizimin dhe pavarësinë ekonomike të grave viktima të një dhune të tillë. Kjo do të thotë të sigurohet që viktimat ose përdoruesit e shërbimeve janë të familjarizuar me të drejtat dhe të privilegjet e tyre dhe mund të marrin vendime në një mëdis mbështetës që i trajton ata me dinjitet, respekt dhe ndjeshmëri. Në të njëjtën kohë, shërbimet duhet t'u rrënjosin viktimave një ndjenjë kontrolli të jetës së tyre, e cila në shumë raste përfshin punën drejt sigurisë financiare, veçanërisht pavarësinë ekonomike nga dhunuesi.

119. Disa shembuj në të cilët shërbimet, duke përfshire degët e agjencive të zbatimit të ligjit, ndodhen në të njëjtën ndërtesë ose në afërsi me njëra-tjetrën dhe bashkëpunojnë, kanë treguar se rrisin ndjeshëm nivelet e kënaqësisë me shërbimet dhe, në disa raste, kanë rritur vullnetin e viktimave të ngrenë akuza ose të përballen me një çështje. Këta shembuj njihen si “One-stop-shop” dhe janë provuar dhe testuar për shërbimet e dhunës në familje, por mund të përshtaten lehtësisht me format e tjera të dhunës. Për këtë arsy, paragrafi 3 u bën thirrje palëve të përpilen për të vendosur shërbimet në të njëjtën ndërtesë.

120. Në fund, paragrafi 3 kërkon nga Palët në Konventë të sigurojnë që shërbimet mbështetëse të jenë në dispozicion të personave të cenueshëm dhe të adresojnë nevojat e tyre specifike. Termi “persona të cenueshëm” i referohet të njëjtës listë të personave siç shpjegohet në komentet sipas nenit 12. Palët duhet t'i vënë këto shërbime në dispozicion të viktimave pavarësisht nga statusi i tyre socio-ekonomik dhe t'i ofrojnë ato pa pagesë, aty ku është e përshtatshme.

121. Qëllimi i paragrafit 4 është të tregojë një ankesë serioze të cilën viktimat e hasin shpesh kur kërkojnë ndihmë dhe mbështetje. Shumë shërbime, publike dhe private, e bëjnë mbështetjen e tyre të varur nga gatishmëria e viktimës për të ngritur akuza ose për të dëshmuar kundër autorit. Nëse, për arsyet frike ose trazirash emocionale dhe lidhjeje, viktima nuk dëshiron të ngrejë akuzë ose refuzon të dëshmojë në gjykatë, ai ose ajo nuk do të marrë këshillim ose strehim. Kjo bie ndesh me parimin e fuqizimit dhe të qasjes së bazuar në të drejtat e njeriut dhe duhet të shmanget. Është e rendësishme të theksohet se kjo dispozitë i referohet para së gjithash shërbimeve mbështetëse të përgjithshme dhe të specializuara të përmendura në nenet 20 dhe 22 të Konventës – me përjashtim të shërbimeve të ndihmës juridike.

122. Disa nga format e dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konverte mund të kenë një dimension ndërkombëtar. Viktimat e dhunës si martesat e detyruara ose dhuna në familje, por edhe gratë ose vajzat e kërcënua me gjyntim gjenital dhe që janë jashtë shtetit të tyre kërkojnë mbrojtje konsullore dhe, ndoshta, ndihmë mjekësore dhe financiare. Paragrafi 5 kërkon që Palët të marrin masat e duhura për të ofruar ndihmën e nevojshme konsullore dhe, nëse është e përshtatshme, mbrojtje dhe ndihmë tjetër, e cila përfshin ndihmën për viktimat e krimit të

*dhunshëm, ndihmën në rast arrestimi ose ndalimi, lehtësimin dhe riatdhesimin e shtetasve në gjendje të vështirë, lëshimin e dokumentacion me identitetit të ri dhe mbështetje tjetër konsullore.*

*123. Ky detyrim nuk është i kufizuar për shtetasit e një Pale në Konventë, por shtrihet për të gjitha viktimat e tjera të cilat, në përputhje me detyrimet e tyre sipas ligjit ndërkombëtar, kanë të drejtën e mbrojtjes kombëtare nga ajo Palë, për shembull shtetasit e një shteti anëtar të Bashkimit Evropian, i cili në vetvete nuk ofron mbrojtje përmes një përfaqësie të përhershme (ambasadë, konsullatë e përgjithshme ose konsullatë) siç parashihet me nenin 20 (2) lit. c të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian.*

### **Neni 50** **Reagim, parandalim dhe mbrojtje të menjëherëshme**

*257. Paragrafi 1 kërkon që agjencitë e zbatimit të ligjit të reagojnë menjëherë dhe në mënyrë të përshtatshme duke ofruar mbrojtje adekuate dhe të menjëherëshme për viktimat, ndërsa paragrafi 2 kërkon angazhimin e tyre të menjëherëshëm dhe të duhur në parandalimin dhe mbrojtjen kundër të gjitha formave të dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konverte, duke përfshirë përdorimin e masave operacionale parandaluese dhe mbledhjen e provave.*

*258. Përbushja e këtij detyrimi përfshin, për shembull, sa vijon:*

- të drejtën e organeve përgjegjëse të zbatimit të ligjit për të hyrë në vendin ku ndodhet një person në rrezik;*
- trajtimin dhe dhënien e këshillave viktimave nga agjencitë përgjegjëse të zbatimit të ligjit në mënyrën e duhur;*
- dëgjimi i viktimave pa vonesë nga personeli i trajnuar posaçërisht, sipas rastit, femra në ambiente që janë krijuar për të krijuar një marrëdhënie besimi midis viktimës dhe personelit të zbatimit të ligjit; dhe*
- të sigurojë një numër adekuat të zyrtarëve femra të zbatimit të ligjit, përfshirë në nivele të larta përgjegjësie.*

*259. Duhet të merren masa efektive për të parandaluar format më flagrante të dhunës që janë vrasja ose tentativa për vrasje. Çdo rast i tillë duhet të analizohet me kujdes për të identifikuar çdo dështim të mundshëm të mbrojtjes në funksion të përmirësimit dhe zhvillimit të masave të mëtejshme parandaluese.*

### **Neni 51** **Vlerësimi i rrezikut dhe menaxhimi i rrezikut**

*260. Shqetësimet për sigurinë e viktimës duhet të qëndrojnë në thelb të çdo ndërhyrjeje në rastet e të gjitha formave të dhunës që mbulohen nga objekti i kësaj Konverte. Prandaj, ky nen përcakton detyrimin për të garantuar që të gjitha autoritetet përkatëse, pa u kufizuar vetëm në polici, të vlerësojnë në mënyrë efektive dhe të hartojnë një plan për të menaxhuar rreziqet e sigurisë me të cilat përballet një viktimë e caktuar prej rasti në rast, sipas procedurës së standardizuar dhe në bashkëpunim dhe bashkërendim me njëri-tjetrin. Shumë autore i kërcënojnë viktimat e tyre me dhunë të rëndë, duke përfshirë vdekjen, dhe i kanë nënshtruar viktimat të tyre ndaj një dhune të rëndë në të kaluarën. Prandaj është thelbësore që çdo vlerësim i rrezikut dhe menaxhimi i rrezikut të marrë parasysh mundësinë e dhunës së përsëritur, veçanërisht dhunës vdekjeprurëse, dhe të vlerësojë në mënyrë adekuate seriozitetin e situatës.*

*261. Qëllimi i kësaj dispozite është të sigurojë që të krijohet një rrjet efektiv të të gjitha agjencive profesionistësh për të mbrojtur viktimat me rrezik të lartë. Prandaj, vlerësimi i rrezikut duhet të kryhet me synimin për të menaxhuar rrezikun e identifikuar duke hartuar një plan sigurie për viktimën në fjalë, në mënyrë që të ofrohet siguri dhe mbështetje e koordinuar nëse është e nevojshme.*

262. Megjithatë, është e rëndësishme të sigurohet që çdo masë e marrë për të vlerësuar dhe menaxhuar rrezikun e dhunës së mëtejshme të mundësojë që të respektohen të drejtat e të akuzuarit gjatë gjithë kohës. Në të njëjtën kohë, është e një rëndësie të madhe që masa të tilla të mos përkqësojnë asnjë dëm të përjetuar nga viktimat dhe që hetimet dhe procedurat gjyqësore të mos çojnë në viktimizimin dytësor.

263. Paragrafi 2 zgjeron detyrimin për të siguruar që vlerësimi i rrezikut të përmendur në paragrafin e parë të këtij neni merr parasysh siç duhet informatat e besueshme për posedimin e armëve të zjarrit nga autorët e akteve të dhunës. Mbajta e armëve të zjarrit nga autorët jo vetëm që përbën një mjet të fuqishëm për të ushtruar kontroll mbi viktimat, por gjithashtu rrit rrezikun e vrasjes. Ky është veçanërisht rasti në situatat pas konfliktit ose në vendet me një traditë të posedimit të armëve të zjarrit, të cilat mund t'u ofrojnë autorëve qasje më të madhe në këto armë. Megjithatë, raste shumë të rënda të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje janë kryer me përdorimin e armëve të zjarrit edhe në të gjitha vendet e tjera. Për këtë arsy, hartuesit menduan se ishte thelbësore t'u vendosnin Palëve detyrimin për të siguruar që çdo vlerësim i rreziqeve me të cilat përballet një viktimë duhet të marrë parasysh sistematikisht, në të gjitha fazat e hetimit dhe aplikimit të masave mbrojtëse, nëse autori posedon legalisht apo ilegalisht ose ka qasje në armë zjarri për të garantuar sigurinë e viktimave. Për shembull, në lëshimin e urdhraive të ndalimit emergjent, urdhraive të ndalimit ose mbrojtjes, dhe kur dënohen pas dënimive penale për ndonjë nga format e dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konvente, Palët mund të miratojnë, brenda sistemeve të tyre ligjore të brendshme, masa të tilla që mund të jenë të nevojshme për të mundësuar konfiskimin e menjëherëshëm të armëve të zjarrit dhe municionit. Për më tepër, për të mbuluar të gjitha armët që mund të përdoren në raste të rënda të dhunës, veçanërisht thikat e tipit luftarak, Palët inkurajohen të marrin parasysh, sa më shumë që të jetë e mundur, posedimin ose qasjen në armë të tilla.

## **Rekomandimet/opinionet e institucioneve ndërkombëtare dhe analizë krahasimore e legjisacioneve të shteteve anëtare të Këshillit të Evropës**

### **(i) Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit ndaj grave [CEDAW]**

Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Gruas (në tekstin e mëtejmë: Komiteti CEDAW) është organ i pavarur i ekspertëve i cili monitoron zbatimin e Konventës për Eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas, i cili përbëhet nga 23 ekspertë nga e gjithë bota.

*Rekomandimi nr. 35 në lidhje me dhunën në bazë gjinore ndaj grave, që përditëson rekomandimin nr. 19 [ i miratuar nga Komitetit për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave [Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas], miratuar më 26 korrik 2017]*

A. Përgjegjësia për veprimet ose mosveprimet e aktorëve shtetërorë

22. Sipas Konventës dhe ligjit të përgjithshëm ndërkombëtar, një shtet palë është përgjegjës për veprimet ose mosveprimet e organeve dhe agjentëve të tij që përbëjnë dhunë me bazë gjinore ndaj grave, që përfshijnë veprimet ose mosveprimet e zyrtarëve në degët e tij ekzekutive, legjislative dhe gjyqësore. Neni 2 (d) i Konventës parashev që shtetet palë, dhe organet dhe agjentët e tyre, duhet të përbahen nga përfshirja në çdo veprim ose praktikë të diskriminimit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë kundër grave dhe të sigurojnë që autoritetet dhe institucionet publike të veprojnë në pajtim me këtë detyrim. Përvëç sigurimit që ligjet, politikat, programet dhe procedurat nuk diskriminojnë gratë, në përputhje me nenet 2 (c) dhe (g), Shtetet palë duhet të kenë një kuadër efektiv dhe të qasshëm të shërbimeve ligjore për të adresuar të gjitha format e dhunës me bazë gjinore ndaj grave e kryer nga agjentë shtetërorë, qoftë në territorin e tyre apo jashtë territorit.

23. Shtetet palë janë përgjegjëse për parandalimin e akteve ose mosveprimeve të tilla nga organet dhe agjentët e tyre, duke përfshirë trajnimin dhe miratimin, zbatimin dhe monitorimin e dispozitave ligjore, rregulloreve administrative dhe kodeve të mirësjelljes, si dhe për hetimin, ndjekjen penale dhe zbatimin e sanksioneve të përshtatshme ligjore ose disiplinore, si dhe dhënien e dëmshpérblimit, në të gjitha rastet e dhunës me bazë gjinore ndaj grave, përfshirë ato që përbëjnë krime ndërkomëtare, dhe në rastet e dështimit, neglizhencës ose mosveprimi nga ana e autoriteteve publike. Duke vepruar kështu, duhet të merren parasysh diversiteti i grave dhe rreziqet e formave të kryqëzuara të diskriminimit.

[...]

Ndjekja penale dhe dënim

32. Komiteti rekomandon që shtetet palë të zbatojnë masat e mëposhtme në lidhje me ndjekjen penale dhe dënimin për dhunën me bazë gjinore ndaj grave:

(a) Të sigurojnë qasje efektive për viktimat në gjykata dhe tribunale dhe që autoritetet t'i përgjigjen në mënyrë adekuate të gjitha rasteve të dhunës me bazë gjinore ndaj grave, duke përfshirë zbatimin e ligjit penal dhe, sipas rastit, ndjekjen penale sipas detyrës zyrtare për të njëjtës qysh autorët e dyshuar në një të mënyrë të drejtë, të paanshme, me kohë dhe të shpejtë dhe vendosjen e dënimeve adekuate. Tarifat apo shpenzimet gjyqësore nuk duhet të vendosen ndaj viktimate/të mbijetuarve; (b) Të sigurohet që dhuna me bazë gjinore ndaj grave të mos i referohet detyrimisht procedurave alternative të zgjidhjes së kontesteve, duke përfshirë ndërmjetësimin dhe pajtimin. Përdorimi i këtyre procedurave duhet të rregullohet në mënyrë strikte dhe të lejohet vetëm kur një vlerësim i mëparshëm nga një ekip i specializuar siguron pëlqimin e lirë dhe të informuar të viktimate/të mbijetuarve dhe se nuk ka tregues të rreziqeve të mëtejshme për viktimat/të mbijetuarit ose anëtarët e familjes së tyre. Procedurat duhet të fuqizojnë viktimat/të mbijetuarat dhe të sigurohen profesionistë të trajnuar posaçërisht për të kuptuar dhe për të ndërhyrë në mënyrë adekuate në rastet e dhunës me bazë gjinore ndaj grave, duke garantuar mbrojtjen e duhur të të drejtave të grave dhe fëmijëve dhe që ndërhyrjet të kryhen pa stereotipizim apo riviktimizim të grave. Procedurat alternative të zgjidhjes së kontesteve nuk duhet të përbëjnë pengesë për qasjen e grave në drejtësinë formale.

## (ii) Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës

[Rekomandimi [Rec (2002)5] i Komitetit të Ministrave të shteteve anëtarë të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Grave kundër Dhunës, miratuar më 30 prill 2002, si dhe Memorandumi Shpjegues]

### Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

93. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.
94. Gjykata, fillimisht vë në pah se parashtruesja e kërkesës kërkesën e saj në Gjykatë e ka dorëzuar si kërkesë individuale të bazuar në paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës dhe se përmes kësaj kërkeze nuk konteston ndonjë akt specifik të një autoriteti publik, por pretendon se përmes (mos)veprimeve të autoriteteve publike, përkatësisht: (i) Gjykatës Themelore në Gjilan; (ii) Prokurorisë Themelore të Gjilanit; (iii) Prokurorisë Themelore të Prishtinës; dhe (iv) Stacionit policor në Graçanicë, të ndjerës, përkatësisht nënës së saj S.M., i është cenuar e drejta për jetën, e garantuar me nenin 25 të Kushtetutës në lidhje me nenin 2 të KEDNJ-së.

95. Gjykata duke iu referuar nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, i cili përcakton detyrimin që të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuar me Kushtetutë të interpretohen në harmoni me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, vlerëson se konstatimet e kësaj të fundit që ndërlidhen me pranueshmërinë e kërkesës në rastet ku është pretenduar cenimi i nenit 2 të KEDNJ-së, duhet që gjatë shqyrtimit të kritereve të pranueshmërisë të aplikohen edhe në rrethanat e rastit të parashtrueses së kërkesës.
96. Në këtë kuptim, Gjykata vë theksin në paragrafin 1 të nenit 25 të Kushtetutës, i cili përcakton që: “*Secili individ gëzon të drejtën për jetën.*” si dhe në paragrafin 1 të nenit 2 të KEDNJ-së, i cili përcakton që: “*E drejta e çdo njeriu për jetën mbrohet me ligj. [...].*”.
97. Në këtë linjë, GJEDNJ përmes praktikës së saj gjyqësore kishte theksuar se: “*Qasja e [GJEDNJ-së] përkizazi me interpretimin e nenit 2 të [KEDNJ-së] duhet të udhëhiqet nga fakti se objekti dhe qëllimi i Konventës si instrument për mbrojtjen e individëve kërkon që dispozitat e saj duhet që të interpretohet dhe aplikohen në atë mënyrë që garancitë e saja të janë praktike dhe efektive*” (shih rastin e GJEDNJ-së, *McCann dhe të Tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 18984/91, Aktgjykim i 27 shtatorit 1995, parografi 146).
98. Gjykata vë në dukje se KEDNJ të drejtën për jetën e rangon si njëren nga dispozitat fundamentale të saj (shih, në këtë aspekt rastin e GJEDNJ-së, *McCann dhe të Tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, parografi 147).
99. Në vijim të kësaj, GJEDNJ ka konstatuar se nenit 2 i KEDNJ-së përban dy obligime përbajtësore: (i) detyrimin e përgjithshëm që të drejtën në jetë ta mbrojë me ligj, dhe (ii) ndalimin e privimit të qëllimshëm të së drejtës në jetë (shih rastin e GJEDNJ-së, *Boso kundër Italisë*, nr. 50490/99, Aktvendim i 5 shtatorit 2002, parografi 1).
100. Për më tepër, Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës në kërkesën e saj shprehimisht kërkon që Gjykata të vlerësojë nëse (mos)veprimet e autoriteteve publike të sipërcakura, kanë cenuar të drejtën për jetë të nënës së saj të garantuar me Kushtetutë dhe me KEDNJ, dhe në të njëjtën kohë pretendon se veprimet dhe mosveprimet e autoriteteve shtetërore kanë rezultuar në shkelje të neneve 18, 50 dhe 51 të Konventës së Stambollit.
101. Bazuar në atë si më lart, në vlerësimin e kritereve të pranueshmërisë së kërkesës përkatëse, Gjykata do të vendosë theksin në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të vet Gjykatës në kuptim të shqyrtimit të pretendimit për shkelje të së drejtës për jetën, të garantuar me nenit 25 të Kushtetutës, në lidhje me nenit 2 të KEDNJ-së, e që ndërlidhen me detyrimin pozitiv të shteteve për të mbrojtur të drejtën për jetë me ligj.

*(i) Lidhur me palën e autorizuuar*

102. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. *Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuuar.*

[...]

7. *Individët janë të autorizuuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*

103. Gjykata gjithashtu i referohet edhe pikës (a) të paragrafit (1) të rregullit 39 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës i cili përcakton:
- (i) *Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:*
- (a) *kërkesa parashtrohet nga një palë e autorizuar.*
104. Në shqyrtimin dhe vlerësimin e këtij kriteri, Gjykata i referohet praktikës së Gjykatës dhe asaj të GJEDNJ-së.
105. Në këtë kontekst, Gjykata, duke rikujtuar praktikën e saj gjyqësore, në veçanti rastin KI41/12 me parashtrues *Gëzim dhe Makfire Kastrati*, Aktgjykim, i 26 shkurtit 2013, thekson se në rastin konkret, kishte pranuar statusin e palës së autorizuar të parashtruesve të kërkesës, të cilët ishin prindërit e së ndjerës D.K.
106. Në vijim, Gjykata rikujton praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, përkatësisht rastet e kësaj gjykate që ndërlidhen me pretendime për shkelje të nenit 2 të KEDNJ-së. Gjykata vëren se kjo e fundit në rastet respektive, ka pranuar kërkesa individuale nga individët qe konsiderohen si viktima indirekte apo të tërthorta, kur ekziston një lidhje personale dhe specifike ndërmjet viktimës dhe parashtruesit (shih, rastet e GJEDNJ-së, *Van Colle kundër Mbretërisë së Bashkuar*, të cituar më lart, parografi 86; *Yasa kundër Turqisë*, të cituar më lart, parografi 66).
107. Në raste të tilla, GJEDNJ ka pranuar që anëtarët e ngushtë të familjes, si për shembull prindërit e një personi vdekja apo zhdukja e të cilit është pretenduar të përfshijë përgjegjësinë e shtetit, mund të kërkjojë që të jenë viktima indirekte të shkeljes së pretenduar të nenit 2 të KEDNJ-së, dhe pyetja nëse ata ishin trashëgimtarë ligjorë të të ndjerit/ndjerës nuk ishte relevante (shih rastet e GJEDNJ-së, *Van Colle kundër Mbretërisë së Bashkuar*, të cituar më lart, parografi 86; *Tsalikidis dhe të Tjerët kundër Greqisë*, të cituar më lart, parografi 64, *Kotilainen dhe të tjerët kundër Finlandës*, nr.62439/12, Aktgjykim i 17 shtatorit 2020, paragrafët 51-52).
108. Më specifisht, në kontekst të dhunës në familje, Gjykata në rastet e saja që ndërlidheshin me pretendimin për shkelje të nenit 2 të KEDNJ-së, si palë të autorizuar kishte pranuar edhe anëtarët e familjes së viktimate, të cilët ishin privuar ngajeta (shih, për shembull, rastin e GJEDNJ- *Branko Tomašić dhe Të Tjerët kundër Kroacisë*, nr. 46598/06, Aktgjykim, i 15 janarit 2009.) Në këtë rast parashtrues të kërkesës ishin të afërm të një gruaje dhe foshnjës së saj, bashkëshorti/babai i të cilëve kishte vrarë të dytë dhe më pas edhe veten e tij.
109. Gjykata duke aplikuar edhe konstatimet e lartcekura përmes praktikës gjyqësore të vet Gjykatës dhe asaj të GJEDNJ-së, në rrëthanat e rastit konkret, përkatësisht parashtrueses së kërkesës, e cila është e bija e së ndjerës S.M, konsideron se ekziston lidhja direkte mes viktimës dhe parashtrueses së kërkesës, dhe rrjedhimisht konstaton se e njëjtë është palë e autorizuar ashtu siç është përcaktuar me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës dhe rregullin 39 (1) (a) të Rregullores së punës.
- (ii) *Lidhur me shterimin e mjeteve juridike*
110. Në këtë aspekt, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, të cituar më lart; paragrafit 2 të nenit 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit; dhe pikës (b), paragrafit (1), të rregullit 39 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës, të cilët përcaktojnë:

Neni 47  
(Kërkesa individuale)

(...)

2. Individ mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

Rregulli 39  
(Kriteret e pranueshmërisë)

1. Gjkata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:  
(...)

(b) janë shteruar të gjitha mjetet efektive të përcaktuara me Ligj kundër aktgjykimit ose vendimit të kontestuara.

111. Gjkata vëren që paragrafi 7 i nenit 113 të Kushtetutës përcakton detyrimin e shterimit të “të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj” kundër vendimeve të autoriteteve publike. Ky detyrim kushtetues është gjithashtu i përcaktuar me nenin 47 të Ligjit dhe me pikën (b) të paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës.
112. Në kuptim të këtij kriteri, Gjkata përsërit se parashtruesja e kërkesës në kërkesën e saj nuk konteston ndonjë akt të një autoritetit publik, por konteston se (mos)veprimet e autoriteteve shtetërore të lartcekura kanë rezultuar në cenimin të së drejtës për jetë të së ndjerës S.M.
113. Gjkata rikujton se parashtruesja e kërkesës në kuptim të shterimit të mjetet juridike në kërkesën e saj kishte theksuar se pas vdekjes së nënës së saj nuk ka pasur mjet efektiv juridik në dispozicion. Në këtë kuptim, parashtruesja e kërkesës kishte specifikuar se: “*Në parim, mundësia për kompensim për vdekjen e personit si pasoje e dështimit të shtetit për të mbrojtur të drejtën për jetën paraqet një mjet juridik adekuat dhe të mjaftueshëm [...] Sidoqoftë, në rendin juridik kosovar nuk ekziston një mundësi e tille. Edhe sikur te ekzistonte, fakti qe autoritetet shtetërore nuk kane zhvilluar asnjë procedure penale, disiplinore, apo tjetër ndaj zyrtareve përgjegjës, nënkuption qe ky mjet juridik nuk do te kishte gjasa për sukses, ndaj edhe nuk do te ishte efektiv [...]. Sido që të jetë, problemet me (mos)veprimet e autoriteteve qe adresohen në këtë Kërkesë ndërlidhen me probleme zinxhirore e institucionale ne rastin në fjalë që nuk do të mund të adresoheshin me ndonjë mjet tjetër juridik ne Kosove [...]*”.
114. Së dyti, parashtruesja e kërkesës po ashtu kishte theksuar se: “[...] nuk është mjet juridik adekuat as ngritja e kallëzimeve penale apo fillimi i procedurave tjera nga të afërmët e viktimës.” Në këtë kuptim, ajo specifikoi se: “*në çështje që mund të invokojnë përgjegjësinë e shtetit për vdekje te individëve autoritetet duhet të veprojnë në këtë drejtim sipas detyrës zyrtare, pa pritur veprime nga të afërmët e viktimës [...]*”.
115. Gjkata, bazuar në dosjen e lëndës po ashtu vëren se parashtruesja e kërkesës bazuar në nenet 4 dhe 12 të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, kishte parashtruar kërkesa për qasje në dokumente publike, në: (i) Prokurorinë Themelore në Prishtinë; (ii) Gjykatën Themelore në Gjilan; (iii) në ZMNV; dhe (iv) në Shërbimin Korrektues të Republikës së Kosovës. Gjkata vëren se përveç Shërbimit Korrektues, asnjëra nga autoritetet tjera publike nuk i ishte përgjigjur kërkesës së saj për qasje në dokumente.

116. Ashtu siç është cekur më lart, Gjykata i referohet rastit të vetëm të saj ku kjo kishte konstatuar shkelje të së drejtës në jetë të garantuar me nenin 25 të Kushtetutës në lidhje me nenin 2 të KEDNJ-së, përkatësisht rastit KI41/12. Në këtë rast, në shqyrtimin e kriterit të shterimit të mjeteve juridike, Gjykata në paragrafët 48 deri 52 të Aktgjykimit të saj kishte vlerësuar dhe konstatuar si në vijim:

*“48. Gjykata Kushtetuese vëren se, me 26 prill 2010, e ndjera D. K. ka dorëzuar kërkesë në Gjykatën Komunale në Prishtinë për lëshimin e urdhrit për mbrojtje emergjente.*

*49. E ndjera nuk ka pasur ndonjë mjet tjeter juridik, pasi ajo nuk ka pranuar asnjë vendim nga Gjykata Komunale në Prishtinë, që do të pranonte apo që do të refuzonte kërkesën e saj.*

*50. Në anën tjeter, parashtruesit e kërkesës insistojnë se as ata nuk kanë pasur mjete në dispozicion dhe efektive që do të mund t'i ushtronin.*

*51. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se, në bazë të legjislacionit ne fuqi dhe nga përgjigja me shkrim e KGJK-se, ku përshkruhet procedura disciplinore e zhvilluar për këtë rast, e tëra që kanë mundur të bëjnë parashtruesit, është ankesa drejtuar Zyrës se Prokurorit Disiplinor, ndërsa në fazat e mëtutjeshme në komisionin përkatës ne KGJK, dhe se ata nuk kanë pasur mundësi të jetë pale në procedure.*

*52. Prandaj, Gjykata konsideron se parashtruesit nuk kanë pasur ndonjë mjet juridik efektiv në dispozicion, për t'i mbrojtur të drejtat e tyre.”*

117. Në vlerësimin e kriterit të shterimit të mjeteve juridike, Gjykata do t'i referohet edhe praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, përkatësisht praktikës gjyqësore ku kjo e fundit kishte ofruar konstatimet e saj përkitazi me shterimin e mjeteve juridike në kuptim të trajtimit të kërkesës përmes të cilës pretendohet shkelje e nenit 2 të KEDNJ-së e që në mënyrë specifike ndërlidhen me mosveprimet e autoriteteve shtetërore në garantimin e këtyre të drejtave, në kuptimin e obligimeve pozitive.

118. Në këtë aspekt, Gjykata i referohet rastit të GJEDNJ-së *Branko Tomašić dhe të Tjerët kundër Kroacisë*, rr Ethanat e të cilët rast ndërlidheshin me atë se e bija, respektivisht motra e tyre M.T. dhe fëmija i saj, V.T., ishin vrarë nga M.M. [babai i V.T.]. Parashtruesit e kërkesës para GJEDNJ-së pretendonin shkelje të neneve 2 dhe 13 të KEDNJ-së për arsy se sipas tyre autoritetet kroate kishin dështuar të merrnin masat e përshtatshme për të mbrojtur M.T. dhe V.T. nga vrasja dhe nuk kishin zhvilluar hetime efektive për përgjegjësinë e shtetit mbi vdekjen e tyre.

119. GJEDNJ në shqyrtimin e kritereve të pranueshmërisë, përkatësisht shqyrtimit të kriterit të shterimit të mjeteve juridike, kishte theksuar se: “[...] rregulli për shterimin e mjeteve juridike ashtu siç përcaktohet me nenin 35 [të KEDNJ-së] kërkon që parashtruesi të ketë mjetë juridike që ndërlidhen me shkeljet e pretenduara e që në të njëjtën kohë janë në qasshme dhe të mjaftueshme. Ekzistimi i këtyre mjeteve duhet të jetë mjaftueshëm i sigurt jo vetëm në teori por edhe në praktikë, dhe një dështim i kësaj do të rezultonte në mungesë të qasshme qëndruese dhe efektshmërisë; është për Shtetin përgjegjës, që këto kriteret të plotësohen (parografi 35 i Aktgjykimit, dhe referencat e përdorura në këtë rast, si rasti *Selmouni kundër Francës*, nr. 25803/94, Aktgjykim i 28 korrikut 1999, paragrafët 74 dhe 75). Sipas GJEDNJ-së në këtë rast, nisi 35 i KEDNJ-së parashev shpërndarjen e barrës së dëshmërisë, përkatësisht është detyrë e Qeverisë e cila pretendon mosshterim që t'i dëshmojë Gjykatës që mjeti juridik ishte efektiv dhe i qasshëm si në teori ashtu edhe në praktikë në kohën relevante, që nënkupton që ishte i qasshëm, dhe i cili parashev korrigjim përkatës ndaj padisë së ngritur dhe ofron perspektivë të arsyeshme për sukses (parografi 36 i Aktgjykimit, dhe referencat e përdorura aty, si rasti *Akdivar dhe të Tjerët kundër Turqisë*, të cituar më lart, parografi 67). Në vijim, GJEDNJ

përmes Aktgjykimit të saj në këtë rast kishte theksuar së një rregull i tij duhet të aplikohet në kuadër të kontekstit, apo rrethanave specifike të rastit (parografi 37 i Aktgjykimit në rastin *Branko Tomašić dhe të Tjerët kundër Kroacisë*).

120. Përfundimisht, GJEDNJ në rastin e saj *Branko Tomašić dhe të Tjerët kundër Kroacisë* konkludoi se: “[...] duke arritur në këtë konkluzion, [GJEDNJ] ka marrë në konsideratë rrethanat specifike të rastit të tanishëm dhe po ashtu edhe faktin se në pyetje në këtë rast është një drejtë fundamentale si e drejta në jetë” dhe se [KEDNJ] ka për qëllim që të mbrojë të drejta që nuk janë teorike dhe iluzore, por të drejta që janë praktike dhe efektive [...]” (parografi 44, i Aktgjykimit në rastin *Branko Tomašić dhe të Tjerët kundër Kroacisë*). Rrjedhimisht, GJEDNJ kishte konstatuar se kërkesa e parashtruesve të kërkesës në këtë rast ishte e pranueshme dhe kishte vazhduar me shqyrtimin e meritave të rastit.
121. Për pasojë, dhe në kontekst të sqarimëve si më lart, bazuar në kontekstin specifik të rrethanave të rastit dhe praktikën e vet gjyqësore në rastin KI41/12 dhe praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjkata konstaton se parashtruesja e kërkesës nuk ka pasur ndonjë mjet juridik efektiv në dispozicion për të ngritur pretendimet e saj për mosveprime të autoriteteve shtetërore në kuptim të obligimit të tyre pozitiv për parandalimin e vdekjes së të ndjerës S.M..

#### *(iii) Lidhur me saktësimin e kërkesës*

122. Në vazhdim, Gjkata po ashtu shqyrton nëse parashtruesja e kërkesës i ka përbushur edhe kriteret e tjera të pranueshmërisë, të përcaktuara me nenin 48 (Saktësimi i kërkesës) të Ligjit dhe pikën (d) të paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës, të cilat përcaktojnë saktësimin dhe qartësimin e të drejtave dhe lirive të garantuara me Kushtetutë, të cilat pretendohen të janë cenuar.
123. Sa i përket përbushjes së këtij kriteri, Gjkata vëren se parashtruesja e kërkesës i ka qartësuar saktësisht se cilat të drejta të garantuara me Kushtetutë, KEDNJ dhe Konventën e Stambollit, pretendon se i janë cenuar.

#### *(iv) Lidhur me afatin kohor*

124. Gjkata rikujton që nen 49 (Afatet) i Ligjit dhe pika (c) e paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës, përcaktojnë që kërkesa duhet të dorëzohet brenda afatit prej katër (4) muajsh nga data e nxjerrjes së vendimit apo ditës kur vendimi i mjetit të fundit efektiv juridik i është dorëzuar personalisht.
125. Gjkata duke aplikuar konkluzionin e saj të lartcekur se në vlerësimin e përbushjes së kritereve të pranueshmërisë së kërkesës do të aplikojë qëndrimet dhe konstatimet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së në rastet kur janë pretenduar shkeljet e nenit 2 apo 3 të KEDNJ-së, i referohet rastit të GJEDNJ-së, *Opuz kundër Turqisë*, të cilit rast i është referuar edhe parashtruesja e kërkesës në kërkesën e saj.
126. Gjkata fillimisht e rikujton rastin e GJEDNJ-së *Opuz kundër Turqisë*, ku GJEDNJ, ndër të tjera, theksoi se: “[...] duke iu referuar praktikës së saj të mirë vendosur gjyqësore në rastin kur nuk ekzistojnë mjete juridike në dispozicion afati gjashtë-mujor fillon të rrjedhi nga data kur është kontestuar veprimi” (parografi 110, i Aktgjykimit). GJEDNJ, në mënyrë specifike kishte vlerësuar se: “[...] pasi që kishte intervall midis ngjarjeve, Gjkata konsideron se dhuna në tërësinë e saj subjekt i të cilës ishin parashtruesja dhe nëna e saj ishin për një kohë të gjatë nuk mund të konsiderohet si një episod individual dhe i ndarë por duhet që të konsiderohet si një zinxhir ngjarjesh” (parografi 111 i Aktgjykimit). Përfundimisht, GJEDNJ konstatoi se:

*“Duke qenë kështu, [GJEDNJ] vëren se parashtruesja ka dorëzuar kërkesën brenda afatit gjashtë muajve nga dita e vrasjes së nënës së saj nga ana e H.O., e cila ngjarje mund të konsiderohet si momenti kur ajo u vë në dijeni për jo-efektshmérinë e mjeteve juridike në legjislacion vendor, si rezultat i dështimit të autoriteteve për të parandaluar H.O në kryerjen e dhunës së mëtejmë”* (paragrafi 112, i Aktgjykimit në rastin *Opuz kundër Turqisë*).

127. Gjykata duke aplikuar këtë konkludim të GJEDNJ-së në rastin *Opuz kundër Turqisë* në rrrethanat e parashtrueses së kërkesës, vëren se e ndjera S.M. nga L.S ishte vrarë më 14 mars 2021, përderisa parashtruesja e kërkesës kërkesën në saj në Gjykatë e kishe dorëzuar më 13 korrik 2021.
128. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se parashtruesja e kërkesës, kërkesën e saj në Gjykatë e ka dorëzuar brenda afatit të përcaktuar me Ligj dhe Rregullore të punës.

*(v) Lidhur me kushtet e tjera të pranueshmërisë*

129. Në fund, Gjykata konsideron se kërkesa nuk mund të konsiderohet qartazi e pabazuar në kuadër të rregullit 39 (2) të Rregullores së punës dhe nuk ka asnje bazë tjetër për ta shpallur atë të papranueshme, meqë asnje nga kushtet e përcaktuara me rregullin 39 (3) të Rregullores së punës nuk janë të aplikueshme në rastin konkret.

*(vi) Konkluzion përkitazi me pranueshmërinë e kërkesës*

130. Pas vlerësimit të secilit kriter të pranueshmërisë të përcaktuar me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe Rregullore të punës, Gjykata arrin në përfundimin se parashtruesja e kërkesës në kuptim të kërkesës për vlerësimin e (mos)veprimeve të: (i) Gjykatës Themelore në Gjilan; (ii) Prokurorisë Themelore në Gjilan; (iii) Stacionit Policor në Graçanicë; dhe (iv) Prokurorisë Themelore në Prishtinë, në kontekst të detyrimit pozitiv të autoriteteve shtetërore për të mbrojtur të drejtën për jetën të viktimate të dhunës në familje të garantuar me nenin 25 të Kushtetutës në lidhje me nenin 2 të KEDNJ-së dhe nenet 18, 50 dhe 51 të Konventës së Stambollit, është: (i) palë e autorizuar; (ii) duke marrë për bazë kontekstin specifik të rrrethanave të rastit parashtruesja e kërkesës nuk ka pasur mjet efektiv juridik në dispozicion; (iii) ka saktësuar të drejtat dhe liritë të garantuara me Kushtetutë, me KEDNJ dhe Konventën e Stambollit, të cilat pretendon se janë cenuar; (iv) se është plotësuar kriteri i afatshmërisë; (v) kërkesa nuk është qartazi e pabazuar në bazë kushtetuese; dhe se (vi) nuk ka asnje kusht tjetër të pranueshmërisë i cili nuk është plotësuar.
131. Përfundimisht, Gjykata konstaton se në kuptim të plotësimit të kritereve të pranueshmërisë, kërkesa e parashtrueses së kërkesës është e pranueshme dhe në vijim do të shqyrtojë meritat e kërkesës së saj.

### **Meritat e rastit**

132. Gjykata fillimisht rikujton se objekt i vlerësimit të kushtetutshmërisë në këtë rast është nëse (mos)veprimet e autoriteteve publike, përkatësisht ato të Gjykatës Themelore, Prokurorisë Themelore në Gjilan, Stacionit Policor në Graçanicë dhe Prokurorisë Themelore në Prishtinë, kanë: (i) cenuar të drejtën për jetë, të nënës së parashtrueses së kërkesës, të ndjerës S.M., të garantuar me nenin 25 të Kushtetutës në lidhje me nenin 2 të KEDNJ-së, si rezultat i vrasjes së saj nga L.S; dhe (ii) nëse njëkohësisht të njëjta veprime apo mosveprime kanë rezultuar edhe në shkelje të neneve 18, 50 dhe 51 të Konventës së Stambollit.

133. Në këtë kontekst dhe fillimisht, Gjykata rikujton që më 14 mars 2021, nëna e parashtrueses së kërkesës, ishte privuar ngajeta me armë zjarri nga bashkëshorti, përkatësisht babai i parashtrueses së kërkesës, i cili në vendngjarje më pas kishte kryer vetëvrasje.
134. Gjykata rikujton se para privimit të saj ngajeta, më 10 nëntor 2019, e ndjera S.M., në Stacionin Policor në Gjilan kishte raportuar rastin për sulm dhe dhunë të vazhdueshme në familje nga i ndjeri L.S., dhe si rezultat, e njëjtë në Gjykatën Themelore në Gjilan, më 12 nëntor 2019, kishte parashtruar kërkesë për Urdhër Mbrojtje. Gjykata Themelore, më 26 nëntor 2019, kishte nxjerrë urdhrin mbrojtës [C.nr. 1002/2019] ndaj S.M.-së dhe vëllait të saj, në kohëzgjatje prej dymbëdhjetë (12) muajve, me mundësi vazhdimi, por jo më shumë se njëzet e katër (24) muaj. Urdhri mbrojtës kishte skaduar më 26 nëntor 2020. Ashtu siç është reflektuar edhe në kronologjinë e faktave të rastit dhe bazuar edhe në shkresat e lëndës, nga data e skadimit të Urdhrit Mbrojtës deri më 3 mars 2021, kur në Stacionin policor në Graçanicës, nga e bija e të ndjerës S.M., ishte raportuar sérish dhunë në familje, nuk rezulton të ketë informatë nëse ka pasur zhvillime të tjera apo raportime të tjera nga ana e së ndjerës S.M., apo fëmijëve të saj për dhunë në familje.
135. Në vijim, marrë për bazë faktin që Prokuroria Themelore e Gjilanit dhe Gjykata Themelore në Gjilan, kanë zhvilluar procedurat e përcaktuara me ligj, të cilat kanë rezultuar në ngritjen e aktakuzës dhe shpalljen e tij fajtor për kryerje të veprës penale të dhunës në familje, Gjykata në shqyrtimin e pretendimeve të parashtrueses së kërkesës nëse autoritetet përkatëse me veprimet apo mosveprimet e tyre nuk kanë parandaluar apo marrë masat përkatëse për mbrojtje të së ndjerës S.M., dhe fëmijëve të saj, do të përqendrohet në: (i) veprimet e Stacionit Policor në Graçanicë ; dhe (ii) Prokurorisë Themelore në Prishtinë, pas raportimit të dhunës në familje, më 3 mars 2021 deri më 14 mars, ditën kur S.M., u privua ngajeta nga ana e L.S., gjithnjë në kontekst të kronologjisë së ngjarjeve që nga raportimi i parë për dhunë në familje bazuar në shkresat e lëndës, përkatësisht 10 nëntorit 2019.
136. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton se rastit konkret ndërlidhen me dhunë në familje, prandaj në këtë kuptim, Gjykata do të shqyrtojë dhe vlerësojë: (i) pretendimet që ndërlidhen me cenimin e të drejtës për jetën të S.M.-së, të garantuar me nenin 25 të Kushtetutës në lidhje me nenin 2 të KEDNJ-së; dhe (ii) pretendimet për shkelje të neneve 18, 50 dhe 51 të Konventës së Stambollit, duke aplikuar në këtë vlerësim të gjitha parimet e përgjithshme të shtjelluara në këtë Aktgjykim.

### I. Në lidhje me pretendimin për shkelje të së drejtës për jetën

137. Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës pretendon se mosveprimet e autoriteteve shtetërore kanë cenuar të drejtën për jetën të nënës së saj S.M., të garantuar me nenin 25 të Kushtetutës dhe nenin 2 të KEDNJ-së.
138. Paragrafi 1 i nenit 25 të Kushtetutës përcakton që: “*Secili individ gjëzon të drejtën për jetën*”.
139. Përderisa paragrafi 1 i nenit 2 të KEDNJ-së përcakton që: “*E drejta e çdo njeriu për jetën mbrohet me ligj.[...]*”.
140. Gjykata, përmes Aktgjykit të rastit KI41/12, ndër të tjera, kishte theksuar se: “[...] e drejta për jetën është e drejta me e rëndësishme e të gjitha qenieve njerëzore. Është e drejte nga e cila rrjedhin te gjitha të drejtat e tjera”.

141. Gjykata Kushtetuese rikujton se në pajtim me nenin 53 të Kushtetutës, është detyrim i saj kushtetues që interpretimin e të drejtave lirive themelore te njeriut ta bëjë në pajtim me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së. Marrë për bazë natyrën e pretendimeve të parashtrueses së kërkesës, konsideron që çështjet e ngritura në kërkesën e saj para Gjykatës duhet që të shqyrtohen nga këndvështrimi i aspektit përbajtësor të paragrafi 1 të nenit 25 të Kushtetutës në lidhje me paragrin 1 të nenit 2 të KEDNJ-së.

**A. Parimet e përgjithshme për të drejtën në jetë të garantuar me nenin 25 të Kushtetutës dhe nenin 2 të KEDNJ-së**

**1. Obligimet pozitive në kuptim të nenit 25, në lidhje me nenin 2 të KEDNJ-së në kontekst të dhunës në familje**

*(a) Praktika gjyqësore e Gjykatës Kushtetuese*

142. Gjykata fillimisht rikujton se parimet e përgjithshme përkizazi me të drejtën për jetë, të vendosura përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së i ka aplikuar në rastin KI41/12 me parashtrues *Gëzim dhe Makfire Kastrati*, Aktgjykim, i 25 janarit 2013. Parimet e elaboruara dhe aplikuara në këtë rast, kryesisht ishin bazuar në kriteret apo testin e rastit të GJEDNJ-së *Osman kundër Mbretërisë së Bashkuar* (nr. 23452/94, Aktgjykim, i 28 tetorit 1998).
143. Në këtë kuptim, Gjykata duke i afirmuar parimet e vendosura përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-ja, ka theksuar se: “[...] është detyrim i organeve shtetërore që, jo vetëm të përbahen nga marrja e qëllimshme dhe e paligjshme e jetës, por gjithashtu të ndërmarrin hapat e duhur për mbrojtjen e jetës se individëve [...]” (parografi 59 i Aktgjykit të rastit KI41/12). Në vijim, Gjykata gjithashtu ka theksuar se: “...është detyrim i organeve shtetërore që të sigurojnë të drejtën për jetë duke vendosur dispozita penale efektive për të penguar kryerjen e veprave penale kundër individit, të mbështetur nga mekanizmat e zbatimit të ligjit për parandalimin, ndëshkimin dhe shuarjen e shkeljeve të dispozitave të tilla” (shih paragrin 59 të Aktgjykit të rastit KI41/12).
144. Për më tepër, Gjykata gjithashtu ka nënvizuar se detyrimi pozitiv i shtetit për të mbrojtur të drejtën për jetë paraqitet atëherë kur vërtetohet se autoritetet e kanë ditur apo është dashur të dinë për rrezikun real dhe të menjëhershëm kundrejt jetës së një individi dhe kanë dështuar që të ndërmarrin masat e nevojshme brenda fushëveprimit të tyre për ta mënjanuar atë rrezik (shih, rastin e lartcekur, KI41/12 me parashtrues *Gëzim dhe Makfire Kastrati*, parografi 60).
145. Megjithatë praktika gjyqësore e GJEDNJ-së përkizazi me të drejtën në jetë në kontekst specifik të dhunës në familje ka evoluar përgjatë viteve të fundit. Gjykata në vijim të elaborimit të obligimeve pozitive në kuptim të nenit 25 të Kushtetutës në lidhje me nenin 2 të KEDNJ-së, do t'i referohet praktikës gjyqësore relevante dhe më aktuale të GJEDNJ-së e që ndërlidhen me dhunën në familje.

*(b) Praktika relevante gjyqësore e GJEDNJ-së në kontekst të dhunës në familje*

146. Gjykata fillimisht vë në pah se GJEDNJ përmes praktikës së saj gjyqësore kishte theksuar se: “[...] çështja e dhunës në familje, e cila mund të marrë forma të ndryshme që variojnë nga dhuna psikike deri te ajo fizike apo vërbale, tejkalon rrethanat e rastit konkret. [...] Gjykata pranon që meshkujt po ashtu mundtë janë viktimi e dhunës në familje, po ashtu dhe fëmijët, janë shkaktarë të fenomenit, si në

*mënyrë direkte apo indirekte*" (shih rastin *Opuz kundër Turqisë*, të cituar më lart paragafi 132).

147. Gjykata më tej vë në pah se kriteret që ndërlidhen me obligimet pozitive në kontekst të dhunës në familje janë përcaktuar në rastin *Opuz kundër Turqisë* dhe *Kurt kundër Austrisë*, si një ndër rastet kryesore të kësaj gjykate. Megjithatë, praktika gjyqësore e GJEDNJ-së përfshin, por nuk kufizohet edhe në rastet *Kontrova kundër Sllovakisë*, *Branko Tomašić* dhe të *Tjerët kundër Kroacisë*, *Halime Kilic* kundër *Turqisë*, *Talpis* kundër *Italisë*, *Tkheldize* kundër *Gjeorgjisë*, *Y* dhe të *Tjerët kundër Bullgarisë* (nr. 9077/18, Aktgjykim, i 22 marsit 2022) dhe *Landi* kundër *Italisë* (nr. 10929/19, Aktgjykim i 7 prillit 2022). Me qëllim të vazhdimit të elaborimit të kritereve të zhvilluara përmes praktikës relevante gjyqësore të GJEDNJ-së në kontekst të dhunës në familje ndër vite, Gjykata në vijim do të përbledh rr Ethanat e rasteve të GJEDNJ-së si në vijim:
148. Në rastin *Kontrova kundër Sllovakisë* (nr. 7510/04, Aktgjykim i 31 majit 2007), GJEDNJ konstatoi shkelje të nenit 2 të KEDNJ-së për shkak të dështimit të autoriteteve për të mbrojtur jetën e fëmijëve të parashtrueses. Për më tepër ishte konstatuar se njëri nga zyrtarët e përfshirë kishte ndihmuar parashtruesen dhe burrin e saj gjatë modifikimit të ankesës së saj penale të nëntorit 2002 në mënyrë që ajo të mund të trajtohej si një kundërvajtje që nuk do të kërkonte ndonjë veprim të mëtejshëm. Si përfundim, siç e kishin vërtetuar gjykatat vendore dhe qeveria sllovake e kishte pranuar që policia kishte dështuar në obligimet e veta dhe pasoja e drejtpërdrejtë e këtyre dështimeve kishte qenë vdekja e fëmijëve të parashtrueses.
149. Në rastin *Branko Tomašić* dhe të *tjerët kundër Kroacisë*, GJEDNJ fillimisht rikujojti se sipas nenit 2 të Konventës shteti duhet të ndërmarrë hapat e duhur për të mbrojtur jetën e të afërmve të parashtruesve të kërkësës brenda juridikzonit të saj. Sipas GJEDNJ-së kjo përfshin një detyrë parësore të shtetit për të siguruar të drejtën e jetës duke: (i) vendosur dispozita efektive të legjislacionit penal për të penguar kryerjen e veprave kundër personave të mbështetur nga makineria e zbatimit të ligjit për parandalimin, shtypjen dhe ndëshkimin e shkeljeve të tilla; dhe (ii) detyrimin pozitiv të autoriteteve për të marrë masa parandaluese operacionale për të mbrojtur një individ, jeta e të cilit është në rrezik nga veprimet kriminale të një individi tjetër.
150. Rasti *Opuz kundër Turqisë* (kërkesa nr. 33401/02, Aktgjykim, i 9 qershorit 2009) ndërlidhet me atë se parashtruesja dhe nëna e saj u sulmuan dhe kërcënuan për shumë vite nga bashkëshorti i parashtrueses, në raste të ndryshme duke lënë të dy gratë me lëndime kërcënuese për jetën. Përfundimisht, kur dy gratë po përpinqeshin të largoheshin, bashkëshorti i parashtrueses qëlloi për vdekje vjehrrën e tij [nënë e parashtrueses] me arsyetimin se i ishte rrezikuar nderi i tij. Bashkëshorti i parashtrueses ishte dënuar për vrasje me burgim të përjetshëm, por ishte liruar në pritje të ankesës së tij, pas së cilës parashtruesja pretendoi se ai vazhdoi ta kërcënonte atë. Sipas analizës krahasimore të zhvilluar nga GJEDNJ në rastin *Opuz kundër Turqisë*, rezulton që në 11 shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, si në Shqipëri, Austri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Estoni, Greqi, Itali, Poloni, Portugali, San Marino, Spanjë dhe Zvicër, autoritetet janë të obliguara që të vazhdojnë me procedurën penale pavarësisht tërheqjes së viktimit nga ankesa e tij/saj për dhunë në familje (paragafi 87 i Aktgjykimit në rastin *Opuz kundër Turqisë*). GJEDNJ konstatoi shkelje të së drejtës për jetë sipas nenit 2 të KEDNJ-së për vrasjen e nënës së parashtrueses dhe shkelje të nenit 3 (Ndalimi i trajtimit çnerëzor ose degradues) të KEDNJ-së në lidhje me dështimin e shtetit për të mbrojtur parashtruesen e kërkësës. GJEDNJ konstatoi se shteti kishte dështuar të vendosë dhe zbatojë një sistem për ndëshkimin e dhunës në familje dhe mbrojtjen e viktimateve. Autoritetet

madje nuk kishin përdorur masat mbrojtëse në dispozicion dhe kishin ndërprerë procedurat si "çështje familjare" duke injoruar se pse ishin tërhequr ankesat.

151. Në rastin *Talpis kundër Italisë* (Aktgjykim, i 2 marsit 2017), GJEDNJ duke aplikuar kriteret e zhvilluara në rastin *Opuz kundër Turqisë*, konstatoi shkelje të nenit 2 të KEDNJ-së për shkak të vrasjes së djalit të parashtrueses dhe vrasjes së saj në tentativë nga bashkëshorti i saj. GJEDNJ, në veçanti, vlerësoi se autoritetet shtetërore duke mos ndërmarrë masa emergjente mbi ankesën e paraqitur nga parashtruesja, autoritetet italiane e kishin privuar atë ankesë nga çdo efekt, duke krijuar një situatë të mosndëshkimit të favorshëm për përsëritjen e akteve të dhunës, gjë që më pas rezultoi në vrasjen në tentativë të parashtrueses dhe vdekjen e djalit të saj.

152. Rrethanat e rastit *Kurt kundër Austrisë* (Aktgjykim i GJEDNJ-së (Dhoma e Madhe) i 15 qershorit 2021), ndërlidhen me atë se në qershor të vitit 2010, parashtruesja ishte ankuar në polici për rrahje nga bashkëshorti i saj E., kundër të cilit ishte nxjerrë urdhër ndalimi dhe mbrojtjeje që e detyronte atë që të qëndronte larg banesës së tyre, si dhe nga banesa e prindërve të parashtrueses si dhe zonave përreth për 14 ditë. Më pas, në janar të vitit 2011, E., u dënuia për lëndim trupor ndaj saj dhe kërcënim të rrezikshëm ndaj të afërmve. Pas kësaj, parashtruesja nuk raportoi asnjë incident në polici deri më 22 maj 2012, kur ajo bëri kërkësë për divorc dhe denoncoi E. në polici për dhunë në familje në baza ditore në dy muajt e mëparshëm. Ajo gjithashtu deklaroi se nganjëherë ai kishte goditur dy fëmijët e tyre, gjë që ishte konfirmuar nga këta të fundit gjatë intervistimit. Në të njëjtën ditë, një urdhër i ri ndalimi dhe mbrojtjeje ishte nxjerrë kundër E., duke e ndaluar atë të kthehej në banesën e tyre, në banesën e prindërve të parashtrueses dhe në zonat përreth. Ai u ishte marrë në pyetje, iu kishin sekuestruar çelësat si dhe Prokuroria publike kishte inicuar procedurë penale kundër tij. Tre ditë më vonë, ai qëlloi djalin e tyre në shkollë dhe u vetëvra duke qëlluar veten. Më pas, djali vdiq nga plagët e marra. Parashtruesja pa sukses zhvilloi procedurë për përgjegjësi zyrtare duke pretenduar se E. duhej të mbahej në paraburgim. Parashtruesja e kërkësës para GJEDNJ-së pretendoi se autoritetet austriake kishin dështuar që të përbushin detyrimin e tyre pozitiv sipas nenit 2 të KEDNJ-së për të mbrojtur të drejtën në jetë të djalit të saj. Sipas parashtrueses, autoritetet austriake nuk kishin marrë masat e nevojshme për të shmangur këtë rrezik, gjegjësisht që E. të merret në paraburgim pasi ekzistonte rreziku i menjëershëm i kryerjes së veprës penale. Parashtruesja, gjithashtu, pretendoi se kuadri ligjor për mbrojtjen e fëmijëve në kuptim të dhunës në familje kishte qenë i pamjaftueshëm, pasi që në urdhrat e ndalimit dhe mbrojtjes nuk mund të zbatoheshin në ambientet e kujdesit përfshirë fëmijët, duke i lënë fëmijët e saj të pambrojtur në shkollën e tyre. Në këtë Aktgjykim, Dhoma e Madhe e GJEDNJ-së zgjeroi parimet e përgjithshme në kontekst të dhunës në familje në bazë të "testit Osman" (rasti *Osman kundër Mbretërisë së Bashkuar*, i cituar më lart). GJEDNJ përsëriti se autoritetet duhej të jepnin një përgjigje të menjëershëm ndaj pretendimeve për dhunë në familje dhe se prej tyre kërkohej kujdes i veçantë në trajtimin e rasteve të tillë. Autoritetet duhej të përcaktonin: (i) nëse ekzistonte një rrezik real dhe i menjëershëm për jetën e një ose më shumë të identifikuarve viktimat; për këtë qëllim ata kishin përfshirë kryenin një vlerësim të rrezikut që ishte autonom, proaktiv dhe gjithëpërfshirës dhe duhej të vlerësonin realitetin dhe menjëershëmërinë e rrezikut duke marrë parasysh kontekstin e veçantë të rasteve të dhunës në familje; (ii) nëse rezultati i vlerësimit të rrezikut ishte se ekzistonte një rrezik real dhe i menjëershëm për jetën, detyrimi i autoriteteteve për të marrë masa parandaluese operacionale; dhe (iii) masat e tillë duhej të ishin të përshtatshme dhe proporcionale me nivelin e rrezikut të vlerësuar.

153. Në kontekst të këtij rasti, GJEDNJ vlerësoi se nuk ka pasur vonesa ose pasivitet nga ana e autoriteteve në përgjigjen ndaj pretendimeve të parashtrueses për dhunë në familje. Rrjedhimisht, GJEDNJ gjeti se në raport me parashtruesen, vlerësimi i rrezikshmërisë nga ana e autoriteteve austriake kishte qenë autonom, proaktiv dhe gjithëpërfshirës. Për sa i përket çështjes se a kanë qenë apo është dashur autoritetet austriake të jenë në dijeni të rrezikut që i kanosej djalit të parashtrueses, GJEDNJ theksoi se në vlerësimin e rrezikshmërisë ishin të përfshirë zyrtarë policorë me përvojë dhe trajnim përkatës dhe se edhe pse është e vërtetë që vlerësim i veçantë i rrezikut nuk është bërë në mënyrë eksplikite në lidhje me fëmijët, GJEDNJ vlerësoi se në bazë të informacionit të disponueshmë në kohën përkatëse kjo nuk do të kishte ndryshuar situatën. Përfundimisht, GJEDNJ konstatoi se nuk kishte pasur shkelje të nenit 2 të KEDNJ-së në rastin konkret. GJEDNJ konstatoi se autoritetet austriake kishin shfaqur zellin e veçantë të kërkuar për t'iu përgjigjur me shpejtësi pretendimeve të parashtrueses për dhunë në familje. Rrjedhimisht, GJEDNJ konstatoi se asnjë rrezik real dhe i menjëhershëm i një sulmi mbi jetën e fëmijëve nuk ishte i dallueshmë. Prandaj, në rr Ethanat e çështjes në fjalë, sipas GJEDNJ-së, nuk kishte pasur asnjë detyrim të autoriteteve për të marrë masa të mëtejshme operacionale parandaluese veçanërisht në lidhje me fëmijët e parashtrueses, qoftë në hapësira private apo publike, si p.sh. lëshimi i një urdhri ndalimi në lidhje me shkollat e fëmijëve.
154. Kriteret e zhvilluara në rastin *Kurt kundër Austrisë*, GJEDNJ i kishte aplikuar në rastet *Tkhelidze kundër Gjeorgjisë* (nr. 33056/17, Aktgjykim i 8 korrikut 2021), *Y dhe Të Tjerët kundër Bullgarisë* (nr. 9077/18, Aktgjykim, i 22 Marsit 2022) dhe *Landi kundër Italisë* (nr. 10929/19, Aktgjykim, i 7 prillit 2022).

*Parimet dhe kriteret e zhvilluara përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së në kontekst të dhunës në familje*

155. GJEDNJ në rastet e lartekura *Opuz kundër Turqisë* dhe *Kurt kundër Austrisë* kishte theksuar, ndër të tjera, se çështja e dhunës në familje, e cila mund të marrë format e ndryshme që shkojnë nga dhuna fizike në psikologjike apo abuzimi me fjalë tejkalon, rr Ethanat e një rasti individual (shih rastin *Opuz kundër Turqisë*, paragrafi 132 dhe rastin *Kurt kundër Austrisë*, paragrafin 161).
156. Bazuar në këtë të fundit, Gjykata rikuhton se në rastet *Opuz kundër Turqisë* dhe *Kurt kundër Austrisë* janë afirmuar dhe zhvilluar më tej kriteret e përcaktuara në rastin *Osman kundër Turqisë*. Në këtë rast, GJEDNJ kishte specifikuar, ndër të tjera, se: “*Është bazë e përbashkët se detyrimi i shtetit në këtë drejtim shtrihet përej detyrës së tij kryesore për të siguruar të drejtën e jetës duke vënë në vend dispozita efektive të ligjit penal për të penguar kryerjen e shkeljeve kundër personit, të mbështetur nga makineritë e zbatimit të ligjit për parandalimin, shtypjen dhe sanksionimin e shkeljeve të këtyre dispozitave. Prandaj është pranuar nga ata që janë paraqitura para Gjykatës se neni 2 i Konventës në rr Ethanat të mirë definuara të përfshijë obligimin pozitivë të autoriteteve që të ndërmarrin masa operacionale të mbrojnë individin jeta e të cilit është në rrezik nga veprimet kriminale të një individi tjetër. [...]” (paragrafi 115 i Aktgjykit të rastin *Osman kundër Mbretërisë së Bashkuar*).*
157. Në rastin *Opuz kundër Turqisë*, për më tepër, ishte përcaktuar si në vijim: “*Sipas mendimit të [GJEDNJ-së], aty ku ekziston një pretendim se autoritetet kanë shkelur detyrimin e tyrë pozitiv për të mbrojtur të drejtën në jetë në kontekst të detyrës së tyre [...] për të parandaluar dhe luftuar shkeljet kundër personit, duhet të përcaktohet sipas satisfaktionin të tij/saj që autoritetet kishin njojuri apo duhej ta kishin ditur në kohën e ekzistencës së një rreziku real dhe të menjëhershëm për jetën e një individi apo individësh të identifikuar nga veprat penale të një pale të tretë dhe*

*se ata nuk arritën të merrnin masa brenda sferës së pushtetit të tyre që, gjykuar në mënyrë të arsyeshme, mund të pritej nga ata që ta shmangin këtë rrezik. Për më tepër, duke pasur parasysh natyrën e së drejtës së mbrojtur nga neni 2, një e drejtë themelore në skemën e [KEDNJ-së], është e mjaftueshme që një parashtrues të mbështetë se autoritetet nuk bënë gjithçka që mund të pritej në mënyrë të arsyeshme prej tyre për të shmanjur një rrezik real dhe të menjëhershëm për jetën e të cilit ata kanë ose duhet të kenë njohuri. Kjo është një pyetje e cila mund të përgjigjet vetëm në dritën e të gjitha rrethanave të çdo rasti të veçantë (ibid.)*" (paragrafi 130, i Aktgjykimit në rastin *Opuz kundër Turqisë*).

158. Vlerësimi i rrezikut të një kërcënimi real dhe të menjëhershëm tek rastet e dhunës në familje në veçanti, sipas GJEDNJ-së, bëhet duke marrë parasysh kontekstin e veçantë të dhunës në familje, pasi që nuk bëhet fjalë vetëm për një detyrim për t'i ofruar mbrojtje të përgjithshme shoqërisë, por mbi të gjitha për të marrë parasysh përsëritjen e episodeve të njëpasnjëshme të dhunës në familje (shih rastin e GJEDNJ-së, *Tkheldize kundër Gjeorgjisë*, të cituar më lart, paragrafi 49). Kurdo që ka dyshime në lidhje me ekzistimin e dhunës në familje, përkatësisht dhunën ndaj grave, një reagim i menjëhershëm dhe kujdes i mëtejshëm i veçantë kërkohet nga autoritetet për t'u marrë me natyrën specifike të dhunës (shih rastet e GJEDNJ-së, *Tkheldize kundër Gjeorgjisë*, të cituar më lart, paragrafi 48; *Kurt kundër Austrisë*, të cituar më lart, paragrafët 165-166).
159. Përderisa, në një ndër rastet më aktuale të GJEDNJ-së, përkatësisht rastin *Kurt kundër Austrisë*, kjo e fundit në kuptim të dhunës në familje kishte theksuar se: "[...] masa të përgjithshme ligjore dhe të tjera janë të nevojshme për t'u siguruar viktimate të dhunës në familje mbrojtje efektive dhe masa mbrojtëse." (shih paragrafët 162 të Aktgjykimit në rastin *Kurt kundër Austrisë*, si dhe referencat e përdorura në këtë rast). Në po të njëjtin rast, GJEDNJ, më tej kishte theksuar se: "Ekzistenca e një rreziku real dhe të menjëhershëm për jetën (shih paragrafët 158-160 më lart) duhet të vlerësohet duke marrë parasysh kontekstin e veçantë të dhunës në familje. Në një situatë të tillë është mbi të gjitha një çështje e marrjes parasysh të përsëritjes së episodeve të njëpasnjëshme të dhunës brenda njësisë familjare. Prandaj [GJEDNJ] e konsideron të nevojshme të sqarojë se çfarë do të thotë të marrësh parasysh kontekstin dhe dinamikën specifike të dhunës në familje sipas testit Osman" (shih paragrin 162 të Aktgjykimit në rastin *Kurt kundër Austrisë*, si dhe referencat e përdorura; si rasti *Talpis kundër Italisë*, i cituar më lart, paragrafi 122; dhe *Volodina kundër Rusisë* nr. 41261/17, Aktgjykim, i 9 korrikut paragrafi 86; dhe *Munteanu kundër Moldavisë*, nr. 34168/11, Aktgjykim, i 26 majit 2020, paragrafi 70).
160. Në këtë Aktgjykim, Dhoma e Madhe përsëriti se autoritetet duhet të japid: (i) një përgjigje të menjëhershme ndaj pretendimeve për dhunë në familje dhe se prej tyre kërkohet kujdes i veçantë në trajtimin e rasteve të tilla; dhe autoritetet duhet të përcaktojnë (ii) nëse ekzistonte një rrezik real dhe i menjëhershëm për jetën e një ose më shumë të identifikuarve viktimat; për këtë qëllim ata kanë për detyrë të kryejnë një vlerësim të rrezikut që është autonom, proaktiv dhe gjithëpërfshirës; (iii) nëse rreziku është real dhe i menjëhershëm duke marrë parasysh kontekstin e veçantë të rasteve të dhunës në familje, atëherë kjo rezulton në detyrimin e autoriteteve për të marrë masa parandaluese operative dhe të cilat, duhet të janë të përshtatshme dhe proporcionale me nivelin e rrezikut të vlerësuar. Të gjitha këto parime, janë trajtuar dhe specifikuar më tej, përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së.

(i) Detyrimi për tu përgjigjur menjëherë pretendimeve për dhunë në familje

161. GJEDNJ në rastin *Kurt kundër Austrisë* kishte specifikuar se: “[...] nga autoritetet kërkohet një përgjigje e menjëherëshme ndaj akuzave për dhunë në familje [...] Në ato raste kur [GJEDNJ] ka gjetur se autoritetet nuk kanë vepruar menjëherë pas marrjes së një ankesë për dhunë në familje, ajo ka konsideruar se ky dështim për të vepruar ka privuar një ankesë të tillë nga çdo efektshmëri, duke krijuar një situatë pandëshkueshmërie të favorshme për përsëritjen e akteve të dhunës” (shih paragafin 165 të Aktgjykitit në rastin *Kurt kundër Austrisë*, dhe referencat e përdorura; rastet *Halime Kılıç kundër Turqisë*, nr. 63034/11, § 99, Aktgjykim, i 28 qershorit 2016; dhe *Talpis kundër Italisë*, i cituar më lart, parografi 117).
162. GJEDNJ, në vijim kishte theksuar se interpretimi i nenit 2 të KEDNJ-së nuk bëhet në mënyrë të tillë që të imponojë një barrë të pamundur ose joproportionale mbi autoritetet shtetërore dhe jo çdo rrezik i pretenduar pér jetën paraqet obligim për shtetin që sipas KEDNJ-së të marrë masa operacionale për të parandaluar materializimin e rrezikut (shih rastet e GJEDNJ-së, *Branko Tomašić* dhe të tjerët kundër *Kroacisë*, të cituar më lart, parografi 50; *Tkheldize kundër Gjeorgjisë*, të cituar më lart, parografi 49; *Talpis kundër Italisë*, nr. 41237/14, i cituar më lart, parografi 101). Sipas GJEDNJ-së: “...një konsideratë tjetër e rëndësishme është nevoja që policia të ushtrojë kompetencat e saj për të kontrolluar dhe parandaluar krimin në një mënyrë që respekton plotësisht procesin e rregullt dhe garancitë e tjera të cilat në mënyrë legjitime vendosin kufizime në fushëveprimin e tyre për të hetuar krimin dhe për të sjellë shkelësit para drejtësisë” (shih rastin e GJEDNJ-së, *Talpis kundër Italisë*, të cituar më lart, parografi 101). Për më tepër, GJEDNJ ritheksoi se kërkohet kujdes i veçantë nga autoritetet kur merren me rastet e dhunës në familje (shih rastin *Kurt kundër Austrisë*, parografi 166, dhe referencat e përdorura aty).

(ii) Detyrimi në lidhje me vlerësimin e rrezikut

163. Gjkata në vijim vëren se në rastin *Kurt kundër Austrisë* ishte shtuar edhe obligimi për vlerësimin e rrezikut. Sipas analizës krahasimore të zhvilluar nga GJENDJ, kjo e fundit kishte konstatuar: “[...] të gjitha shtetet anëtare zhvillojnë një vlerësimit të rrezikut në mënyrë që përcaktohet nëse një viktimë e dhunës në familje është në rrezik të dhunës së mëtejshme”. Në Aktgjykin e saj, GJEDNJ i referohet edhe nenit 51 të Konventës së Stambollit, përmes të cilit përcaktohet se serioziteti i situatës dhe rreziku për dhunë të ripërsëritur, janë elemente vendimtare të parandalimit në raste të dhunës në familje (parografi 167 i Aktgjykitit, shih dhe referencat e përdorura në këtë paragraf). Për më tepër, GJEDNJ në këtë rast i ishte referuar edhe GREVIO-së [Sekretariatit të Konventës së Stambollit] e cila në cilësinë e palës ndërmjetësuese para GJEDNJ-së në këtë rast kishte theksuar se autoritetet kompetente duhet që të zhvillojnë një vlerësim të rrezikut për viktimat nga momenti i pranimit të ankesës, në mënyrë ideale duke përdorur mjete të standardizuara, ndërkombëtarisht të njohura dhe të bazuara në kërkim me pyetje të paracaktuara të cilat autoritetet duhet që t'i pyesin dhe t'i përgjigjen në mënyrë sistematike (shih paragafin 167 të Aktgjykitit në rastin *Kurt kundër Austrisë*).
164. GJEDNJ, në parim, ka theksuar se vlerësimi i rrezikut të një kërcënimi real dhe të menjëherëshëm, tek rastet e dhunës në familje në veçanti, bëhet duke marrë parasysh kontekstin e veçantë të dhunës në familje, pasi që nuk bëhet fjalë vetëm për një detyrim për t'i ofruar mbrojtje të përgjithshme shoqërisë, por mbi të gjitha për të marrë parasysh përsëritjen e episodeve të njëpasnjëshme të dhunës në familje (shih rastin e GJEDNJ-së, *Tkheldize kundër Gjeorgjisë*, të cituar më lart, parografi 49 dhe rastin *Talpis kundër Italisë*, të cituar më lart, parografi 122). Në lidhje me këtë të

fundit, GJEDNJ kishte specifikuar se kurdo që ka dyshime në lidhje me ekzistimin e dhunës në familje, përkatësisht dhunës ndaj grave, një reagim i menjëherëshëm dhe kujdes i mëtejshëm i veçantë kërkonet nga autoritetet për t'u marrë me natyrën specifike të dhunës (shih rastet e GJEDNJ-së, *Tkheldize kundër Gjeorgjisë*, të cituar më lart, paragrafi 48; *Kurt kundër Austrisë*, të cituar më lart, paragrafët 165-166).

165. Për më tepër, GJEDNJ ka ripërsëritur se sipas nenit 2 të KEDNJ-së, detyrimi për të mbrojtur të drejtën në jetë kërkon një formë të hetimit zyrtar efektiv në rastet kur individët janë vrarë si rezultat i përdorimit të forcës, qoftë nga zyrtarë shtetërorë apo nga individë privatë. Hetimi zyrtar efektiv ka për qëllim zbatimin efektiv të legjislacionit të brendshëm që mbron të drejtën në jetë dhe autoritetet shtetërore duhet të veprojnë me vetiniciativë menjëherë pasi që informohen lidhur me rastin (shih rastet e GJEDNJ-së, *Branko Tomašić dhe të tjerët kundër Kroacisë*, të cituar më lart, paragrafi 62; *Tkheldize kundër Gjeorgjisë*, të cituar më lart, paragrafi 50; *Armani Da Silva kundër Mbretërisë së Bashkuar*, të cituar më lart, paragrafi 230).
166. GJEDNJ, gjithashtu, kishte theksuar se: “[...] e konsideron këtë metodë si të rendësishme për detyrimet pozitive të shtetëve anëtare sipas nenit 2 në kontekstin e dhunës në familje. [GJEDNJ] vëren se për të qenë në gjendje të dinë nëse ekziston një rrezik real dhe i menjëherëshëm për jetën e një viktima të dhunës në familje (krahaso testin Osman në paragrafin 158 më sipër), autoritetet janë nën detyrë të kryejnë një vlerësim të rrezikut vdekjeprurës i cili është autonom, proaktiv dhe gjithëpërfshirës” (shih paragrafin 168 në rastin *Kurt kundër Austrisë*).
167. Sipas GJEDNJ-së: “Termat “autonomë” dhe “proaktivë” i referohen kërkuesës që autoritetet të mos mbështeten vetëm në perceptimin e viktimës për rrezikun, por ta plotësojnë atë me vlerësimin e tyre. Me të vërtetë, për shkak të gjendjes së jashtëzakonshme psikologjike në të cilën gjenden viktimat e dhunës në familje, është një detyrë nga ana e autoriteteve që shqyrtojnë rastin të bëjnë pyetje të duhura me qëllim që të përftojnë të gjithë informacionin e duhur, duke përfshirë agjencitë e tjera shtetërore, në vend që të mbështeten tek viktima për të dhënë të gjitha detajet e duhura” (shih paragrafin 169 të Aktgjykimit në rastin *Kurt kundër Austrisë*).
168. Për më tepër, GJEDNJ ka specifikuar se vlerësimi i rrezikut duhet të jetë edhe gjithëpërfshirës. Termi gjithëpërfshirës sipas GJEDNJ-së në kuptim të vlerësimit të rrezikut mund të përbëjë elemente të hetimit zyrtar që janë njësoj relevante edhe në rastet e dhunës në familje. GJEDNJ në rastin *Kurt kundër Austrisë* kishte theksuar se një vlerësim gjithëpërfshirës mund të përfshijë: (i) *check lista* ta standardizuara, të cilat përmendin faktorë të rrezikut specifik dhe të cilat janë zhvilluar në bazë të një kërkimi të mirëfilltë kriminologjik dhe praktikave më të mira në raste e dhunës në familje, të cilat mund të kontribuojnë në një vlerësim gjithëpërfshirës të rrezikut nga ana e autoriteteve; (ii) trajnime të rregullta dhe ngritje të vetëdijesimit, në mënyrë specifike në lidhje me mjetet e vlerësimit të rrezikut, në mënyrë që të kuptohet dinamika e dhunës në familje, të cilat ia mundësojnë atyre që të vlerësojnë më mirë rrezikun ekzistues, të përgjigjen në mënyrë adekuate dhe të sigurojnë mbrojtje të shpejtë; (iii) autoritete e zbatimit të ligjit duhet që të ndajnë informacion në lidhje me rreziqet dhe të bashkërendojnë mbështetjen me çdo palë tjetër relevante që janë në kontakt me peronat në rrezik (shih paragrafët 171-173 të Aktgjykimit të GJEDNJ-së në rastin *Kurt kundër Austrisë*, ku në këtë Aktgjykim, GJEDNJ i referohet edhe nenit 18 të Konventës së Stambollit dhe komenteve të dhëna nga Sekretariati i GREVIO-së, si palë ndërmjetësuese në procedurë para Dhomës së Madhe të GJENDJ-së).

(iii) Detyrimi në lidhje me masat operacionale

169. Në vijim, GJEDNJ përcaktoi që në qoftë se autoritetet kanë vendosur se ekziston një rrezik real dhe i menjëhershëm për jetën e një apo më shumë individëve të identifikuar, atëherë lind detyrimi i tyre pozitiv për të marrë masa operacionale. Sipas GJEDNJ-së: “*Masa të tillë parandaluese dhe mbrojtëse operacionale kanë për qëllim të shmangin një situatë të rrezikshme sa më shpejt të jetë e mundur [...]*” (shih paragrafin 178 në rastin *Kurt kundër Austrisë*).
170. Në vijim, Gjykata vë në pah se kriteret e rastit *Kurt kundër Austrisë* ishin aplikuar edhe në raste më aktuale të GJEDNJ-së në kontekst të dhunës në familje, përkatësisht në rastin *Y dhe të Tjerët kundër Bullgarisë*, (i) cituar më lart, parografi 89), në të cilin rast ishte vlerësuar nëse: (i) autoritetet duhet që të reagojnë menjëherë në rast të lajmërimit të dhunës në familje; (ii) është bërë një lajmërim i tillë, autoritetet duhet që të vlerësojnë apo verifikojnë nëse ekziston rreziku real dhe i menjëhershëm për jetë të një viktima të identifikuar të dhunës në familje duke ndërmarrë vlerësim autonom, proaktiv dhe gjithëpërfshirës të rrezikut. Autoritetet duhet që të marrin në konsideratë kontekstin e veçantë të dhunës në familje kur janë duke e vlerësuar nëse rreziku është real dhe i menjëhershëm; (iii) nëse nga vlerësimi i rrezikut rezulton që ekziston një rrezik real dhe i menjëhershëm, atëherë autoritetet duhet që të ndërmarrin masa operacionale për të shmanjur rreziku. Këto masa duhet që të jenë adekuate dhe proporcionale me nivelin e vlerësuar të rrezikut. Si rezultat i aplikimit të këtyre kritereve GJEDNJ në rastin *Y dhe Të Tjerët kundër Bullgarisë* në kuptim të obligimeve pozitive të shtetit kishte konkluduar se dështim i autoriteteve për të mbrojtur jetën e një gruaje të vrarë nga bashkëshorti i saj, përkundër ankesave të saj të ndryshme për dhunë në familje në 9 muajt e fundit si dhe ndërmarrjen e masave inadekuate parandaluese, përkatësisht dështimi i autoriteteve për të vlerësuar rrezikun për jetë në çdo rast të lajmërimit nga viktima, kishte rezultuar në cениm të drejtës për jetën, të garantuar me nenin 2 të KEDNJ-së.
171. Përderisa në rastin *Landi kundër Italise* të GJEDNJ-së, kjo e fundit po ashtu kishte konkluduar se: (i) autoritetet italiane nuk kishin treguar kujdesin e duhur dhe si rrjedhojë kishin dështuar në obligimet e tyre pozitive që të mbronin jetën e parashtresës dhe të birit të saj; (ii) autoritetet kishin dështuar në detyrimin e tyre për të bërë vlerësimin proaktiv të rrezikut imediat të përsëritjes së akteve të dhunës të kryera ndaj parashtrueses dhe fëmijëve të saj; (iii) në veçanti, sipas GJEDNJ-së, autoritetet kishin qenë pasive kundrejt rrezikut serioz të keqtrajtimit të parashtrueses, dhe mosveprimet e tyre kishin mundësuar partnerit të saj që të vazhdojë me kërcënime, keqtrajtime dhe rrezik të dhunës së ripërsëritur, si i papenguar dhe i pandëshkuar për këtë; (iv) autoritetet do të duhej që të kishin vlerësuar rrezikun e përsëritjes së dhunës dhe të nxjerrnin masa adekuate, të cilat ishin të përcaktuar me legjispcionin italian, pavarësisht nëse ka pasur ndonjë kallëzim apo ndryshim të perceptimit të rrezikut nga ana e parashtrueses.
172. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të sqaruar më lart, në rrethanat e rastit konkret, Gjykata do të aplikojë kriteret e vendosura nga GJEDNJ, me theks në rastin *Kurt kundër Austrisë*, dhe të afirmuara edhe përmes praktikës së saj gjyqësore në rastet *Y dhe Të Tjerët kundër Bullgarisë* dhe *Landi kundër Italise*, përkatësisht do të shqyrtojë nëse:
  - (i) autoritetet në rastin e lajmërimit të dhunës kanë reaguar menjëherë;
  - (ii) me rastin e lajmërimit, autoritetet shtetërore kanë bërë vlerësimin e rrezikut, përkatësisht kanë vlerësuar nëse ekziston një rrezik i menjëhershëm dhe real për jetën e të ndjerës S.M., dhe nëse ky vlerësim ishte autonom, proaktiv dhe gjithëpërfshirës;

- (iii) autoritetet shtetërore ishin në dijeni apo është dashur të jenë në dijeni që kishte një rrezik real dhe të menjëhershëm; dhe
- (iv) si rezultati i vlerësimit të rrezikut rezulton që ekziston një rrezik i menjëhershëm dhe real, atëherë lind detyrimi për të ndërmarrë masa parandaluese operacionale, të cilat duhet që të jenë adekuate dhe në proporcion me rrezikun e vlerësuar.

## **B. Parimet e përgjithshme për të drejtën në jetë sipas instrumenteve ndërkontëtare, rekomandimeve dhe opinioneve të organizatave ndërkontëtare në kontekst të dhunës në familje**

173. Në kuptim të parimeve të përgjithshme për parandalimin e dhunës ndaj gruas dhe dhunës në familje, Gjkata do t'i referohet edhe instrumenteve ndërkontëtare, rekomandimeve dhe opinioneve të organizatave ndërkontëtare, të cilat gjatë shqyrtimit të pretendimeve të parashtrueses së kërkesës, do të shërbejnë si burim i interpretimit të dispozitave kushtetuese dhe të KEDNJ-së në lidhje me të drejtën për jetë. Në kuptim të kësaj të fundit, Gjkata do t'i: (i) referohet instrumenteve ndërkontëtare, rekomandimeve dhe opinioneve të miratuara nga mekanizmat e Këshillit të Evropës, siç janë: rekomandimi i Këshillit të Evropës, i cili rekomandim ka shërbyer si standard për hartimin dhe miratimin e Konventën e Stambollit; parimeve dhe detyrimeve të përgjithshme të përcaktuara me Konventën e Stambollit, të cilat parime do të elaborohen edhe më tej në lidhje me pretendimin e parashtrueses së kërkesës për shkelje të neneve 18, 50 dhe 51 të saj; për të vazhduar me (ii) Konventën për Eliminim e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas, dhe në lidhje me këtë të fundit, Rekomandimin e Komitetit për Eliminim e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas (në tekstin e mëtejmë: Komiteti i CEDAW) dhe praktikës relevante të këtij Komiteti.

### **1. Këshilli i Evropës**

#### *a. Rekomandimi Rec (2002) 5 për mbrojtjen e grave nga dhuna*

174. Më 30 prill 2002, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës aprovoi "Rekomandimin Rec (2002) 5 për mbrojtjen e grave nga dhuna", i cili në parim përcakton se është në përgjegjësinë dhe në interesin e shteteve mbrojtja e grave nga çfarëdo lloj forme e dhunës dhe nga çdo person.
175. Të tutje, ky Rekomandim përcakton që shtetet duhet të prezantojnë, zhvillojnë dhe/ose pëmirësojnë aty ku është e nevojshme, politikat e brendshme kundër dhunës duke u bazuar në sigurinë dhe mbrojtjen maksimale të viktimave, fuqizimin e grave të viktimiizuara, përshtatjen e legjislacionit civil dhe penale, përfshirë procedurën gjyqësore, ngritjen e vetëdijes publike dhe edukimin e të rinxve, trajnimet e posaçme për profesionistët që merren me dhunën ndaj grave si dhe parandalimin në të gjitha aspektet. Në kontekst specifik të dhunës në familje Komiteti i Ministrave rekomandon që shtetet anëtarë të klasifikonin të gjitha format e dhunës brenda familjes si veprat penale dhe përcaktonin mundësinë e ndërmarrjes së masave, në mënyrë që, *inter alia*, t'i mundësonin gjyqësorit që të aprovojë masa të përkohshme me qëllim të mbrojtjes së viktimave, të ndalojë kryerësin e dhunës që të kontaktojë, komunikojë apo t'i afrohet viktimës, ose të banojë ose të hyjë në zona të definuara. Po ashtu ky Rekomandim specifikon penalizmin e shkeljes së këtyre masave të caktuara ndaj kryerësve të dhunës dhe të vendos një protokoll të detyrueshëm në mënyrë që policia, shërbimet mjekësore dhe ato sociale të respektojnë të njëjtën procedurë.

### *b. Konventa e Stambollit*

176. Gjykata rikujton se më 11 maj 2011, Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës miratoi Konventën e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje, e njohur si Konventa e Stambollit dhe e njëjtë më 11 maj 2011 ishte hapur për nënshkrim në sesionin e 121-të të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës në Stamboll. Si rezultat i ratifikimit të dhjetë të saj nga Andorra më 22 prill 2014, Konventa hyri në fuqi më 1 gusht 2014. Konventa e Stambollit përfshin standardin e përcaktuar përmes Rekomandimit të lartcekur të Këshillit të Ministrave Rec (2002)<sup>5</sup> për mbrojtjen e grave nga dhuna në familje.
177. Gjykata ripërsëritë se dispozitat relevante të Konventës së Stambollit përkizazi me dhunën ndaj grave ishin përdorur edhe si mjet i interpretimit të KEDNJ-së nga GJEDNJ në rastin *Kurt kundër Austrisë*. Në këtë rast, GJEDNJ, duke iu referuar nenit 51 të Konventës së Stambollit kishte theksuar se vlerësimi i rrezikut vdekjeprurës, seriozitetit të situatës dhe rrezikut të dhunës së përsëritur janë elementët thelbësorë në parandalimin e rasteve të dhunës në familje (shih rastin e GJEDNJ-së, *Kurt kundër Austrisë*, të cituar më lart, paragrafi 167).
178. Në vijim të kësaj, Gjykata vë në dukje se çështjen e aplikimit të Konventës së Stambollit në sistemin juridik të Republikës së Kosovës dhe detyrimet që dalin nga kjo Konventë, do t'i elaborojë në pjesën e këtij Aktgjykimi që ndërlidhen me pretendimet e parashtrueses së kërkësës për shkelje të neneve 18, 50 dhe 51 të saj.

## **2. Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas**

179. Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit është njëra nga nëntë instrumentet ndërkombëtare drejtpërdrejtë të zbatueshme në sistemin juridik të Republikës së Kosovës ashtu siç përcaktohet me nenin 22 të Kushtetutës. Gjykata vë në dukje, se parashtruesja e kërkësës nuk ka ngritur apo parashtruar kërkësë për vlerësimin e shkeljes së njërisë nga dispozitat e kësaj Konverte.
180. Megjithatë, me qëllim të trajtimit të pretendimeve të parashtrueses së kërkësës për dështimin e autoriteteve publike për mbrojtjen e të drejtës për jetë të garantuar me nenin 25 të Kushtetutës në lidhje me nenin 2 të KEDNJ-së, Gjykata gjatë shqyrtimit dhe elaborimit të detyrimeve të autoriteteve publike në trajtimin e rastit të dhunës ndaj të ndjerës S.M., dhe masave të ndërmarra nga ato, do t'i referohet edhe Konventës, Rekomandimit nr. 35; dhe rasteve të shqyrtuara nga grupi i ekspertëve i Komitetit CEDAW. Rrjedhimisht, këto të fundit do të shërbejnë si burim i interpretimit të dispozitave përkatëse kushtetuese që ndërlidhen me detyrimin pozitiv të autoriteteve publike për mbrojtjen e të drejtës për jetë të viktimave të dhunës në familje, përkatësisht në rastin konkret detyrimin pozitiv të autoriteteve publike për mbrojtjen e jetës së të ndjerës S.M.
181. Gjykata rikujton se nen 2 i kësaj Konverte, ndër të tjera, përcakton që: “*Shtetet pale dënojnë diskriminimin ndaj grave në të gjitha format, pranojnë të ndjekin me të gjitha mjetet e përshtatshme dhe pa vonesë një politikë të eliminimit të diskriminimit kundrejt grave dhe për këtë arsyet zotohen: [...]*  
*(c) të vendosin një mbrojtje gjyqësore të të drejtave të grave mbi bazën e barabartë me burrat dhe të sigurojnë. nëpërmjet gjykatave kombëtare kompetente dhe institucioneve të tjera publike, mbrojtjen efektive të grave kundër çdo veprimi diskriminues [...].*”

182. Në kuadër të kësaj Konvente, në vitin 2017, Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit ndaj grave (në tekstin e mëtejmi: CEDAW), kishte miratuar Rekomandimin nr. 35 për dhunën ndaj grave i cili përditëson. Ashtu siç është vënë në dukje si më lart përmes këtij dokumenti, ndër të tjera, rekomandohet që: “*Shtetet palë janë përgjegjëse për parandalimin e akteve ose mosveprimeve të tilla nga organet dhe agjentët e tyre, duke përfshirë trajnimin dhe miratimin, zbatimin dhe monitorimin e dispozitave ligjore, rregulloreve administrative dhe kodeve të mirësjelljes, si dhe për hetimin, ndjekjen penale dhe zbatimin e sanksioneve të përshtatshme ligjore ose disiplinore, si dhe dhënien e dëmshpërblimit, në të gjitha rastet e dhunës me bazë gjinore ndaj grave, përfshirë ato që përbëjnë krime ndërkombëtare, dhe në rastet e dështimit, negligencës ose mosveprimit nga ana e autoriteteve publike*”.

(i) *Rastet e shqyrtuara para Komitetit CEDAW*

183. Disa nga rastet e shqyrtuara para Komitetit CEDAW në kontekst të dhunës në familje janë: *A.T kundër Hungarisë* (komunikimi nr. 2/2003, CEDAW/C/36/D/2/2003); *V.K kundër Bullgarisë* (Komunikimi nr. 20/2008, CEDAW/C/49/D/20/2008); *Karen Tayag Vertido kundër Filipineve* (nr. 18/2008 (Dok. i Kombeve të Bashkuara CEDAW/C/46/D/18/2008); *Yildirim kundër Austrisë*, nr. 6/2005 (Dok. i Kombeve të Bashkuara CEDAW/C/39/D/6/2005); dhe *Goekce kundër Austrisë* (nr. 5/2005, CEDAW/C/39/D/5/2005).
184. Në rastin *Şahide Goekce kundër Austrisë*, rrethanat e të cilët ndërlidhen me vrasjen e znj. Goekce nga bashkëshorti i saj para dy vajzave të tyre, Komiteti i CEDAW gjeti se Shteti Palë, në këtë rast Austria, kishte shkelur detyrimin (due diligence) për të mbrojtur të ndjerën *Şahide Goekce*, pasi që policia kishte dështuar t'i përgjigjet menjëherë thirrjes emergjente të saj disa orë para se ajo të privohej ngajeta. Si përfundim, Komiteti CEDAW konstatoi se Austria kishte shkelur të drejtën e *Şahide Goekce* për jetë dhe integritet fizik dhe mendor të garantuar me nenin 2 (a) dhe (c) deri (f) dhe nenit 3 të Konventës për Eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj Grave në lidhje me nenin 1 të kësaj Konverte dhe Rekomandimin nr. 19 të Komitetit CEDAW. Në vijim, Komiteti CEDAW ofroi vërejtje në lidhje me atë se pse prokurori publik nuk do të duhej që të refuzonte kërkesat e policisë për arrestimin e bashkëshortit të saj: “*12.1.15 Edhe pse shteti palë në mënyrë të drejtë pohon se është e domosdoshme që në çdo rast të përcaktojë nëse arrestimi mund të rezultojë në një ndërrhyrje joproporcionale në të drejtat dhe liritë fondamentale e kryesit të një vepre të dhunës në familje, siç është liria e lëvizjes dhe gjykimit të drejtë, megjithatë Komiteti vë në dukje se të drejtat e kryerësit nuk mund të mbizotërojnë të drejtën për jetë të gruas dhe të drejtën për integritet fizik dhe mendor [...].*”

### C. Aplikimi i parimeve të lartcekura në rrethanat e rastit konkret

185. Gjkata që në fillim vë në dukje se gjatë shqyrtimit të pretendimeve të parashtrueses së kërkesës për shkeljen e të drejtës së nënës së saj për jetë, do të aplikojë: (i) praktikën gjyqësore të vet Gjykatës, përkatësisht rastin KI41/12; (ii) parimet dhe kriteret e zhvilluara përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së; dhe (iii) instrumentet ndërkombëtare, drejtpërdrejtë të aplikueshme në sistemin juridik të Kosovës, përkatësisht Konventën për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit dhe Konventësn e Stambollit.
186. Gjkata në vijim, gjatë shqyrtimit të pretendimeve të parashtrueses së kërkesës për shkelje të drejtës për jetë të garantuar me nenin 25 të Kushtetutës dhe nenin 2 të KEDNJ-së, do të aplikojë edhe testin e zhvilluar dhe të aplikuar përmes praktikës gjyqësore më aktuale të GJEDNJ-së, e të shtjelluar më lart, në kontekst të dhunës në familje.

187. Gjykata, duke rikujtuar kronologjinë faktike që nga 10 nëntori 2019, nga dita e raportimit të dhunës në familje, dhe deri më 14 mars 2021, kur ishte privuar ngajeta, e ndjera S.M., vë në dukje edhe një herë se:

- (i) më 10 nëntor 2019, S.M., në Stacionin Policor në Gjilan kishte raportuar rastin për sulm dhe dhunë të vazhdueshme në familje nga i ndjeri L.S., ndërsa më 12 nëntor 2019, kishte parashtruar kërkesë për Urdhër Mbrojtje në Gjykatën Themelore në Gjilan;
- (ii) më 12 nëntor 2019, bashkëshorti L.S., i së ndjerës S.M., ishte intervistuar nga Prokuroria Themelore në Gjilan në cilësinë e të dyshuarit;
- (iii) po të njëjtën ditë, me urdhër të gjyqtarit të procedurës paraprake të Gjykatës Themelore në Gjilan, i njëjtë ishte liruar për procedurë të rregullt, megjithatë me urdhër të prokurorit të rastit, ai po të njëjtën ditë u ndalua për dyzet e tetë (48) orë;
- (iv) po të njëjtën ditë, me urdhër verbal të gjyqtarit të procedurës paraprake në Gjykatën Themelore ishte bastisur edhe shtëpia e L.S.-së;
- (v) më 13 nëntor 2019, Policia e Kosovës dorëzoi kallëzimin penal në Prokurorinë Themelore në Gjilan, dhe për pasojë ishte nxjerrë edhe vendimi i kësaj të fundit për fillimin e hetimit ndaj L.S.-së për shkak të dyshimit të kryerjes së veprave penale, të përcaktuara në paragrafin 1 të nenit 248 (Dhuna në Familje) dhe nënparagrafin 3.1 të nenit 184 (Sulmi) të KPRK-së, duke kërkuar edhe caktimin e paraburgimit ndaj L.S.-së; në lidhje me kallëzimin penal ishte njoftuar edhe ZMNV në Gjilan;
- (vi) më 12 dhjetor 2019, Gjykata Themelore në Gjilan përmes Aktvendimit [P.nr.1042/19] aprovoi kërkesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan dhe L.S.-së i vazhdoi masën e paraburgimit në kohëzgjatje prej dy (2) muajve, gjegjësisht deri më 20 janar 2020;
- (vii) më 25 dhjetor 2019, Prokuroria Themelore në Gjilan ndaj L.S.-së ngriti Aktakuzën [PP.II.1835/19] për shkak të dyshimit se ky i fundit kishte kryer veprat penale të dhunës në familje dhe të sulmit ndaj S.M.-së;
- (viii) më 27 janar 2020, Gjykata Themelore në Gjilan përmes Aktgjykit [P.nr.1042/19], L.S.-në e shpalli fajtor për kryerjen e veprave penale "Dhunë në familje" dhe "Sulm" ndaj S.M.-së, duke e dënuar të njëtin për kryerjen e veprës penale "Dhunë në familje" me nëntëdhjetë (90) ditë burgim dhe me dyqind (200) euro gjobë, ndërsa për kryerjen e veprën penale "Sulm" me tridhjetë (30) ditë burgim; megjithatë kjo gjykatë vendosi që dënim i me burgimit të zëvendësohej me dënim me gjobë në shumë prej një mijë e treqind (1300) eurosh dhe konfiskoi thikë-briskun. Nga kjo rezulton që pas Aktgjykit të Gjykatës Themelore në Gjilan, L.S., ishte liruar ndërsa S.M., në cilësinë e viktims nga e njëjta gjykatë, ishte udhëzuar në kontest civil për kompensim dëmi.

188. Gjykata rikujton që Urdhri Mbrojtës [C. Nr. 1002/2019] i 26 nëntorit 2019 përcaktonte që L.S.-së i ndalohej të shqetësonte S.M.-në, "respektivisht ndalimi i shqetësimit, ofendimit, përuljes apo përbuzjes, mos ta sulmoj apo kërcënoj se do ta sulmoj qoftë fizikisht apo psiqikisht, ta ndjek apo te bllokoj lëvizjen, apo të mos kontaktoj direkt apo indirekt ne çfarëdo forme me palën e mbrojtur dhe masën mbrojtëse të afritit në afërsi prej 100 m nga vendbanimi i palës së mbrojtur", dhe ndalohej që t'i afrohej S.M.-së dhe fëmijëve dhe vëllait të S.M.-së, si në shkollë të fëmijëve ashtu edhe në pjesë të ndryshme të qytetit në afërsi prej 20 m kudo që ndodhet pala e mbrojtur.

189. Gjykata po ashtu rikujton se urdhri mbrojtës i nxjerrë më 26 nëntor 2019 nga ana e Gjykatës Themelore në Gjilan kishte afat prej dy mbëdhjetë (12) muajsh, me mundësi

vazhdimi. Megjithatë, sipas shkresave të lëndës, me arsyetimin e mungesës së kërkesës për vazhdim të tij, ky urdhër mbrojtës kishte skaduar pas kalimit të afatit dyshëmshi (12) mujor, përkatësisht më 26 nëntor 2020.

190. Pas skadimit të urdhrit mbrojtës, Gjykata vëren se:

- (i) Për zhvillimet pas skadimit të urdhrit mbrojtës dhe deri më 3 mars 2021, në shkresat e lëndës nuk ka të dhëna;
- (ii) Më 3 mars 2021, në Stacionin Policor të Graçanicës ishte raportuar sërisht rasti për dhunë në familje në lidhje me S.M.;
- (iii) Të njëjtën ditë, Policia, kishte kontrolluar vendngjarjen, kishe marrë deklaratat përkatës dhe kishte informuar prokurorinë përkatëse;
- (iv) Të nesërmen, më 4 mars 2021, ishte marrë edhe deklarata e L.S.-së; në raportin përkatës të oficerit, ndër të tjera, theksohet që pas kontaktimit të së ndjerës S.M., e njëjta, kishte theksuar se “*nuk është interesuar që të vazhdojë me rastin kundër [L.S.] pasi ka qenë e momentit*”;
- (v) Për veprimet konkrete të ndërmarra prej 4 marsit deri më 14 mars, në shkresat e lëndës nuk ka të dhëna;
- (vi) më 14 mars 2021, S.M., u privua ngajeta me armë zjarri nga bashkëshorti i saj L.S., i cili më pas kreua vetëvrasje.

191. Në kontekst, të zhvillimit të kronologjisë si më lart, Gjykata vëren që raportimi për dhunë në familje më 10 nëntor 2019 në Stacioni Policor në Gjilan, kishte rezultuar me: (i) urdhër mbrojtës; (ii) kallëzim penal; (iii) aktakuzë; dhe (iv) vendim të Gjykatës Themelore në Gjilan për dhunë në familje të datës 27 janar 2020. Ndërsa, raportimi për dhunë në familje në Stacionin Policion në Graçanicë më 3 mars 2021, kishte rezultuar në marrjen e deklaratave fillestare.

192. Në lidhje me zhvillimin e kategorisë së parë të procedurave dhe të cilat kishin përfunduar me dënimin e L.S.-së për dhunë në familje nga Gjykata Themelore në Gjilan, Gjykata rikujton që parashtuesja e kërkesës pretendon, që Prokuroria Themelore në Gjilan dhe Gjykata Themelore në Gjilan, nuk kishin marrë në konsideratë problemet e natyrës psikike të L.S.-së, edhe pse ishin të informuar nga e ndjera S.M. Më saktësisht sipas pretendimeve: (i) Prokuroria Themelore në Gjilan asnjëherë nuk ka kerkuar ekzaminimin psikiatrik te L.S.-së, me gjithë indikacionet për probleme të shëndetit mendor, te cilat ishin burim i sjelljes se tij te dhunshme; (ii) Gjykata Themelore në Gjilan kishte dështuar në vendosjen e masës së trajtimit “psikosocial” në kontekst të procedurave për nxjerrje të urdhrit mbrojtës dhe shpalljes së tij fajtor dhe zëvendësimit të dënit të tij me dënim me gjobë. Në kontekst, Gjykata vë në dukje se në lidhje me këtë pretendim nga autoritetet relevante dhe nga ana e parashtueses së kërkesës nuk ka pranuar informacionet specifike dhe relevante në mënyre që kjo Gjykatë të vazhdojë me shqyrtimin e këtij pretendimi specifik, nga ana e parashtueses së kërkesës.

193. Thënë këtë, Gjykata vë në dukje se sikurse Prokuroria Themelore në Gjilan ashtu edhe Gjykata Themelore në Gjilan, kishin ndërmarrë një numër veprimesh përkatëse dhe kishin zhvilluar procedurë penale kundër L.S.-së, dhe e cila kishte rezultuar në shpalljen e tij fajtor për vepër penale. Megjithatë, Gjykata nuk mund të mos vë theks në faktin që Gjykata Themelore në Gjilan, në kuptim të shqiptimit të dënit për kryerjen e dy veprave penale për dhunë në familje, përkatësisht asaj të dhunës në familje dhe të sulmit, kishte shqiptuar dënim me gjobë.

194. Gjykata më tej vëren që pas raportimit për dhunë në familje të 3 marsit 2021, procedurat përkatëse ishin zhvilluar në mes Policisë së Kosovës, përkatësisht stacionit policor në Gracanicë dhe Prokurorisë Themelore në Prishtinë, dhe

“veprimet apo mosveprimet” e tyre, kishin rezultuar në vrasjen e të ndjerës më 14 mars 2021 nga bashkëshorti i saj. Prandaj, në vlerësimin nëse “veprimet apo mosveprimet”, institucionet përkatëse shtetërore nuk kanë parandaluar apo marrë masat përkatëse për mbrojtje të së ndjerës S.M.-së dhe fëmijëve të saj, Gjykata do të përqendrohet në: (i) veprimet e Policisë; dhe (ii) Prokurorisë Themelore në Prishtinë pas raportimit të dhunës në familje, më 3 mars 2021 deri më 14 mars, ditën kur S.M. u privua nga jeta nga ana e L.S., sigurisht dhe gjithnjë në kontekst të procedurës së ndjekur nga 10 nëntori 2019, kur sipas shkresave të lëndës ishte raportuar për herë të parë dhuna në familje dhe të 27 janarit 2020, kur Gjykata Themelore në Gjilan kishte shpallur të ndjerin L.S., fajtor për veprën penale të dhunës në familje.

195. Gjykata rithekson se objekt vlerësimi i pretendimeve të parashtrueses së kërkesës do të jetë aspekti përbajtësor i nenit 25 të Kushtetutës në lidhje me nenin 2 të KEDNJ-së, gjegjësisht shqyrtimi dhe vlerësimi i asaj nëse autoritete kompetente publike kanë dështuar në detyrimet e tyre pozitive për të mbrojtur të drejtën për jetë të së ndjerës S.M., përkatësisht, nënës së parashtrueses së kërkesës.
196. Ashtu siç është elaboruar edhe më lart në pjesën e këtij Aktgjykimi në lidhje me parimet dhe kriteret e zhvilluara përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së ndër vite, Gjykata do të aplikojë testin që rezulton nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së përkatësisht rastin *Kurt kundër Austrisë*, dhe do të vlerësoj nëse: (i) autoritetet kompetente në detyrimin e tyre për të mbrojtur apo parandaluar cenimin e të drejtës për jetë të së ndjerës S.M.-së, kanë reaguar menjëherë; (ii) autoritetet kompetente, kanë vepruar në pajtim me procedurat në fuqi, për të vlerësuar nëse ekziston një rrezik i menjëhershëm dhe real për jetën e nënës së parashtrueses, vlerësimi ky që duhet të jetë autonom, proaktiv dhe gjithëpërfshirës; (iii) autoritetet kompetente ishin në dijeni apo është dashur të jenë në dijeni që kishte një rrezik real dhe të menjëhershëm për të ndjerën S.M.; dhe (iv) si rezultat i vlerësimit të rrezikut konstatohet që ekziston një rrezik i menjëhershëm dhe real, nëse janë ndërmarrë masa parandaluese operacionale, të cilat duhet që të jenë adekuate dhe në proporcion me rrezikun e vlerësuar. Në vijim, Gjykata do të aplikojë parimet që burojnë nga kriteret e lartcekura, në rrethanat e rastit konkret.

#### **(i) Nëse autoritetet kompetente kanë reaguar menjëherë**

197. Gjykata thekson se, M.S, e bija e së ndjerës S.M., respektivisht motra e parashtrueses së kërkesës, më 3 mars 2021, kishte raportuar rastin "dhunë në familje" në Stacionin Policor në Graçanicë. Sipas raportit të Oficerit të Policisë së Graçanicës, rrëth orës 20.15 patrulla policore doli në vendngjarje, përkatësisht në vendbanimin ku ndodhej e S.M., dhe pas kontaktimit me sektorin e hetimeve, i morën edhe deklaratat e bijës së saj M.S. dhe vet S.M. Sipas informatave të dorëzuara në Gjykatë, rezulton që po të njëjtën ditë, Stacioni Policor kishte njoftuar prokuroren e kujdestare për rastin e iniciuar si "dhunë në familje" dhe të këtë të fundit e kishte njoftuar edhe për veprimet e ndërmarra nga ky stacion policor.
198. Bazuar në atë si më lart, Gjykata vëren se autoritetet kompetente, përkatësisht zyrtarët policorë të Stacionit Policor në Graçanicë, kishin reaguar menjëherë ndaj raportimit të bijës së të ndjerës S.M. për dhunë në familje nga ana e L.S.-së.
199. Gjykata rikujton se zyrtarët policor po ashtu kishin reaguar duke e ftuar L.S.-në, në cilësinë e të dyshuarit për t'i marrë deklaratën lidhur me raportimin e bërrë nga e bija e tij për dhunë ndaj S.M.-së. Gjykata gjithashtu vëren që të njëjtën ditë, zyrtarët policorë të Stacionit Policor në Graçanicë përmes telefonit kishin kontaktuar edhe të ndjerën S.M., e cila, gjithnjë sipas raportit policor të dorëzuar në Gjykatë: (i) kishte deklaruar se nuk kishte mundësi të paraqitej në Stacionin Policor; dhe (ii) zyrtarëve

policor të këtij stacioni iu kishte kërkuar që i ndjeri L.S. të lirohet nga mbajtja. Në fund, Gjykata rikujton edhe Raportin e Oficerit [2021-AT-086] të 4 marsit 2021 ku theksohet se: “...më 03.03.2021 është intervistuar i dyshuarit [L.S.] në cilësinë e të dyshuarit, më pas edhe është njoftuar prokurorja kujdestare e dhunës në familje [H.K] e cila ka udhëzuar që i dyshuarit të lirohet dhe rasti të vazhdon në procedurë të rregullt”.

200. Gjykata më tej, do t'i referohet informatave dhe shpjegimeve të dhëna nga: (i) Policia e Kosovës; (ii) Prokuroria Themelore në Prishtinë; dhe (iii) të gjeturat e Raportit *Ex Officio* të Avokatit të Popullit të i 27 prillit 2021, që ndërlidhen me veprimet e policisë dhe Prokurorisë Themelore në Prishtinë për masat e ndërmarrja nga dita e lirimtë të L.S.-së nga stacioni policor më 4 mars 2021 deri në momentin e privimit nga jeta të së ndjerës S.M nga ana e L.S.-së.
201. Së pari, bazuar në komentet e Policisë së Kosovës ndaj pretendimeve të parashtrueses së kërkuesës dhe dokumenteve të dorëzuara në Gjykatë, Gjykata vëren se pas raportimit të 3 marsit 2021 për dhunë ndaj të ndjerës S.M., ky rast nuk është trajtuar nga hetuesi i dhunës në familje sepse sipas Policisë “zyrtarja përgjegjëse kishte qenë në pushim vjetor” dhe rrjedhimisht, rasti ishte trajtuar nga një hetues tjetër, e i cili “nuk i ka njoftuar institucionet e tjera, përkatësisht, Qendrën për Punë Sociale dhe Mbrojtësin e Viktimave”.
202. Së dyti, Prokuroria Themelore në Prishtinë në përgjigjen e dorëzuar në Gjykatë kishte deklaruar se në ditën kur S.M., ishte privuar nga jeta, rasti i të ndjerës kishte “qenë duke u trajtuar nga organet e drejtësisë dhe në ditën e raportimit të rastit “Prokuroria ishte në fazën e grumbullimit të provave dhe informatave të nevojshme për ndriçimin e rrethanave faktike që nuk kanë qenë të njoitura për organet përkatëse”.
203. Së treti, Gjykata rikujton edhe gjetjet e evidentuara në Raportin *Ex Officio* të Avokatit të Popullit të 27 prillit 2021, ku ky i fundit kishte konstatuar se pas raportimit të rastit nga e bija e S.M.-së në Stacionin Policor në Graçanicë, zyrtarët policorë të këtij stacioni menjëherë kishin dalur në vendin e ngjarjes. Në po këtë raport, konstatohet se më 4 mars 2021, zyrtarët policor kishin intervistuar L.S.-në, në cilësinë e të dyshuarit dhe kishin ftuar edhe S.M. për intervistik, e cila sipas përgjigjes së Policisë dorëzuar Zyrës së Avokatit të Popullit “kishte deklaruar se nuk kishte mundësi të paraqitje në polici dhe kishte kërkuar që L.S. të mos burgosej, por mundësia të lirohej.” Në përgjigjen e dorëzuar në Zyrën e Avokatit të Popullit, Policia kishte konfirmuar se Prokurorja Kujdestare “ishte njoftuar në detaje në lidhje me rastin dhe se kjo e fundit kishte udhëzuar policinë që i dyshuarit L.S. të lirohej dhe rasti të vazhdonte në procedurë të rregullt.” Avokati i Popullit në vijim kishte konstatuar se nga ana e Policisë, nuk ishin respektuar procedurat e Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, “nuk kishin njoftuar QPS-n, mbrojtësin e viktimave apo përfaqësuesin ligjor të viktimës dhe nuk kanë përpiluar raportin.”
204. Bazuar në të lartcekurat, Gjykata vë theks në faktin që: (i) zyrtarët policorë të Policisë në Graçanicë, kishin reaguar menjëherë duke dalë në vend të ngjarjes dhe marrë në intervistë të dyshuarin L.S. Megjithatë, të njëjtit pas pranimit të udhëzimit të Prokuropës kujdestare, kishin liruar L.S.-në dhe raportin e kishin dorëzuar në Prokurori, duke mos njoftuar Mbrojtësin e Viktimave dhe Qendrën për Punë Sociale, përkatësisht duke mos vepruar në pajtim me detyrimet përkatëse të përcaktuara me ligj dhe procedurat standarde të veprimit për të njoftuar QPS-në dhe ZMNV-në; dhe (ii) Prokuroria Themelore në Prishtinë, pas pranimit të raportit nga ana e policisë, në rastin e së ndjerës S.M., nuk kishte ndërmarrë veprime të menjëhershme procedurale.

205. Gjykata gjithashtu thekson që: (i) të referuarit e Policisë së Kosovës, në faktin që “zyrtarja përgjegjëse kishte qenë në pushim vjetor” dhe rrjedhimisht, rasti ishte trajtuar nga një hetues tjetër, e i cili “nuk i ka njoftuar institucionet e tjera, përkatësish, Qendrën për Punë Sociale dhe Mbrojtësin e Viktimate”, nuk është relevant sepse detyrimet pozitive të shtetit në kuadër të nenit 25 të Kushtetutës dhe nenit 2 të KEDNJ-së, nuk mund të varen nga çështje të brendshme organizative të një institucioni, i cili në çdo kohë duhet të ndërmerr të gjitha masat që të sigurohet që ligji dhe rregullativa e aplikueshme zbatohet me përpikmëri; (ii) fakti që e ndjera S.M., mund të ketë deklaruar që “nuk kishte mundësi të paraqitje në polici dhe kishte kërkuar që L.S. të mos burgosej, por mundësish të lirohej”, bazuar në detyrimet pozitive të shtetit të garantuara me nenin 25 të Kushtetutës në lidhje me nenin 2 të KEDNJ-së, si dhe nenet 18 dhe 55 të Konventës së Stambollit, nuk e liron asnje institucion shtetërorë nga detyrimi për të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme të përcaktuara me ligje dhe rregullativë të aplikueshme në mbrojtje të viktimës; dhe (iii) Prokuroria Themelore në Prishtinë, përgjatë një periudhe dhjetë (10) ditore “ishte në fazën e grumbullimit të provave dhe informatave të nevojshme për ndriçimin e rrëthanave faktike që nuk kanë qenë të njoitura për organet përkatëse.”, përkundër faktit që autoritetet kompetente kishin të dhëna të sakta, përkitazi më L.S.-në, sepse i njëjtë tashmë ishte i dënuar për veprën e penale të dhunës në familje si rezultat i raportimit të dhunës të nëntorit 2019.
206. Për pasojë, dhe bazuar në sqarimet si më lart, Gjykata konstaton që reagimi i autoriteteve kompetente, përkatësish Stacionit Policor në Graçanicë dhe Prokurorisë Themelore në Prishtinë, nuk ishte i menjëhershëm.

#### **(ii) Kualiteti i vlerësimit të rrezikut nga autoritetet kompetente**

207. Gjykata vë në pah edhe një herë se GJEDNJ kishte përcaktuar që autoritetet përkatëse shtetërore duhet që faktet t'i shikojë apo shqyrtojë në mënyrën strikte ashtu siç ishin të ditura apo të njoitura për autoritetit në kohën kur kishte ndodhur ngjarja, dhe jo me dobinë e njojurisë së fakteve të rastit të njoitura pas ndodhjes së ngjarjes (benefit of the hindsight) (shih, në lidhje me këtë, rastin *Kurt kundër Austrisë*, paragrafi 195 i Aktgjykit). Në këtë kontekst, dhe bazuar në testin e shtjelluar dhe përcaktuar nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së, Gjykata do të vlerësojë nëse vlerësimi i rrezikut i autoriteteve kompetente ishte vlerësim autonom, proaktiv dhe gjithëpërfshirës.
208. Gjykata rikujton se në lidhje me vlerësimin e rrezikut, Procedurat Standarde të Veprimit (të aprovuara përmes Vendimit nr. 78/2013 të 15 korrikut 2013 të Koordinatorit Nacional kundër Dhunës në Familje në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë), përcaktojnë masat dhe veprimet e autoriteteve përkatëse gjatë trajtimit të rasteve të dhunës në familje. Përveç kësaj, në kohën kur rasti ishte raportuar në Polici nga e bija e S.M më 3 mars 2021, Konventa e Stambollit ishte po ashtu në fuqi, e cila Konventë po ashtu përcakton procedura standarde që ndërlidhen me kualitetin e vlerësimit të rrezikut në raste të njoftimit të viktimeve apo familjarëve për dhunë në familje (në lidhje me këtë shih edhe elaborimin në lidhje me pretendimin e parashtrueses së kërkuesës për shkelje të neneve 18, 50 dhe 51 të Konventës së Stambollit).
209. Sipas Procedurave Standarde të Veprimit (faqe 33 dhe 34 i Procedurave), ndër të tjera, përcaktohet që: “Qëllimi i vlerësimit të rrezikut është që të ndihmojë akterët të vlerësojnë potencialin e vuajtjes së vazhdueshme apo dhunës së shtuar ndaj një viktime nga kryesi i dhunës në familje dhe të sigurohen shërbime dhe mbrojtje e duhur. Vlerësimi i rrezikut bëhet nga Policia me rastin e reagimit fillestar. Ky

vlerësim duhet të kryhet pasi që të merren të gjitha masat e nevojshme emergjente për krijimin e sigurisë për viktimën dhe të gjithë të tjerët. Pas pranimit të informacioneve fillestare, Policia bën vlerësimin e rrezikut për viktimën e dhunës në familje. Vlerësimi i rrezikut duhet të bëhet në prezencën e Mbrojtësit të Victimave dhe kur viktima është fëmijë në prezencë të organit të kujdestarisë. Si pjesë e vlerësimit të rrezikut, policia duhet të përgatitë formën bazike të të dhënave e cila përfshinë: (i) Nevojat emergjente të viktimës; (ii) Identitetin (të dhënat personale); (iii) Vlerësimin e gjendjen dhe nevojave shëndetësore të viktimës; (iv) Vlerësimin e rrethanave të sigurisë; (v) Përshkrimi i shkurtër i rastit: dhe (vi) Nevojën për strehim: po ose jo. Edhe pse parashikohet se policia është institucioni primar përgjegjës për kompletimin e formës bazike gjatë fazës së vlerësimit të rrezikut, në rastet kur viktima është adresuar fillimisht tek akterët tjerë në procedurë, kjo formë bazike duhet të jetë e njejtë duke u bazuar në informatat që i ka ky institucion”.

210. Në vijim të kësaj, Gjykata rikujton se në shtojcën 3 (Forma bazike e të dhënave për viktimën e dhunës në familje) të Procedurave Standarde të Veprimit, janë përcaktuar edhe indikatorë të rrezikut. Indikatorët e rrezikut në këtë shtojcë janë ndarë në indikatorë të rrezikshmërisë së ulët, të rrezikshmërisë së mesme dhe rrezikshmërisë së lartë, respektivisht.
211. Sipas kësaj shtojce indikatorë të rrezikut të mesëm, ndër të tjera, mund të cilësohen kur: “*Kryesi posedon armë; Kryesi shumëherë e kontrollon viktimën dhe shpreh pakënaqësinë për shoqërinë e viktimës; kryesi e kërcënnon viktimën se do ta lëndoje nëse viktima e lë atë dhe ikë nga shtëpia; kryesi ka probleme psikologjike. Sjelljet e tij nuk duken të janë normale. Ai është agresiv dhe i dhunshëm me të tjerët. Ndërsa indikatorë të rrezikut të lartë, ndër të tjera, mund të cilësohen kur: “kryesi e ka kërcënuar viktimën me armë; kryesi është arrestuar disa herë; kryesi nuk frikohet prej policisë e sulmon viktimën edhe në prani të tyre; kryesi e kontrollon çdo aktivitet ditor të viktimës, din çdo detaj rreth viktimës; kryesi ka lënduar viktimën kur ka ikur nga shtëpia dhe i ka sulmuar personat tek të cilët ka qëndruar viktima; kryesi flet për planet për vetëvrasje ose kryesi ka pasur plane për vetëvrasje dhe kryesi ka çrrëgullim psikik dhe nuk i përdor ilaqt”.*
212. Në vijim, Gjykata vëren se sipas Shtojcës 9 (Lista e Kontrollit për Policinë) të Procedurave Standarde të Veprimit, Policia është e detyruar që ta plotësojë këtë listë të kontrollit të rrezikut, e cila ndër të tjera, përfshin veprime dhe marrje masash të ndryshme, ndër të tjera, që pas reagimit ndaj rastit të dhunës, të bëhet edhe vlerësimi i rrezikut; që viktima të informohet për të drejtat e saj; njoftimi Qendrës për Punë Sociale dhe mbrojtësit të viktimate apo përfaqësuesit ligor të viktimës; intervistimi i viktimës, kryesit, fëmijëve dhe dëshmitarëve; dorëzimi i kopjes së formës/ndarja e informacionet me akterët tjerë të përfshirë në proces; përpilimi i raportit lidhur me rastin dhe dorëzimi i kopjes së raportit viktimës, QPS-së, dhe Mbrojtësit të viktimate (ZMNV).
213. Gjykata rikujton se në shkresën e Policisë të dorëzuar në Gjykatë theksohet se:

*“Me datën 07.05.2021 është themeluar komisioni profesional (ad-hoc) për t'i vlerësuar veprimet e zyrtareve përgjegjës policor përkitazi me rastin e dhunës në familje, i paraqitur me 3 mars 2021 ne Stacionin Policor te Gracanicës.*

*Komisioni profesional (ad-hoc) me datën 11.05.2021 ka vizituar stacionin policor Graqanicë për t'i analizuar te gjitha shkresat e lentes dhe veprimet e zyrtareve policore. Komisioni profesional ne raportin e përpiluar me datën 12.05.2021 ka gjetur disa veprime te cilat nuk janë ndërmarr nga zyrtaret përgjegjës policor te stacionit policor Graqanicë si me poshtë:*

- Rasti nuk është trajtuar nga hetuesi i dhunës ne familje (zyrtarja qe trajton këto raste ka qene ne pushim vjetor) por rasti është trajtuar nga hetues tjetër;
  - Hetuesi nuk i ka njoftuar institucionet tjera si janë qendra për punën sociale dhe mbrojtësi i viktimate;
  - Nuk janë plotësuar format bazike, plotësimi i këtyre formave është obligim i Policisë se Kosovës, sipas Procedurave Standarde te Veprimit për mbrojtje nga dhuna ne familje. Kjo forme bazike e të dhënavë duhet te jete konfidenciale duhet të jete ne shërbim vetëm për akteret ne procedure, pra kur viktima dërgohet ne strehimore apo dërgohet tek institucionet tjera për ndonjë shërbim, ndërsa ne rastet kur viktima nuk ka nevoje për strehim apo shërbime tjera, origjinali i formës ruhet ne dosjen e rastit;
  - Nuk është kryer vlerësimi i rrezikshmërisë për rastin dhe nuk është plotësuar forma e vlerësimit te rrezikshmërisë;
  - Nuk është plotësuar lista e kontrollit, e cila kërkohet sipas procedurës standarde te veprimit nacionalë dhe e cila ndihmon Policin e Kosovës qe mos te lëshoj ndonjë gabim eventual gjate trajtimit te rasteve te dhunës ne familje;
  - Nuk është evidentuar, nëse është këshilluar viktima për planin e sigurisë, i cili është shume i rëndësishëm për viktimin e dhunës ne familje.”
214. Rrjedhimisht, bazuar në informatat dhe dokumentacionin e dorëzuar në Gjykatë nga Policia e Kosovës: (i) nuk rezulton që është kryer vlerësimi i rrezikut; (ii) nuk janë plotësuar listat e lartekura sipas Procedurave Standarde të Veprimit; dhe (iii) nuk janë njoftuar Qendra për Punë Sociale dhe Mbrotësi i Viktimate. Gjykata po ashtu rikuhton se dështimi për të ndërmarrë veprime të nevojshme për vlerësimin e rrezikut nga ana e Policisë ishte konstatuar edhe përmes Raportit *Ex Officio* të Avokatit të Popullit.
215. Në raportin e Avokatit të Popullit, ndër të tjera, specifikohej se:

“17.Më 15 prill 2021, përfaqësuesi i Avokatit te Popullit nëpërmjet një shkresë kërkoi informacione nga menaxheri te ZMNV -se ne Prishtine nëse ata ishin vene ne dijeni përkitazi me dhunën ne familje te raportuar ne SP ne Gracanice, me 3 mars 2021. Ne po atë dite, përfaqësuesi i Avokatit te Popullit mori përgjigje se mbrotësi i viktimate nuk ishte njoftuar lidhur me këtë çështje.  
[...]

57.Me 20 prill 2021, Avokati i Popullit mori përgjigje nga Prokuroria Themelore ne Prishtinë, bashke me një shënim zyrtar për rastin (2021-AT-0086. date 15 prill 2021). si dhe shkresat e lëndës që sipas Prokurorisë Policia ia kishte dërguar deri me 19 prill 2021. Nga shkresat e dërguara shihet se te njëjtat kishin të bënин ekskluzivisht me veprimet policore te SP ne Gracanice, me datat 3 dhe 4 mars 2021. Për zhvillimet të tjera pas kësaj date apo sqarime te tjera rreth ngjarjes se datës 14 mars 2021, nuk u mor asnjë lloj informacioni. Avokati i Popullit konstaton se autoritetet përgjegjëse nuk e kishin vlerësuar mjaftueshëm rrezikun potencial te rastit, edhe pse viktima kishte deklaruar përvazhdimësinë e veprimeve te L. S. dhe kishte dhënë indikacione te problemeve me shëndetin mendor.

58. Avokati i Popullit konstaton se kishte munguar koordinimi i veprimeve ndërmjet autoriteteve, gjë që shtron nevojën e përmirësimit të cilësisë dhe sigurisë së shërbimeve për rastet e dhunës në familje dhe forcimin e mekanizmave të cilësisë dhe sigurisë se shërbimeve për rastet e dhunës ne familje dhe forcimin e mekanizmave te kontrollit te secilit institucion, prej momentit te paraqitjes se rastit te dhunës ne familje e deri ne përfundimin e tij.

59. Avokati i Popullit konstaton se zyrtaret policore ne SP ne Gracanice nuk kishin vepruar ne përputhje me dispozitat e Procedurave Standarde te Veprimit

*për Mbrojtje nga Dhuna ne Familje, pasi te njëjtët nuk e kishin njoftuar mbrojtësin e viktimate se duhet te jete prezent me viktimin, si dhe nuk ishte përpiluar ndonjë plan për sigurinë për viktimin.*

*60. Avokati i Popullit rikujton se si pjese përbërëse e parimit te sigurisë juridike garantonohet edhe parimi i pritjes legjitime. Pritjet legjitime mund te krijohen nga politikat publike, deklaratat publike dhe miratimin e praktikave te rregullta. Një pritje e ligjshme mund te cenohet edhe kur zyrtaret publike nuk arrijnë ta zbatojnë një politike ose te ndjekin një procedure. Me gjithë numrin e madh te akteve ligjore qe i referohen mbrojtjes nga dhuna ne familje. instrumenteve ndërkombëtare qe janë te zbatueshme ne vendin tone. Ligjin për Mbrojtje nga Dhuna ne Familje. Ligjin për Mbrojtje nga Diskriminimi. Ligjin për Barazi Gjinore, Kodin Penal, procedurave si dhe ne një mori te akteve te tjera po ashtu deklarimeve te vazhdueshme te zyrtarëve qeveritare për luftimin e dhunës ne familje, duket se nuk janë përmبushur pritjet legjitime ne këtë rast.”*

216. Po ashtu, Gjkata vëren se mungesa e vlerësimit të rrezikut autonom, proaktiv dhe gjithëpërfshirës nga ana e policisë, po ashtu nuk ishte korrigjuar nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, pas pranimit të Raportit të Policisë për raportim të dhunës. Për më tepër, të gjitha faktet rrëth L.S.-së duhet të ishin të njoitura për autoritetet shtetërore, marrë për bazë faktin që L.S., kishte një precedent të arrestimit, urdhër për mbrojtje emergjente të nxjerrë nga Gjkata dhe dënim për vepër penale në vitin 2019. Në kuptim të kësaj, Gjkata vëren se asnjë nga mosveprimet apo dështimet e zyrtarëve policorë për të vlerësuar rrezikun nuk ishte korrigjuar nga ana e Prokurorisë. Në lidhje me këtë, Gjkata rikujton se Prokuroria Themelore në Prishtinë në komentet e saj ndaj pretendimeve të parashtrueses së kërkuesës ka theksuar se përkundër që e ndjera S.M., ka deklaruar se “*nuk është e interesuar të vazhdojë me ndjekjen penale*”, kjo nuk e ka ndaluar Prokurorinë që të ndërmarrë veprime tjera hetimore me qëllim të vërtetimit të veprës penale dhe gjendjes faktike, dhe në mungesë të informatave dhe refuzimit të palës së dëmtuar për bashkëpunim të mëtejmë, ka kërkuar informacione shtesë për të verifikuar arsyen e refuzimit të të ndjerës për të vazhduar me rastin. Në fund, Prokuroria Themelore në Prishtinë përfundon komentet e saj duke theksuar se: “*...prokurori i rastit i cili merret vetëm me rastet dhunë në familje, ka ndërmarrë sipas kompetencave dhe autorizimeve, të gjitha veprimet e nevojshme hetimore dhe ligjore për të trajtuar këtë rast dhe si çdo herë është në mbrojtje dhe shërbim të sigurimit të jetës dhe të drejtave të çdo lloj kategorie kushtetuese të shoqërisë, veçmas të rasteve më të ndjeshme të dhunës në familje që janë rastet më të vështira dhe më të ndjeshme për trajtim sepse çdo herë prekin themellet e familjes dhe shoqërisë*”. Në lidhje me këtë, Gjkata vëren se Prokuroria Themelore në Prishtinë nuk kishte dhënë asnjë sqarim se cilat masa konkrete dhe specifike i kishte ndërmarrë në lidhje me vlerësimin e rrezikut. Për pasojë, rezulton që Prokuroria Themelore në Prishtinë, nuk kishte ndërmarrë masa adekuate për zhvillimin e një vlerësimi autonom, proaktiv dhe gjithëpërfshirës ashtu siç përcaktohet me legjislacionin në fuqi dhe procedurat standarde të veprimit, por edhe garancitë kushtetuese të Republikës së Kosovës.
217. Bazuar në të lartcekurat, Gjkata theksion që Policia e Kosovës, përkatësisht stacioni policor në Graçanicë, nuk ka bërë një vlerësim të rrezikshmërisë autonom, proaktiv dhe gjithëpërfshirës. Kjo sepse, edhe sipas vet shkresave të Policisë së Kosovës por edhe konstatimeve të Avokatit të Popullit, nuk janë ndjekur e zbatuar Procedurat Standarde të Veprimit të Koordinatorit Nacional kundër Dhunës në Familje, përkatësisht dhe ndër të tjera: (i) nuk janë ndjekur hapat procedural të përcaktuara përmes Procedurave Standarde të Veprimit; (ii) nuk janë plotësuar format standarde, përfshirë lista respektive e kontrollit, të vlerësimit të rrezikshmërisë; (iii) nuk është njoftuar Qendra për Punë Sociale; (iv) nuk është njoftuar Mbrojtësi i Viktimate. Të

gjithë këto kritere dhe të cilat nuk janë zbatuar në rrethanat e rastit konkret, burojnë edhe nga detyrimet e Konventës e Stambollit e cila po ashtu përcakton procedura standarde që ndërlidhen me kualitetin e vlerësimit të rrezikut në raste të njoftimit të viktimateve apo familjarëve për dhunë në familje.

218. Për sa i përket, Prokurorit të Shtetit, përkatësisht Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Gjykata vëren që sipas Prokurorisë përkatëse e njëjtë: "...*ishte në fazën e grumbullimit të provave dhe informatave të nevojshme për ndriçimin e rrethanave faktike që nuk kanë qenë të njohura për organet përkatëse.*”, dhe “*prokurori i rastit i cili merret vetëm me rastet dhunë në familje, ka ndërmarrë sipas kompetencave dhe autorizimeve, të gjitha veprimet e nevojshme hetimore dhe ligjore për të trajtuar këtë rast dhe si çdo herë është në mbrojtje dhe shërbim të sigurimit të jetës dhe të drejtave të çdo lloj kategorie kushtetuese të shoqërisë*”. Gjykata thekson që asnë nga përgjigjet e Prokurorisë, nuk kanë saktësuarasnë masë të vetme e cila është ndërmarrë nga datat e raportimit të dhunës, përkatësisht 3 mars 2021 deri në vrasjen e të ndjerës, më 14 mars 2021. Gjykata thekson që autoritetet kompetente kishin të dhëna të sakta, përkitazi më L.S.-në, sepse i njëjtë tashmë ishte i dënuar për veprën e penale të dhunës në familje si rezultat i raportimit të dhunës të nëntorit 2019. Në kontekstini e kronologjisë së rrethanave faktit të rastit së dhunës në familje të S.M-së, periudha kohore prej dhjetë (10) ditësh në të cilën Prokuroria përkatëse ishte “*në fazën e grumbullimit të provave dhe informatave të nevojshme*”, në mënyrë të drejtëpërdrejtë mbështet konstatimin e Gjykatës që kjo prokurori në rrethanat e rastit konkret, nuk kishte vlerësuar rrezikun në mënyrë autonome, proaktive dhe gjithëpërfshirese.
219. Për pasojë, dhe bazuar në sqarimet si më lart, Gjykata konstaton që autoritetet kompetente, përkatësisht Stacioni Policor në Graçanicë dhe Prokuroria Themelore në Prishtinë, nuk kishin bërë vlerësimin e rrezikut në mënyrë autonome, proaktive dhe gjithëpërfshirese, në kundërshtim me garancitë kushtetuese që burojnë nga neni 25 i Kushtetutës në lidhje me nenin 2 të KEDNJ-së, garancitë e përcaktuara me nenet 18 dhe 51 të Konventës së Stambollit dhe Procedurat Standarde të Veprimit.

***(iii) Nëse autoritetet kompetente kanë qenë në dijeni apo është dashur të jenë në dijeni që kishe një rrezik real dhe të menjëhershëm për të ndjerën S.M***

220. Në vijim, Gjykata do të shqyrtojë dhe vlerësojë nëse autoritet përkatëse, në këtë rast Policia në Stacionin Policor në Graçanicë dhe Prokuroria Themelore në Prishtinë ishin në dijeni apo është dashur të jenë në dijeni që kishte një rrezik real dhe të menjëhershëm për të ndjerën S.M., përkatësisht nënën e parashtueses së kërkesës.
221. Gjykata vëren se ky kriter ndërlidhet me atë nëse autoritetet kompetente, përkatësisht Policia e Kosovës dhe Prokuroria Themelore, bazuar në informatat dhe dokumentacionin të cilën e posdonin në atë kohë kur kishin zhvilluar një vlerësim të mirëfilltë të rrezikut. Ashtu siç është elaboruar dhe vlerësuar si më lart, Gjykata konsideron se Policia e Kosovës, gjegjësisht zyrtarët policorë të Stacionit Policor në Gracanicë, do të duhej që të ishin në dijeni në lidhje me të kaluarën kriminale të L.S.-së, përkatësisht kryerjen e veprës penale të dhunës në familje dhe sulmit për të cilat veprat ishte shpallur fajtor nga Gjykata Themelore në Gjilan, e cila po ashtu kishte nxjerrë një urdhër mbrojtës të vlefshëm për dymbëdhjetë (12) muaj.
222. Bazuar në të lartcekurat, Gjykata vlerëson se Policia e Kosovës është dashur të ishte në dijeni për një rrezik real dhe të menjëhershëm që i kanosej të ndjerës S.M. Gjykata më tej vëren që Ligji për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Procedurat Standarde të Veprimit, përcaktojnë, ndër të tjera, Policinë si kontaktin e parë për viktimen e

dhunës në familje. Paragrafi 4 i nenit 24 të Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje përeakton që: “*4. Policia e Kosovës e përpilon raportin lidhur me rastin pavarësisht se a është kryer vepra apo jo, a është ndaluar dikush apo jo dhe një kopje të këtij rapporti ia jatin viktimës, përfaqësuesit të saj ligjor dhe mbrojtësit të viktimës*”.

223. Bazuar në elaborimin si më sipër, Gjykata thekson që autoritetet shtetërore, përkatësish Stacioni Policor në Graçanicë dhe Prokuroria Themelore në Prishtinë, do të duhej që të ishin në dijeni apo posedonin informatat përkatëse që kishte një rrezik real dhe të menjëhershëm për të ndjerën S.M. Gjykata vë theks në faktin që përderisa Stacioni Policor në Graçanicë dhe Prokuroria Themelore, ishin në trajtim të raportimit të dhunës në familje të datës 3 mars 2021, dhe se që nga kjo datë dhe deri në vrasjen e të ndjerës S.M., Prokuroria përkatëse ishte “*në fazën e grumbullimit të provave dhe informatave të nevojshme*”, edhe Policia e edhe Prokuroria Themelore, duhet të kishin marrë parasysh në mënyrë të menjëhershme faktin që, bazuar në raportimin e dhunës së 10 nëntorit 2019: (i) ishte lëshuar një urdhër mbrojtës në kohëzgjatje prej dy mbëdhjetë (12) muajsh; dhe (ii) ishte dënuar për veprën penale të dhunës në familje dhe sulmit nga Gjykata Themelore në Gjilan.
224. Për pasojë, dhe bazuar në sqarimet si më lart, Gjykata konstaton që autoritetet kompetente, përkatësish Stacioni Policor në Graçanicë dhe Prokuroria Themelore në Prishtinë, kanë qenë në dijeni apo është dashur të janë në dijeni që kishte një rrezik real dhe të menjëhershëm për të ndjerën S.M., dhe përkundër këtij fakti, nuk kanë ndërmarrë masat e nevojshme siç janë të saktësuarë, ndër tjera, në Procedurat Standarde të Veprimit, në kundërshtim me garancitë kushtetuese që burojnë nga neni 25 i Kushtetutës në lidhje me neni 2 i KEDNJ-së, garancitë e përcaktuara me nenet 18, 50 dhe 51 të Konventës së Stambollit dhe Procedurat Standarde të Veprimit.

**(iv) Nëse autoritetet përkatëse kanë ndërmarrë masa parandaluese dhe adekuatë në rrëthanat e rastit konkret**

225. Gjykata rikujton se obligimi për ndërmarrjen e masave parandaluese, ndër të tjera, është përcaktuar në nenet 50 dhe 51 të Konventës së Stambollit, dispozitave të Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, dispozita përkatëse të Kodit të Procedurës Penale, Procedurave Standarde të Veprimit, të cilat do të përmblidhen si në vijim:
226. Neni 50 (Reagim, parandalim dhe mbrojtje të menjëhershme), paragrafi 1 i Konventës së Stambollit përcakton që: “*Palët marrin masat e nevojshme legjislativë apo të tjera për të siguruar që agjencitë përgjegjëse të zbatimit të ligjit të përgjigjen ndaj të gjitha formave të dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konverte menjëherë dhe në mënyrë të përshtatshme duke ofruar mbrojtje të mjaftueshme dhe të menjëhershme për viktimat*“.
227. Për më tepër edhe neni 55 (Procedimet *ex parte* dhe *ex officio*) të po të njëjtës Konventë përcakton që: “*Palët sigurojnë që hetimet ose ndjekja penale e veprave penale të parashikuara në përputhje me nenet 35, 36, 37, 38 dhe 39 të kësaj Konverte nuk do të janë tërësisht të varura nga një raport ose ankesë e paraqitur nga një viktimë, nëse vepra penale ishte kryer tërësisht ose pjesërisht në territorin e saj, dhe se procedimi mund të vazhdojë edhe nëse viktima e tërheq deklaratën ose ankesën e tij ose saj*”.
228. Së pari, dhe bazuar në këto dy dispozita të Konventës së Stambollit, Gjykata vëren se obligimi për të ndërmarrë masa parandaluese dhe të menjëhershme ekziston për autoritetet kompetente shtetërore edhe në rast se viktima ka tërhequr raportimin apo ankesën për dhunë në familje.

229. Së dyti, Gjykata vë në dukje se bazuar në nenin 13 (Kërkesat për urdhër mbrojtje ose urdhër mbrojtje emergjente) të Ligjit për Mbrotjtje nga Dhuna, përcaktohet se nga kush dhe në të cilat raste mund të parashtrohet kërkesa për urdhër mbrojtje. Përveç viktimës, kërkesë për urdhër të mbrojtjes mund të paraqesë edhe mbrojtësi i viktimës apo përfaqësuesi i qendrës sociale. Megjithatë Gjykata thekson që në rrethanat e rastit konkret, dhe siç është svaruar më lart, në dështim të përmembushjes së detyrimit për të zbatuar Procedurat Standarde të Veprimit, mbrojtësi i viktimës dhe përfaqësuesi i Qendrës për Punë Sociale, nuk kishin qenë të njoftuar nga zyrtarët policorë në lidhje me raportimin e 3 marsit 2021.
230. Së treti, Gjykata po ashtu vëren se bazuar në nenin 22 (Urdhri për mbrojtjen e përkohshme emergjente) të Ligjit për Mbrotjtje nga Dhuna në Familje, jashtë orarit të punës së gjykatave, kërkesa për urdhër të mbrojtjes së përkohshme emergjente mund t'i paraqitet Policisë së Kosovës nga pala e mbrojtur; përfaqësuesi i autorizuar, ose mbrojtësi i viktimate; personi me të cilin pala e mbrojtur ka lidhje familjare; përfaqësuesi i qendrës për punë sociale ku ka vendbanimin ose vendqëndrimin pala e mbrojtur; personi i cili është në dijeni të drejtpërdrejtë për një vepër ose më shumë vepra të dhunës në familje ndaj kërkuesit kohëzgjatja e të cilat urdhër skadon në fund të ditës së ardhshme gjatë të cilës gjykata punon. Sipas kësaj dispozitë shefi i njësitit rajonal të Policisë së Kosovës kundër dhunës në familje: "...mund të shqiptojë urdhrin për mbrotjtje të përkohshme emergjente dhe të caktojë një ose disa prej masave të përmendura në nenet 5,6,7 dhe 10 të këtij ligji". Këto masa, ndër të tjera, mund të jenë: (i) masa mbrojtëse e ndalimit të afrimit viktimës (neni 5 i ligjit të lartcekur); dhe (ii) masa mbrojtëse e ndalimit të shqetësimit personave të eksposuar (neni 6 i ligjit të lartcekur).
231. Së katërti, gjykata vëren se bazuar në paragrafin 2 të nenit 24 të Ligjit për Mbrotjtje nga Dhuna në Familje: "Nëse ekziston dyshimi i arsyeshëm se është kryer vepra që ka të bëjë me dhunën në familje, Policia e Kosovës e ndalon kryerësin e supozuar në pajtim me ligjin". Bazuar në këtë, Gjykata vëren se Policia kishte kompetencën e ndalimit të L.S.-së dhe në vijim të ndjekë procedurat përkatëse të masave të ndalimit në pajtim me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale.
232. Së pesti, Procedurat Standarde të Veprimit (faqe 37), përcaktojnë që: "Policia mund të udhëzojë akterët tjerë që ndihmojnë viktimën të përpilojnë një plan të sigurisë. Në rastet kur policia e vlerëson se ekziston rrezik për viktimën apo akterët tjerë, policia ofron siguri duke përfshirë shoqërimin dhe sigurimin e transportit gjatë procesit gjyqësor. Policia e Kosovës duhet të ndërmerr të gjitha masat për monitorimin dhe ekzekutimin e menjëhershëm të të gjithë urdhërave mbrojtës. Në rastet kur policia gjatë hetimit të dhunës në familje rezulton se ka elemente të veprës penale ose ka shkelje të urdhërave mbrojtës, komunikon me prokurorin, e njofton me rastin konkret dhe varësisht nga udhëzimet e marra vepron, ndërsa më vonë përpilon kallzimin penal dhe rastin e referon tek Prokurori kompetent".
233. Në fund, Gjykata vë në pah edhe pretendimin e parashtrueses së kërkesës e cila thekson se: "...fakti se e ndjera [S.M.] siç thuhet ne komunikatën e Prokurorisë "nuk dëshiron që më tutje te vazhdoje me rastin" nuk duhet assesi te përbëjë baze për arsyetim te heqjes dore nga ndjekja e veprës penale nga ana e prokurorisë. Vepra penale "dhuna në familje" e përcaktuar me nenin 248 të Kodit 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës, është vepër penale që ndiqet sipas detyrës zyrtare dhe prokurori i rastit nuk ka guxuar që të bazohet në thëniet e viktimës. Madje, kjo parashihet edhe me atë që konsiderohet si "një nga hallkat më të rëndësishme në infrastrukturën ligjore për mbrotjtje nga dhuna në familje" Në lidhje me këtë, parashtruesja e kërkesës i referohet "Procedura[ve] Standarde të Veprimit për

*Mbrojtje nga Dhuna ne Familje në Kosovë*”, gjeqjësisht i referohet përbajtjes së këtij Dokumenti duke cituar se: “*ndjekja e veprave penale është e rëndësishme për sigurinë e Kosovës. Ndjekja e veprave penale është një çështje midis shtetit dhe kryesit/të pandehurit. Viktima është një dëshmitar i veprës penale*”.

- 234. Bazuar në sqarimet e lartcekura, Gjykata thekson që nëse do të ishin zbatuar Procedurat Standarde të Veprimit, që nënkupton, ndër të tjera, edhe informimin me kohë të Qendrës për Punës Sociale dhe Mbrojtësit të Victimave, përkitazi me raportin e 3 marsit 2021 për dhunë në familje, bazuar në ligjet e aplikueshme të Republikës së Kosovë, ndër të tjera, do të ishin të mundshme masat në vijim: (i) bazuar në nenin 13 për Ligjin për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, kërkesa për urdhër të mbrojtjes do të mund paraqitjes edhe nga mbrojtësi i viktimës apo përfaqësuesi i qendrës sociale; (ii) bazuar në nenin 22 të Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, urdhrin të mbrojtjes së përkohshme emergjente, do të mund të nxirre vet Policia, përkatësisht shefi i njësitet rajonal të Policisë së Kosovës, me kërkesë nga palët e autorizuara në këtë nen, përfshirë po jo kufizuar në mbrojtësi i viktimave apo përfaqësuesi i qendrës për punë sociale ku ka vendbanimin ose vendqëndrimin pala e mbrojtur; dhe (iii) bazuar në paragrafin 2 të nenit 24 të Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Policia kishte kompetencën e ndalimit të L.S.-së dhe në vijim të ndjekë procedurat përkatëse të masave të ndalimit në pajtim me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale. Përtej ligjeve të aplikueshme dhe Procedurave Standarde të Veprimit, Gjykata vë në pah, edhe detyrimet që burojnë nga nenet 50, 51 dhe 55 të Konventës së Stambollit, dhe të cilat: (i) theksojnë detyrimin e shtetit për zbatimin e ligjeve të aplikueshme, përkatësisht Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, dispozita përkatëse të Kodit të Procedurës Penale, Procedurave Standarde të Veprimit; dhe për pasojë (ii) detyrimin për të të ndërmarrë masa parandaluese dhe të menjëherëshme për të gjitha autoritetet kompetente shtetërore edhe në rast se viktima ka tërhequr raportimin apo ankesën për dhunë në familje. Ndërsa, përkitazi me Prokurorinë Themelore në Prishtinë, nuk është tashmë kontestuese që në rrëthanat e rastit konkret, nuk ishte ndërmarrë asnjë masë e vetme.
- 235. Për pasojë, dhe bazuar në sqarimet si më lart, Gjykata konstaton që autoritetet kompetente, përkatësisht Stacioni Policor në Graçanicë dhe Prokuroria Themelore në Prishtinë, në kundërshtim me garancitë kushtetuese që burojnë nga nen 25 i Kushtetutës në lidhje me nenin 2 të KEDNJ-së, garancitë e përcaktuara me nenet 18, 50, 51 dhe 55 të Konventës së Stambollit, dhe ligjet e aplikueshme, përfshirë Procedurat Standarde të Veprimit, nuk kanë ndërmarrë masa parandaluese dhe adekuate në rrëthanat e rastit konkret.

#### **(v) Konkluzion i përgjithshëm**

- 236. Gjykata thekson që në rrëthanat e rastit konkret, autoritetet shtetërore, përkatësisht Policia e Kosovës, respektivisht Stacioni Policor në Graçanicë dhe Prokuroria e Shtetit, respektivisht, Prokuroria Themelore në Prishtinë: (i) kanë dështuar në detyrimin e tyre pozitiv për mbrojtje të jetës së S.M.-së, të garantuar me paragrafin 1 të nenit 25 [E Drejta për Jetën] të Kushtetutës dhe paragrafin 1 të nenit 2 (E drejta për jetën) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; dhe (ii) kanë dështuar në përbushjen e detyrimeve të përcaktuara me paragrafin 4 të nenit 18 (Detyrimet e Përgjithshme), paragrafin 1 të nenit 50 (Reagim, parandalim dhe mbrojtje të menjëherëshme), paragrafin 1 të nenit 51 (Vlerësimi i rrezikut dhe menaxhimi i rrezikut) dhe paragrafin 1 të nenit 55 (Procedimet *ex parte dhe ex officio*) të Konventës së Stambollit.
- 237. Kjo sepse, në kundërshtim me garancitë e lartcekura, por edhe ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës, përfshirë Ligjin kundër Dhunës në Familje dhe Procedurat

Standarde të Veprimit, por edhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, dhe në harmoni me të cilën, të gjitha autoritetet publike janë të detyruara të interpretojnë të drejtat dhe liritë themelore, autoritetet kompetente: (i) nuk kanë reaguar menjëherë; (ii) nuk kanë bërë një vlerësim të mirëfilltë dhe të menjëhershëm të rrezikut, dhe i cili duhet të jetë autonom, proaktiv dhe i menjëhershëm; (iii) në rrethanat e rastit konkret, dhe marrë parasysh që L.S., tashmë ishte i dënuar paraprakisht për veprën penale të dhunës në familje, ishin në dijeni apo ishin dashur të jenë në dijeni në lidhje me rrezikun e menjëhershëm dhe real për jetën e S.M.-së, pas raportimit të dhunës në familje të 3 marsit 2021; dhe (iv) nuk kishin ndërmarrë masa parandaluese për të mbrojtur apo parandaluar privimin ngajeta e S.M.-së.

238. Më specifikisht, Gjykata rithekson që:

- (i) Zyrtarët policorë kishin reaguar menjëherë duke dalë në vend të ngjarjes dhe marrë në intervistë të dyshuarin L.S., megjithatë të njëjtë përtej dorëzimit të raportit përkatës në Prokurori, nuk kishin ndjekur Procedurat Standarde të Veprimit, ndër të tjera, duke mos njoftuar Mbrojtësin e Victimave dhe Qendrën për Punë Sociale dhe pas pranimit të udhëzimit të Prokurores kujdestare kishin liruar L.S.-në;
- (i) Zyrtarët policorë në Stacionin Policor në Graçanicë kishin dështuar që të zhvillonin kontrollin e rrezikut dhe planin e sigurisë për S.M.-në sipas Procedurave Standarde të Veprimit, e cili kishte rezultuar në mos njoftimin e Mbrojtësit të Victimave dhe Qendrës për Punë Sociale. Ky mosveprim i zyrtarëve policorë nuk ishte korrigjuar as nga ana e Prokurorisë Themelore në Prishtinë pas dorëzimit të raportit policor;
- (ii) Zyrtarët policorë në Stacionin Policor në Graçanicë dhe Prokuroria Themelore në Prishtinë ishin në dijeni në lidhje me rrezikun real dhe menjëhershëm për jetën e S.M, të paktën që nga data e raportimit të dhunës në familje nga ana e bijës së S.M.-së dhe L.S.-së, përkatësisht më 3 mars 2021;
- (iii) Zyrtarët Policorë dhe Prokuroria Themelore në Prishtinë, si rezultat i mungesës së vlerësimit të rrezikut dështuan që të ndërmarrin masa parandaluese për mbrojtjen e jetës së S.M.-së të cilat masa ata i kishin në dispozicion bazuar në legjislacionin në fuqi të Republikës së Kosovës.

239. Përfundimisht, në drithën e elaborimit dhe vlerësimit të parimeve të lartcekura të përgjithshme, të përcaktuara me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe mekanizmat e lartcekur ndërkombëtarë në kontekst të dhunës në familje dhe të vlerësimit të seçilit kriter të lartcekur, të vendosur përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ, Gjykata konstaton se në rrethanat e rastit konkret, autoritetet shtetërore, përkatësisht Policia e Kosovës, respektivisht Stacioni Policor në Graçanicë dhe Prokurori i Shtetit, përkatësisht Prokuroria Themelore në Prishtinë, kanë dështuar në obligimin e tyre pozitiv për mbrojtje të jetës së S.M., të garantuar me nenin 25 të Kushtetutës dhe nenin 2 të KEDNJ-së.

**II. Në lidhje me pretendimin për shkelje të neneve 18, 50 dhe 51 të Konventës së Stambollit**

**A. Aplikimi i Konventës së Stambollit në sistemin juridik të Kosovës**

240. Më 24 tetor 2018, Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës në bazë të paragrafit 9 të nenit 113 të Kushtetutës, Gjykates i dorëzoi amendamentin e propozuar nr. 25 me kërkesën e vlerësimit nëse ky amendament zgjelon ndonjë nga të drejtat dhe liritë e përcaktuara me Kapitullin II të Kushtetutës. Tetëdhjetë (80) deputetë të Kuvendit të

Republikës së Kosovës kishin propozuar që “në nenin 22, pas paragrafit (8) [të] shtohet paragrafi (9) si në vijim: (9) Konventa e Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje” (shih rastin KO162/18, me parashtrues Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Aktgjykim, i 19 dhjetorit 2018).

241. Bazuar në kërkësën e dorëzuar në Gjykatë, deputetët të cilët kishin propozuar miratimin e amendamentit theksonin se: “*Shteti si i tillë duhet të ketë përgjegjësi nëse nuk i përgjigjet shkeljes së të drejtave të njeriut që i parasheh kjo konventë*”. Në vijim të njëjtë po ashtu konsideron se: “*Shteti si i tillë duhet të ketë përgjegjësi nëse nuk i përgjigjet shkeljes së të drejtave të njeriut që i parasheh kjo konventë*”. [...] veprat e tillë si: gjyktimi gjinorë, martesën e detyruar, përndekjen, abortin dhe sterilizimin e detyruar. Kjo do të thotë që shteti ynë t'i përfshijë për herë të parë këto vepra penale në sistemin tonë ligjor si dhe t'i mbështesë veprat e tjera që janë pjesë e kodit penal. Përmes kësaj konvente, do të tentojmë të ndryshojmë sjelljen e shoqërisë, të roleve dhe stereotipave gjinore që e bëjnë të pranueshme dhunën ndaj grave, trajnime të profesionistëve që punojnë me viktimat [...]” (shih paragrafët 31, 32 dhe 34 të Aktgjykimit në rastin KO162/18).
242. Gjykata po ashtu rikujton se si rezultat i shqyrimit të draft-amendamentit nr. 25 të Kushtetutës të referuar në Gjykatë, kjo e fundit përmes Aktgjykimit të saj KO162/18 kishte konstatuar se: “*Në dritën e asaj që u tha më lart, Gjykata konsideron se formulimi i amendamentit të propozuar nuk zvogëlonasnë nga të drejtat dhe lirite e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës. Për më tepër, ajo vetëm i avancon dhe i zhvillon këto të drejta*” (parografi 51 i Aktgjykimit).
243. Gjykata në këtë kuptim rikujton që nen 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] i Kushtetutës liston marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare që kanë zbatim të drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës. Në përputhje me nenin 22 të Kushtetutës, marrëveshjet dhe instrumentet e listuara zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike.
244. Më 25 shtator 2020, Kuvendi i Republikës së Kosovës miratoi Amendamentin nr.25 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës përmes të cilit Konventa e Stambollit u shtua në listën e marrëveshjeve të nenit 22 të Kushtetutës, të cilat zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës. Si rrjedhojë e aprovimit të këtij amendamenti nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, Konventa e Stambollit në Republikën e Kosovës tanimë është drejtpërdrejte e zbatueshme në sistemin juridik të Republikës së Kosovës.
245. Ashtu siç është elaboruar më lart, Gjykata rikujton se si rezultat i miratimit të Amendamentit kushtetues nga ana e Kuvendit më 25 shtator 2020, ky i fundi i dha efekt të drejtpërdrejtë Konventës së Stambollit në sistemin juridik të Republikës së Kosovës. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata gjen se Konventa e Stambollit ishte në fuqi në momentin e raportimit të dhunës më 3 mars 2021 dhe kur e ndjera S.M. u privua ngajeta dhe si e tillë është e aplikueshme në rrethanat e rastit konkret.
246. Prandaj, në lidhje me aplikueshmërinë e Konventës së Stambollit, Gjykata do të përqendrohet në lidhje me “*veprimet apo mosveprimet*” e autoriteteve shtetërore që i paraprijnë privimit të jetës së S.M. nga momenti i raportimit të dhunës nga bija e saj më 3 mars 2021.

## **B. Parimet e përgjithshme sipas Konventës së Stambollit**

247. Gjykata rikujton qëllimin e Konventës së Stambollit, e cila, ndër tjera, parasheh: (i) *Mbrojtjen e grave nga të gjitha format e dhunës, dhe parandalimi, ndjekja penale dhe eliminimi i dhunës kundër grave dhe dhunës në familje; (ii) Kontributin ndaj eliminimit të të gjitha formave të diskriminimit kundër grave dhe promovimi i barazisë thelbësore midis burrave dhe grave, duke përfshirë mënyrat me anë të fuqizimit të grave; (iii) Hartimin e një kuadri gjithëpërfshirës politikash dhe masash përmes mbrojtjen dhe ndihmën përmes të gjitha viktimat e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje; (iv) Ofrimin e mbështetjes dhe ndihmës përmes organizatat dhe agjencitë e zbatimit të ligjit përmes të bashkëpunuar në mënyrë efektive, me qëllim miratimin e një përqasjeje të integruar dhe përmes të eliminuar dhunën kundër grave dhe dhunën në familje*” (shih paragrafin 39 të Aktgjykimit në rastin KO162/18).
248. Në vijim, Gjykata ripërsërit se parashtruesja e kërkesës ka pretenduar shkelje të neneve 18, 50 dhe 51 të Konventës, megjithatë Gjykata vlerëson se pretendimet e saj në thelb ngritin edhe çështje që ndërlidhen me detyrime të autoriteteve shtetërore që përcaktohen edhe me nenin 55 (*Procedimet ex parte dhe ex officio*) të Konventës. Si rezultat i kësaj, Gjykata në vijim, gjatë vlerësimit të pretendimeve të parashtrueses së kërkesës do të elaburojë parimet dhe detyrimet e përcaktuara me nenet 18, 50, 51 dhe 55 të Konventës, dhe të njëjtat do t'i aplikojë edhe në rr Ethanat e rastit konkret.
249. Gjykata, si më lart, ka sqaruar se në lidhje me detyrimet e shteteve palë që dalin nga dispozitat e Konventës së Stambollit në rastet e dhunës në familje në shqyrtim para GJEDNJ-së, përkatesisht rastin *Kurt kundër Austrisë*, këto detyrime apo veprime të përcaktuara përmes kësaj Konverte kishin shërbyer në zhvillimin e testit apo kritereve përmes të përcaktuar nëse autoritetet përkatëse kishin respektuar detyrimin e tyre pozitiv përmes mbrojtjen e jetës të garantuar me nenin 2 të KEDNJ-së. Rrjedhimisht, dispozitat relevante të Konventës së Stambollit dhe kontributi i GREVIO-së si palë ndërmjetësuese në këtë rast kishte shërbyer si burim i interpretimit të nenit 2 të KEDNJ-së ne rr Ethanat e këtij rasti para GJEDNJ-së.
- (i) *Detyrimet e autoriteteve publike të Republikës së Kosovës sipas dispozitave të Konventës së Stambollit*
250. Gjykata në vijim i referohet nenit 18 (Detyrimet e përgjithshme) të Konventës së Stambollit dhe Raportit Shpjegues të saj.
251. Së pari në lidhje me paragrafin 1 të nenit 18 të Konventës së Stambollit, Raporti Shpjegues parasheh që ky paragaf:

*[...] përmban detyrimin e përgjithshëm përmarrjen e masave legjislative ose masa të tjera përmes mbrojtjen e të gjitha viktimate brenda territorit të tyre nga çdo akt tjeter dhune i mbuluar me këtë Konventë. 113. Në përputhje me qasjen e përgjithshme të të gjitha agjencive dhe gjithëpërfshirëse të promovuar me Konventë, parografi 2 kërkon nga Palët në Konventë të sigurojnë që, në përputhje me ligjin e brendshëm, ekzistojnë mekanizmat e duhur që sigurojnë bashkëpunim efektiv midis agjencive të mëposhtme, të cilat hartuesit kanë identifikuar si relevante: gjyqësorin, prokurorët publike, agjencitë e zbatimit të ligjit, autoritetet lokale dhe rajonale dhe OJQ-të. Duke shtuar “organizata të tjera përkatëse”, hartuesit kanë siguruar që kjo listë nuk është shteruese përmë lejuar bashkëpunimin me çdo organizatë tjeter që një Palë mund ta konsiderojë të rendësishme. Termi “mekanizëm” i referohet çdo strukture formale ose joformale, siç janë protokollet e dakorduara, tryezat e rrumbullakëta ose çdo metodë tjeter që mundëson një numër profesionistësh të bashkëpunojnë në një*

mënyrë të standardizuar. Nuk kërkon ngritjen e një organi apo institucionit zyrtar.

114. Theksi i vënë në bashkëpunimin ndërmjet këtyre aktorëve buron nga bindja se format e dhunës të mbuluara me Konventë trajtohen më së miri në një mënyrë të bashkërenduar dhe të koordinuar nga një sërë agjencish. [...].”

252. Ndërsa në lidhje me paragrafin 3 të nenit 18, Raporti Shpjegues specifikon se: “116. [...] ky paragraf kërkon çdo masë të tillë pér të marrë parasysh marrëdhëniet midis viktimate, autorëve, fëmijëve dhe mjedisit të tyre më të gjerë pér të shmanqur rrezikun e adresimit të nevojave të tyre në izolim ose pa pranuar realitetin e tyre shoqëror. Hartuesit e konsideruan të rëndësishme që të sigurohet që nevojat e viktimate të vlerësohen në dritën e të gjitha rrëthanave relevante pér të lejuar profesionistët të marrin vendime të informuara dhe të përshtatshme. Termi “qasje e integruar” i referohet qasjes së integruar të bazuar në të drejtat e njeriut të trajtuar si “qasja tre P”, që synon parandalimin, mbrojtjen dhe ndjekjen penale të integruar”.
253. Gjykata në vijim rikujton se paragrafi 4 i nenit 18 përcakton që: “Sigurimi i shërbimeve nuk varet nga gatishmëria e viktimit pér të ngriturakuza ose pér të dëshmuar kundër një autorivpre penale”.
254. Raporti Shpjegues i Konventës së Stambollit në lidhje me parafin 4 të nenit 18 të Konventës thekson së: “121. Qëllimi i paragrafit 4 është të tregojë një ankesë serioze të cilën viktimat e hasin shpesh kur kërkojnë ndihmë dhe mbështetje. Shumë shërbime, publike dhe private, e bëjnë mbështetjen e tyre të varur nga gatishmëria e viktimit pér të ngriturakuza ose pér të dëshmuar kundër autorit. Nëse, pér arsyefrike ose trazirash emocionale dhe lidhjeje, viktima nuk dëshiron të ngrejë akuzë ose refuzon të dëshmojë në gjykatë, ai ose ajo nuk do të marrë këshillim ose strehim. Kjo bie ndesh me parimin e fuqizimit dhe të qasjes së bazuar në të drejtat e njeriut dhe duhet të shmanget. Është e rëndësishme të theksohet se kjo dispozitë i referohet para së gjithash shërbimeve mbështetëse të përgjithshme dhe të specializuara të përmendura në nenet 20 dhe 22 të Konventës – me përjashtim të shërbimeve të ndihmës juridike”.
255. Në vijim, Gjykata i referohet detyrimeve të përcaktuara me nenin 50 (Reagim, parandalim dhe mbrojtje të menjëherëshme) të Konventës i cili përcakton që: (i) Palët marrin masat e nevojshme legjislative apo të tjera pér të siguruar që agjencitë përgjegjëse të zbatimit të ligjit të përgjigjen ndaj të gjitha formave të dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konverte menjëherë dhe në mënyrë të përshtatshme duke ofruar mbrojtje të mjaftueshme dhe të menjëherëshme pér viktimat; dhe (ii) palët marrin masat e nevojshme legjislative apo të tjera pér të siguruar që agjencitë përgjegjëse të zbatimit të ligjit të angazhohen menjëherë dhe në mënyrë të përshtatshme në parandalimin dhe mbrojtjen kundër të gjitha formave të dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konverte, duke përfshirë përdorimin e masave parandaluese operacionale dhe mbledhjen e provave”.
256. Raporti Shpjegues i Konventës së Stambollit në lidhje me nenin 50 të Konventës, ndër të tjera, thekson se përbushja e këtij detyrimi përfshin, pér shembull:

-të drejtën e organeve përgjegjëse të zbatimit të ligjit pér të hyrë në vendin kundodhet një person në rrezik;

– trajtimin dhe dhënien e këshillave viktimate nga agjencitë përgjegjëse të zbatimit të ligjit në mënyrën e duhur;

- dëgjimin e viktimave pa vonesë nga personeli i trajnuar posaçërisht, sipas rastit, femra në ambiente që janë krijuar për të krijuar një marrëdhëniet besimi midis viktimës dhe personelit të zbatimit të ligjit; dhe
- të sigurojë një numër adekuat të zyrtarëve femra të zbatimit të ligjit, përfshire në nivele të larta përgjegjësie.

257. Për më tepër, i njëjti Raport Shpjegues specifikon që autoritetet shtetërorë duhet që të ndërmarrin: “...masa efektive për të parandaluar format më flagrante të dhunës që janë vrasja ose tentativa për vrasje. Çdo rast i tillë duhet të analizohet me kujdes për të identifikuar çdo dështim të mundshëm të mbrojtjes në funksion të përmirësimit dhe zhvillimit të masave të mëtejshme parandaluese”.

258. Së treti, nen 51 (Vlerësimi i rrezikut dhe menaxhimi i rrezikut) i Konventës përcakton që:

1. *Palët marrin masat e nevojshme legjislative apo të tjera për të siguruar që një vlerësim i rrezikut vdekjeprurës, seriozitetit të situatës dhe rrezikut të dhunës së përsëritur të kryhet nga të gjitha autoritetet përkatëse për të menaxhuar rrezikun dhe nëse është e nevojshme për të siguruar mbështetje dhe siguri të koordinuar.*
2. *Palët marrin masat e nevojshme legjislative apo të tjera për të siguruar që vlerësimi i përmendur në paragrafin 1 merr parasysh siç duhet, në të gjitha fazat e hetimit dhe zbatimit të masave mbrojtëse, faktin se autorët e akteve të dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konventë zotërojnë ose kanë akses të armëve të zjarrit.*

259. Raporti Shpjegues i Konventës në lidhje me këtë detyrim të përcaktuar me nenin 51 të Konventës, ndër të tjera, sqaron se: (i) ky nen përcakton detyrimin për të garantuar që të gjitha autoritetet përkatëse, pa u kufizuar vetëm në polici, të vlerësojnë në mënyrë efektive dhe të hartojnë një plan për të menaxhuar rreziqet e sigurisë me të cilat përballet një viktimë e caktuar prej rasti në rast, sipas procedurës së standardizuar dhe në bashkëpunim dhe bashkërendim me njëri-tjetrin; (ii) çdo vlerësim i rrezikut dhe menaxhimi i rrezikut të marrë parasysh mundësinë e dhunës së përsëritur, veçanërisht dhunës vdekjeprurëse, dhe të vlerësojë në mënyrë adekuat seriozitetin e situatës; dhe (iii) vlerësimi i rrezikut duhet të kryhet me synimin për të menaxhuar rrezikun e identifikuar duke hartuar një plan sigurie për viktimin në fjalë, në mënyrë që të ofrohet siguri dhe mbështetje e koordinuar nëse është e nevojshme; dhe vlerësimi i rrezikut të përmendur në paragrafin e parë të këtij nenit merr parasysh siç duhet informata e besueshme për posedimin e armëve të zjarrit nga autorët e akteve të dhunës. Mbajtja e armëve të zjarrit nga autorët jo vetëm që përbën një mjet të fuqishëm për të ushtruar kontroll mbi viktimat, por gjithashtu rrit rrezikun e vrasjes.

260. Në fund, Gjykata vë në dukje se paragrafi 1 i nenit 55 (Procedimet *ex parte* dhe *ex officio*) i Konventës përcakton që: “*Palët sigurojnë që hetimet ose ndjekja penale e veprave penale të parashikuara në përputhje me nenet 35, 37, 38 dhe 39 të kësaj Konverte nuk do të janë tërësisht të varura nga një raport ose ankesë e paraqitur nga një viktimë, nëse vepra penale ishte kryer tërësisht ose pjesërisht në territorin e saj, dhe se procedimi mund të vazhdojë edhe nëse viktima e tërheq deklaratën ose ankesën e tij ose saj*”.

261. Raporti Shpjegues në lidhje me paragrafin 1 të nenit 55 thekson që:

*“Paragrafi 1 vendos për palët detyrimin për të siguruar që hetimet për një numër të kategorive të veprave nuk do të janë “të varura plotësisht” nga rapporti*

*ose ankesa e parashtruar nga një viktimë dhe se çdo procedurë në zhwillim e sipër mund të vazhdojë edhe pasi viktima e ka tërhequr atë ose deklaratën apo ankesën e tij. Hartuesit vendosën të përdorin termat “të varur plotësisht” për të adresuar dallimet procedurale në çdo sistem ligjor, duke pasur parasysh se sigurimi i hetimeve ose ndjekjes penale të veprave të renditura në këtë nen është përgjegjësi e shtetit dhe autoriteteve të tij. Në veçanti, hartuesit ishin të mendimit se aktet që rezultojnë në dëmtim të rëndë trupor ose privim ngajeta duhet të adresohen menjëherë dhe drejtpërdrejt nga autoritetet kompetente. Fakti që shumë nga veprat penale të mbuluara me këtë Konventë kryhen nga anëtarë të familjes, partnerë intimë ose persona në mjedisin e afërt shoqëror të viktimës dhe ndjenjat e turpit, frikës dhe pafuqisë që rezultojnë nga kjo, çonjë në një numër të ulët të raportimeve dhe, më pas, dënimëve. Prandaj, autoritetet e zbatimit të ligjit duhet të hetojnë në mënyrë proaktive për të mbledhur prova të tilla si prova thelbësore, dëshmi të dëshmitarëve, ekspertizë mjekësore, etj., në mënyrë që të sigurohet që procedura mund të kryhet edhe nëse viktima e tërheq atë ose deklaratën ose ankesën e tij të paktën në lidhje me vepra të rënda, si dhuna fizike që rezulton me vdekje ose lëndim trupor.”*

262. Në vijim të këtij elaborimi si më lart, Gjykata vëren se detyrimet e përgjithshme për autoritetet shtetërore të përcaktuar me nenin 18 të Konventës, specifikohen edhe më tej në nenet 50, 51 dhe paragrafin 1 të nenit 55 të saj.
263. Në vijim, Gjykata do t'i referohet edhe gjetjeve dhe rekondimeve të Sekretariatit të mekanizmit monitorues të Konventës së Stambollit dhe Divizonit të Këshillit të Evropës për Barazinë Gjinore, të përpiluara në Vlerësimin e përfarimit, politikave dhe masave të tjera të Kosovës me standarde Konventës së Stambollit (*Raporti për Kosovën*).

*(ii) Vlerësimi i përfarimit, politikave dhe masave të tjera të Kosovës me standarde Konventës së Stambollit (Raporti për Kosovën)*

264. Gjykata në vijim vë në dukje se në nëntor të vitit 2022, Sekretariati i mekanizmit monitorues të Konventës së Stambollit dhe Divizioni i Këshillit të Evropës për Barazinë Gjinore (Njësia e Projekteve për Ngritjen e Kapaciteteve dhe Bashkëpunimit), publikuan vlerësimin e përfarimit, politikave dhe masave të tjera të Kosovës me standarde Konventës së Stambollit. Në pjesën hyrës të këtij Vlerësimi apo Raporti, kjo: “... nismë doli nga përkushtimi i Kosovës për të fuqizuar veprimin e saj për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, nëpërmjet miratimit të një ndryshimi kushtetues, më 25 shtator 2020, i cili i ka dhënë efekt të drejtpërdrejtë Konventës së Stambollit”.
265. Në lidhje me detyrimin për reagimin, parandalimin dhe mbrojtjen e menjëhershme, delegacioni, ndër të tjera, kishte gjetur se:

*“241. Me miratimin e Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje në vitin 2010, janë vënë në përdorim një sërë masash për të ngritur reagimin e policisë ndaj dhunës në familje. Policia e Kosovës ka themeluar Njësitë për Hetimin e Dhunës në Familje (NjHDhF) në secilën komunë, me personel policor gra dhe burra, të cilët janë të trajnuar posaçërisht për t'u marrë me rastet e dhunës në familje. Për më tepër, Procedurat Standarde të Veprimit (PSV) për Mbrojtje nga Dhuna në Familje përcaktojnë metoda të standardizuara dhe të harmonizuara të koordinimit dhe ndërryrjes ndërsektoriale, duke përfshire për zbatimin e ligjit dhe institucionet gjyqësore. PSV-të e mësipërme parashohin që të gjithë zyrtarët policor duhet të përdorin masa proporcionale për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje, ndalimin e kryerësit të dyshuar të dhunës me*

qëllim të parandalimit të dhunës së mëtejshme; dhe të intervistojnë viktimat në dhoma që ofrojnë rehati dhe siguri për viktimin.

[...] gjithashtu se kishte nevojë për të nxitur trajnimin e të gjithë policisë për dhunën në familje, dhe që kjo të mos kufizohej vetëm në zyrtarët policor nga NjHDhF-të. Zyrtarët policor që dalin në vendin e krimit nuk janë domosdoshmërisht nga NjHDhF-të, dhe më pas rastet merren nga zyrtarët policor të cilët shpesh nuk janë të trajnuar mjaftueshmë dhe nuk kanë njohuri për bashkëpunim me institucionet e tjera, duke përfshire Qendrat e Punës Sociale, Zyrën për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimate dhe strehimoret.

[...]

Në aspekt pozitiv, delegacioni vuri në dukje masat e parapara për zgjerimin e fushëveprimit të Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe PSV-ve shoqëruese sipas Strategjisë Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave (2022-2026).

245. Në vitin 2021, sipas Policisë së Kosovës, janë raportuar 2456 raste të dhunës në familje, ndërsa pothuajse 80% e viktimate ishin gra. Megjithatë, mungesa e ndarjes së të dhënavëve nuk lejon izolin e rasteve të raportuara të dhunës nga partneri intim nga format e tjera të dhunës në familje. [...] Qëndrimet përfundojnë përmirësuar mbledhjen gjithëpërfshirëse të provave përpjekjet e policisë për të gjithë viktimat e dhunës në familje si mosmarrëveshje të thjeshta mes çiftve dhe të përpjekjeve të "pajtojnë" çiftin. [...] Sipas informacionit të marrë nga shoqëria civile, besimet në mite rrëth dhunës seksuale mund të kontribuojnë si në një përvojë negative për viktimin (p.sh. pyetje dhe komente të papërshtatshme) ashtu edhe në mungesë të progresit të rastit.

246. Delegacioni u informua për mbështetjen e fuqishme të policisë dhe shërbimeve të prokurorisë në deklaratën e viktimës, veçanërisht në rastet e dhunës në familje. Kur viktimat tërheqin deklaratat e tyre, procedurat penale shpesh përfundojnë përmirësuar mbledhjen gjithëpërfshirëse të provave përpjekjet e policisë për të gjithë viktimat e dhunës në familje. Kishte pak informacione në lidhje me përpjekjet e policisë për të gjithë viktimat e dhunës në familje. Kur viktimat tërheqin deklaratat e tyre, procedurat penale shpesh përfundojnë përmirësuar mbledhjen gjithëpërfshirëse të provave përpjekjet e policisë për të gjithë viktimat e dhunës në familje. Ekziston nevoja për të ngritur masat që synojnë sigurimin e hetimeve efektive dhe ndërtimin e rasteve në të gjitha rastet e dhunës të mbuluara nga konventa.

247. Ju rekomandohet urgjentisht autoritetet e që:

a. të përmirësojnë kapacitetin dhe njohuritë e të gjithë zyrtarëve të zbatimit të ligjit në lidhje me ndërtimin e rasteve të qëndrueshme për të gjitha format e dhunës të mbuluara nga Konventa e Stambollit, duke përfshire mbledhjen me kohë të provave dhe parandalimin e viktimidit dytësor; dhe

b. të hartojnë procedura standarde të raportimit dhe hetimit në lidhje me të gjitha format e tjera të dhunës ndaj grave, veçanërisht dhunën seksuale dhe martesën e detyruar."

266. Përderisa në lidhje me detyrimin për vlerësimin e rrezikut, ndër të tjera, u theksua dhe u rekomandua që:

"259. Sipas Procedurave Standarde të Veprimit (PSV) për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, vlerësimi i rrezikut duhet të jetë pjesë e ndërryrjes së menjëhershme të policisë në rastet e dhunës në familje. Pas një vlerësimi të tillë të rrezikut, policia ka përditësuar mbrojtjen e viktimat dhe t'i informojë ato për të drejtat e tyre, duke përfshire informimin e tyre për lloje të ndryshme të urdhreve të mbrojtjes, ndërlidhjen me akterë të tjerë për të ofruar mbështetje psikologjike, ndihmë juridike, strehim dhe asistencia tjetër. Pasi viktima të sillet në siguri, policia duhet të zhvillojë një plan adekuat të mbrojtjes. Lista kontrolluese e ofruar për policinë për vlerësimin e rrezikut përbëhet nga disa pika në një formular të dhënavëve bazë. Delegacioni u informua se ndërsa zyrtarët policor reagues mund të kryejë një vlerësim fillestar të rrezikut, është detyrim i

*hetuesve policorë nga NjHDhF-të të plotësojnë Formularin e të Dhënave Bazë për të cilin kanë pasur trajnime specifike. Prokurorët kanë detyrimin të marrin masat e nevojshme në varësi të vlerësimit të rrezikut që bëhet në rastet e dhunës në familje.*

260. Ndërsa mirëpritet që vlerësimet e rrezikut të bazuara në formularë të standardizuar parashikohen si një hap i detyrueshëm sipas Procedurave Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, kjo në praktikë duket se ka të bëjë kryesisht me agjencitë e zbatimit të ligjit, ndërsa objektivi i nenit 51 është që të gjitha autoritetet kompetente që mund të vijnë në kontakt me viktimat të vlerësojnë në mënyrë efektive rreziqet për sigurinë e viktimës rast pas rasti. Për më tepër, vlerësimet e rrezikut nuk duket se kryhen sistematikisht nga policia dhe as të bëhen gjithmonë në mënyrë gjithëpërfshirëse për të siguruar mbrojtjen e duhur të viktimave. Në veçanti, policia shpesh dështon të kryejë vlerësimë të rregullta dhe të përsëritura të rrezikut në të gjitha fazat përkatëse të procedurës, përfshirë gjatë dhe pas lëshimit të urdhreve për mbrojtje.

[...]

264. Ju rekomandohet urgjentisht autoriteteteve që të sigurojnë përdorimin sistematik të një mjeti të standardizuar të vlerësimit të rrezikut të bazuar në prova për të gjitha format e dhunës të mbuluara nga Konventa e Stambollit, në mënyrë që të mundësohet që të gjithë faktorët përkatës të rrezikut të vdekjes dhe dhunës së përsëritur të identifikohen me kohë dhe reagohet ndaj tyre, kur bëhet kontakti i parë me viktimat dhe pas kësaj. Gjithashtu, ju rekomandohet autoriteteteve që të sigurojnë që procedurat e vlerësimit dhe menaxhimit të rrezikut të jenë thelbësore për reagime të koordinuara të agjencive të shumta kundër dhunës ndaj grave, ndërkohë që shtohen trajnimet për agjencitë e zbatimit të ligjit, gjyqësorin dhe shërbime të tjera përkatëse.”

#### **C. Aplikimi i detyrimeve që dalin nga nenet 18, 50, 51 dhe 55 në rrrethanat e rastit konkret**

267. Gjykata rikuhton se ajo tashmë ka konstatuar se mosveprimet e Policisë së Kosovës, përkatësisht Stacionit Policor në Graçanicë dhe Prokurorit të Shtetit, përkatësisht Prokurorisë Themelore në Prishtinë, kanë rezultuar në cenimin e të drejtës për jetë të nënës së parashtrueses së kërkesës, përkatësisht S.M., e cila ishte privuar ngajeta nga bashkëshorti i saj më 14 mars 2021.
268. Gjykata po ashtu rikuhton se kjo e fundit gjatë këtij vlerësimi kishte aplikuar parimet e përgjithshme dhe kriteret e zhvilluara përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së në kontekst të dhunës në familje, përkatësisht kritereve të përcaktuar në rastin *Kurt kundër Austrisë* dhe të aplikuara edhe në rastin *Y dhe të Tjerët kundër Bullgarisë* dhe *Landi kundër Italisë*. Në lidhje me këtë, Gjykata po ashtu ka vënë në dukje se në lidhje me kriterin e vlerësimit të rrezikut dhe ndërmarrjen e masave parandaluese GJEDNJ, i ishte referuar edhe detyrimeve të përcaktuara përmes Konventës së Stambollit.
269. Testin e zhvilluar nga GJEDNJ në rastin *Kurt kundër Austrisë* dhe të aplikuar edhe në dy rastet e mëvonshme të saja, Gjykata e aplikoi edhe në rrrethanat e parashtrueses së kërkesës, pas aplikimit të së cilët konstatoi, ndër të tjera, se: (i) dështimi për të ndërmarrë veprime nga Stacioni Policor në Graçanicë dhe Prokuroria Themelore në Prishtinë për zhvillimin e një vlerësim të rrezikut të menjëhershëm autonom, proaktiv dhe gjithëpërfshirës për jetën e S.M-së; (ii) dështimi të njoftimit të akterëve të tjere, përkatësisht, ZMNV-së dhe QPS-së, në këtë procedurë; dhe (iii) mungesës së ndërmarrjes së masave parandaluese, kanë rezultuar në cenimin e të drejtës për jetë

të S.M.-së, të garantuar me nenin 25 të Kushtetutës në lidhje me nenin 2 të KEDNJ-së.

270. Gjykata në kontekst të detyrimeve specifike që dalin nga Konventa e Stambollit, e cila është drejtpërdrejtë e zbatueshme në sistemin juridik të Republikës së Kosovës dhe ka epërsi ndaj ligjeve të Republikës së Kosovës, e konsideron megjithatë të nevojshme që të shqyrtojë pretendimin e ngritur nga parashtruesja e kërkesës për shkelje të neneve 18, 50 dhe 51 të Konventës së Stambollit. Në vijim, Gjykata në kuadër të pretendimit të parashtrueses së kërkesës për shkelje të nenit 18 të Konventës së Stambollit, ka konsideruar të nevojshme të shqyrtojë edhe detyrimin e autoriteteve shtetërore të cilat burojnë nga neni 55 i Konventës së Stambollit.

(a) *Në lidhje me nenin 18 të Konventës së Stambollit*

271. Gjykata në rrethanat e rastit konkret vë në dukje paragrafin 4 të nenit 18 të Konventës përmes të cilit përcaktohet se detyrimi i shtetit, nuk varet nga gatishmëria e viktimës për të ngritur akuza ose për të dëshmuar kundër një autori të veprës penale ndërlidhet edhe me nenin 55 të Konventës. Më konkretisht, bazuar në rrethanat e rastit konkret, Gjykata vlerëson se tërheqja e së ndjerës S.M. për të dhënë deklaratë në lidhje me raportimin e dhunës, nga ana e bijës së saj, nuk nënkupton lirimin e autoriteteve përkatëse, përkatësisht të Policisë së Kosovës dhe Prokurorisë Themelore që ndaj të njëjtës të ndërmerrën masa parandaluese për mbrojtjen e jetës së saj dhe po ashtu të fëmijëve të saj.
272. Prandaj, Gjykata në vijim të konstatimit të lartcekur do të shqyrtojë nëse mungesa e vlerësimit të menjëhershëm të rrezikut nga Policia e Kosovës; mos njoftimi i Mbrojtësit të Victimave dhe të Qendrës për Punë Sociale nga ana e Policisë dhe dështimit për ndërmarrjen e masave parandaluese nga ana e Policisë së Kosovës dhe Prokurorisë Themelore në Prishtinë, kanë rezultuar edhe në shkeljen e detyrimeve të dala nga nenet 50, 51 dhe 55 të Konventës së Stambollit.

(b) *Në lidhje me nenin 50 dhe nenin 51 të Konventës*

273. Gjykata rikuhton që Policia e Kosovës ka dështuar që të bëjë vlerësimin e rrezikut të përcaktuar në Procedurat Standarde të Veprimit, detyrim ky i përcaktuar edhe me nenin 51 të Konventës. Për pasojë, Gjykata gjen se mungesa e këtij veprimi për vlerësimin e rrezikut të menjëhershëm, ka rezultuar edhe në dështimin e ndërmarrjes së masave parandaluese, detyrim ky i përcaktuar me nenin 50 të Konventës.

(c) *Në lidhje me nenin 55 të Konventës*

274. Siç është elaboruar edhe në pjesën e pretendimeve që ndërlidhen me të drejtën për jetë të garantuar me nenin 25 të Kushtetutës dhe nenin 2 të KEDNJ-së, Gjykata vë në dukje se detyrimet që dalin nga nenii 55 i Konventës, në rastet kur, ndër të tjera, rasti ndërlidhet me dhunë fizike [neni 35 i Konventës së Stambollit]. Gjykata në këtë rast, rikuhton se nenii 55 (Procedimet *ex parte* dhe *ex officio*) i Konventës thekson se: "...hetimet ose ndjekja penale e veprave penale të parashikuara në përputhje me nenet 35, 37, 38 dhe 39 të kësaj Konverte nuk do të janë tërësisht të varura nga një raport ose ankesë e paraqitur nga një viktimë, nëse vepra penale ishte kryer tërësisht ose pjesërisht në territorin e saj, dhe se procedimi mund të vazhdojë edhe nëse viktima e tërheq deklaratën ose ankesën e tij ose saj".
275. Prandaj, në dritën e këtyre rrethanave, Gjykata vlerëson se autoritetet shtetërore përkatësisht Stacioni Policor në Graçanicë dhe Prokuroria Themelore në Prishtinë, nuk kanë vepruar në pajtim me paragrafin 1 të nenit 55 të Konventës së Stambollit,

sepse pavarësisht tërheqjes së deklaratës nga ana e S.M.-së më 4 mars 2021, të njëjtat kanë pasur detyrimin që sipas detyrës zyrtare të vazhdojnë me hetimin dhe ndjekjen penale ndaj L.S.-së.

### **Efektet juridike të Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese**

276. Siç u konstatua më lart nga Gjykata, “veprimet dhe mosveprimet” e Policisë së Kosovës dhe Prokurorit të Shtetit, kanë rezultuar në shkeljen e: (i) detyrimit pozitiv përmbrrojtjen e të drejtës për jetë të S.M.-së, të garantuar me nenin 25 të Kushtetutës në lidhje me nenin 2 të KEDNJ-së; dhe (ii) detyrimeve të përcaktuara me nenet 18, 50, 51 dhe 55 të Konventës së Stambollit.
277. Në kuptim të këtij konstatimi, Gjykata sqaron se, siç është svaruar përmes praktikës së saj gjyqësore tashmë, përfshire në rastet (shih, ndër të tjera, rastet e Gjykatës, KI10/18, parashtrues *Fahri Deqani*, Aktgjykim, i 8 tetorit 2019, KI45/20 dhe KI46/20, parashtrues: *Tinka Kurti dhe Drita Millaku*, Aktgjykim, i 26 marsit 2021 KI113/21, parashtruese *Bukuriye Haxhimurati*, Aktgjykim, i 20 dhjetorit 2021) ajo nuk ka autorizime ligjore për të caktuar ndonjë kompensim të dëmit për rastet kur konstaton shkelje të dispozitave respektive kushtetuese. Megjithatë, Gjykata, në këtë kuptim sqaron se efekti që ky Aktgjykim mundëson, ka të bëjë me të drejtën që i krijohet parashtrueses së kërkesës që nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij Aktgjykimi, për të shfrytëzuar mjetet e tjera juridike në dispozicion për realizimin e mëtejshmë të të drejtave për kompensimin përkatës në përputhje me gjetjet e këtij Aktgjykimi.
278. Në fund, Gjykata thekson, që Konventa e Stambollit dhe e cila është drejtpërdrejtë e aplikueshme në rendin juridik të Republikës së Kosovës, përcakton detyrime të shtetit edhe përkitazi me mjetin juridik efektiv edhe kompensimin adekuat dhe brenda një periudhe të arsyeshme, për viktimat e shkeljeve të Konventës. Këto detyrime janë të përcaktuara në nenet 29 dhe 30 të Konventës së Stambollit, respektivisht. Më saktësisht, përkitazi me mjetet juridike, neni 29 i Konventës përcakton detyrimin e shtetit, që të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme legjislativ apo masat e tjera të duhura që t'i mundësojë: (i) viktimate përkatëse mjetin juridik kundër kryerësit të dhunës; dhe (ii) në përputhje me parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare, mjetin juridik adekuat kundër autoriteteve shtetërore të cilat kanë dështuar në detyrën e tyre për të ndërmarrë masat e nevojshme parandaluese dhe mbrojtëse në kuadër të fushëveprimit të tyre. Ndërsa, përkitazi me kompensimin, neni 30 i Konventës përcakton detyrimin e shtetit, që të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme legjislativ apo masat e tjera për të siguruar që viktimat kanë të drejtë për të kërkuar kompensimin e duhur për të gjitha shkeljet e përcaktuara përmes Konventës. Për më tepër, i njëjti nen saktëson që kompensimi adekuat dhe brenda një afati të arsyeshëm duhet tu akordohet të gjithë viktimate të shkeljeve të Konventës, sipas saktësimeve të këtij nenit.
279. Gjykata rikujton që Konventa e Stambollit është drejtpërdrejtë e aplikueshme në Republikën e Kosovës që nga miratimi i amendamenteve kushtetuese më 25 shtator 2020. Gjykata gjithashtu rikujton që instrumentet ndërkombëtare drejtpërdrejtë të aplikueshme në Republikën e Kosovës, ngërthejnë edhe detyrime për shtetin siç është svaruar në këtë Aktgjykim. Ndër këto detyrime, përfshihen edhe krijimi i mekanizmave efektiv për mjet juridik efektiv dhe kompensim adekuat, sipas dispozitave të lartcekura të Konventës së Stambollit.

## PËR KËTO ARSYE

Gjkata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenet 47, 48 dhe 49 të Ligjit dhe me rregullin 59 (1) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 7 mars 2023, njëzëri:

### VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;
- II. TË KONSTATOJË se Policia e Republikës së Kosovës, përkatësisht Stacioni Policor në Graçanicë dhe Prokurori i Shtetit, përkatësisht Prokuroria Themelore në Prishtinë, kanë dështuar në detyrimin e tyre pozitiv për mbrojtje të jetës së S.M.-së, të garantuar me paragrafin 1 të nenit 25 [E Drejta për Jetën] të Kushtetutës dhe paragrafin 1 të nenit 2 (E drejta për jetën) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- III. TË KONSTATOJË se Policia e Republikës së Kosovës, përkatësisht Stacioni Policor në Graçanicë dhe Prokurori i Shtetit, përkatësisht Prokuroria Themelore në Prishtinë, kanë dështuar në përbushjen e detyrimeve të përcaktuara me paragrafin 4 të nenit 18 (Detyrimet e Përgjithshme), paragrafin 1 të nenit 50 (Reagim, parandalim dhe mbrojtje të menjëherëshme), paragrafin 1 të nenit 51 (Vlerësimi i rrezikut dhe menaxhimi i rrezikut) dhe paragrafin 1 të nenit 55 (Procedimet *ex parte* dhe *ex officio*) të Konventës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje;
- IV. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve dhe, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, ta publikojë në Gazetën Zyrtare;
- V. Ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari rapportues

Safet Hoxha

Kryetarja e Gjkatës Kushtetuese

Gresa Caka-Nimani

